

VËRTETËSIA

Botimi i Xhematit Mysliman Ahmadia të Shqipërisë

Maj-Gusht 2009



Paqja politike pjesa I f. 36



Profeti i paqes:

Shembulli i Profet Muhammedit s.a.v.s. për të vendosur paqen, dashamirësi e tij e pashoqe ndaj armiqve dhe qëllimi i luftërave të tij kundër tyre.

f. 15



Statusi i gruas në Islam:

Një shikim mbi të drejtat dhe rolet e saj në shoqërinë islame.

f. 45



Bekimet e Allahut mbi

Xhematin Mysliman Ahmadia (pjesa I): Përmendja e një pjese të raportit të veprimtarisë së Xhematit gjatë vitit 2008-2009.

f. 61



Një komunitet – një

udhëheqës: Dokumentar rreth përpjekjeve të bëra prej Xhematit Ahmadia për përhapjen e paqes dhe lirisë fetare.

f. 71

Udhëzime nga Kurani Famëlartë, Hadithet dhe nga Librat e feve të ndryshme

VËRTETËSIA

"Erdhi e vërteta dhe u zhduk e pavërteta. Sigurisht, e pavërteta gjithnjë zhduket."

(Kurani i Shenjtë 17-82)

Botimi i Xhematit Mysliman Ahmadia të Shqipërisë

Maj-Gusht 2009 Viti I Nr. 2

LËNDA

Feja Islame, pishtar i lirisë fetare dhe ndërgjegjes.....	2
S'ka dhunë në çështjen e fesë – Komentimi i Kuranit Famëlartë.....	5
Mëshirojini banorët e tokës, që të mëshiroheni nga Ai në qiell. Thënie të Profetit s.a.v.s.....	9
Ç'është xihadi dhe pse Islami pati nevojë për të? Thënie të Mesihut të Premtuar a.s.	11
Hazret Muhammedi, Profeti i paqes	15
Jeta e Hazret Ebu Bekrit r.t.	27
Mendjemadhësia, armiku më i madh i besimtarit	31
Dhjetë gjëra të kota.....	35
Paqja politike (pjesa I)	36
Statusi i gruas në Islam	45
Sadakaja më e madhe	60
Bekimet e Allahut të Lartësuar mbi Xhematin Mysliman Ahmadia	61
Një komunitet, një udhëheqës – Dokumentar televiziv i MTA-së	71
Shkurtime	80

Redaksia

Kryeredaktor: Samad Ahmed Ghor
Zv. Kryeredaktor: Shahid Ahmad Butt
Redaktorë: Rexhep Hasani, Muhamet Peci, Marjela Peci, Izet Shehu
Anëtarë: Javaid Iqbal Nasir, Bujar Ramaj, Çapajev Zera
Shtypur në Shtypshkronjën
"Mirgeeralb", Tiranë, 2009

Adresa:

Xhemati Mysliman Ahmadia i Shqipërisë, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 1,
Kutia Postare 8176, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355(0)682974992, 0692994966, 0672168054,
Fax: +355(0)48302523
E-mail: vertetesia@gmail.com

www.alislam.al



FEJA ISLAME

pishtar i lirisë fetare dhe ndërgjegjes

Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. kishte lindur në një shoqëri që ndiqte rrugën e barbarizmit, mizorisë dhe mendjengushtësisë, por megjithatë, ai solli një mësim që është i pashembullt në mbajtjen e drejtësisë, dhembshurisë dhe tolerancës fetare. Mësimi i tij (Kurani i Shenjtë) deklaron:

*"S'ka dhunë në çështjen e fesë"*¹

Mandej thotë:

*"Kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë."*²

Një tipar dallues i mësimave të Islamit nga të tjerat, është ai që Kurani i Shenjtë thotë qartazi, se duhet të mbash drejtësi në çështjet e popujve dhe të ithtarëve të feve të tjera, por njëkohësisht lejon edhe hakmarrje, nëse ajo do të jetë për të vendosur drejtësi, megjithëkëtë, parapëlqen faljen duke thënë se ajo do të shpërblehet Vetë nga Zoti.³

Nëse bëhet ndonjë padrejtësi nga ithtarët dhe popujt e feve të tjera, atëherë Allahu thotë:

"Mos t'ju nxisë kurrsesi urrejtja ndaj disa njerëzve që ju penguan të vizitoni Qabenë, që

*të bëni padrejtësi ndaj tyre! Ndhimoheni njëri-tjetrin në punë të mira..."*⁴

Nëpërmjet Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s., Allahu i Lartësuar dha këtë mësim të shkëlqyer, që nëse do të shikoni diçka të mirë në fe dhe popuj të tjerë, duhet ta vlerësoni. Ai në Kuranin e Shenjtë thotë:

*"Ata nuk janë të gjithë njëllor. Disa nga ithtarët e Librit (Biblës) janë të drejtë: në orët e natës lexojnë vargjet e (Librit të) Allahut dhe bëjnë sexhde (përkulen) para Tij."*⁵

Gjithashtu duke e vlerësuar ndërgjegjshmërinë e disa ithtarëve të Librit, Kurani i Shenjtë thotë:

*"Ka nga ata ithtarë të Librit, që sikur t'u besosh një barrë të tërë ari, do t'jua kthejnë, por ka edhe të atillë që, nëse u jep në besim, qoftë edhe një dinar, nuk ta kthejnë, veçse nëse nuk u ndahesh."*⁶

Feja Islame jep edhe këtë mësim, që duke u shastisur gjatë debateve dhe polemikave fetare, të mos i fyejmë apo shajmë personalitetet e tyre që janë të nderuara për ta, siç Zoti thotë në Kuranin Famëllartë:

*"Mos i shani ata që jobesimtarët i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija."*⁷

1 El-Bekare 2:257

2 El-Kehf 18:30

3 Ajeti i Kuranit thotë: "Shpërblimi për të keqen është i njëjtë me atë të keqe. Por, atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i Allahut. Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët." (Esh-Shura 42:41)

4 El-Maida 5:3

5 Al-Imran 3:114

6 Al-Imran 3:76

7 El-En'am 6:109

E vetmja fe në botë që pranon të gjithë profetët:

Islami është e vetmja fe në botë, e cila me mësimet e saj të mrekullueshme, paraqet zgjidhjen hyjnore për të shpëtuar nga keqkuptimet dhe tensionet e thella të zhvilluara midis feve të ndryshme.

Sipas Kuranit, të gjitha fetë janë nga Zoti, vetëm se ato në fillim ishin në rrugën e drejtë, por me kalimin e kohës u ndryshuan për shkak të ndërhyrjeve njerëzore. Veç kësaj, ai jo vetëm që e pranon vërtetësinë e të gjithë profetëve, duke pohuar se ata janë nga i njëjti burim, i cili është Allahu i Madhërishëm, por gjithashtu, për herë të parë zbuloi para botës ardhjen e mijëra e mijëra profetëve te popujt e ndryshëm. Kurani i Shenjtë thotë:

“Nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur alarmues.”⁸

Në një vend tjetër Allahu i Madhërishëm deklaron:

“Dhe Ne kemi dërguar te secili popull një profet me këtë mësim: O njerëz, adhurojeni vetëm Allahun dhe shmangni idhujt. Atëherë, disa prej tyre Allahu i përudhi, por disa e merituan të mbeten në humbje. Andaj, udhëtoni nëpër botë dhe shihni se si ishte përfundimi i atyre që (i) përgënjeshtroan (profetët)!”⁹

Mendon për një moment mbi universalizimin e këtij mësimi, i cili paraqitet vetëm nga Kurani i Madhërishëm:

“Vërtet, ata të cilët e mohojnë Allahun dhe Profetët e Tij dhe dëshirojnë të krijojnë dallim midis Allahut e profetëve të Tij dhe thonë: Ne i besojmë disa (profetë), kurse disa të tjerë i mohojmë, dhe (ata) dëshirojnë që të marrin ndonjë qëndrim ndërmjet këtyre, Të tillët janë mosbesimtarë të vërtetë, ... Ndërsa ata të cilët e besojnë Allahun dhe profetët e Tij e që nuk bëjnë ndonjë dallim midis asnjërit prej tyre

8 Fatir 35:25

9 En-Nahl 16:37

(profetëve), të tillëve së shpejti Allahu do t'u japë shpërblimet e tyre. Dhe Allahu fal shumë dhe është i Mëshirshëm.”¹⁰

Në një ajet tjetër Kurani i Shenjtë i urdhëron myslimanët të deklarojnë:

“Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij.”¹¹

Sigurisht, këto mësimet kaq universale i japin një kod themelor shoqërisë për të krijuar paqe ndërfetare.

Islami mëson vetëm paqen

Është vërtetë befasuese të shikosh shumë dijetarë myslimanë me mentalitet mesjetar, që pajtohen me idenë se myslimanët duhet t'u kundërvihen jo myslimanëve në një luftë me armë dhe të qëndrojnë duke luftuar me ta, derisa ata të jenë shfarosur ose të kenë pranuar Islamin. Islami, siç shohim në Kuranin e Shenjtë, nuk ka të bëjë fare me këto nocione të shtrembëruara dhe të deformuara të *xhihadit*. Përkundrazi, Islami kërkon të shpërndajë paqen me të gjitha mënyrat. Kurani Famëlartë fillon me këtë ajet: **Elhamdulilahi Rabbil alamin**, do të thotë se Zoti që na paraqet Islami, nuk është vetëm Zoti i Lindjes apo i Perëndimit, i ndonjë kaste apo i ndonjë vendi të veçantë, por Ai është **Zot i të gjithë botëve** dhe i mëshiron të gjitha ato. Islami është e vetmja fe, të cilën Vetë Zoti e ka emërtuar si **Islam**, që do të thotë **dhënie e sigurisë**, ndërsa ai që ndjek këtë fe, quhet **muslim** (mysliman), domethënë **ai që mundëson sigurinë**. Të praktikuarit e të gjitha rregullave dhe udhëzimeve të kësaj feje quhet **iman**, që do të thotë **përhapje e paqes**, dhe personi që e pranon këtë **Iman** quhet **mu'min**, domethënë **ai që përhap paqen me të gjitha mundësitë e tij**. Sërish, Zoti që

¹⁰ En-Nisa 4:151-153

¹¹ El-Bekare 2:286

paraqet Islami ka shumë emra të bukur, njëri prej tyre është *Es-Selam*, që do të thotë, **paqe e plotë**. Themeluesit të Islamit i është dhënë emri *Rrahmat-ul-lil-Alemin*, që do të thotë se **ai është mëshirë për të gjithë universin**. Kundërshtarët e tij, përpara se të shpallej profet nga Zoti, e thërrisnin me titullin *El-Emin*, domethënë, **i besueshëm dhe i kujdesshëm ndaj amaneteve e shpërndarës i paqes**. Edhe engjëlli që i solli këtë mesazh paqësor Profetit Muhammed s.a.v.s., në Kuran quhet *Ruh-ul-Emin*, që gjithashtu do të thotë, **shpirt i besueshmërisë dhe i paqes**. Përsëritetja islamike që mëson Zoti me anë të Kuranit të Shenjtë në suren En-Nur është *Selam alejkum va rrahmatullahi va barakatuhu*, që në shqip do të thotë, **paqja, mëshira dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ju**. Vallë, a është kjo fe që mëson dhunën dhe terrorizmin?!

Mjerisht, në këtë kohë, feja Islame kaq paqësore është keqkuptuar nga shumë njerëz. Shkaqet e këtij keqkuptimi janë keqinterpretimi i çështjes së xhihadit, keqpërfaqësimi i fesë Islame nga shumë dijetarë e hoxhallarë myslimanë që shfrytëzojnë pasionin e besimit për t'i plotësuar qëllimet e tyre barbare, të cilat nuk kanë kurrfarë lidhje me të vërtetën.

Sot, me përfaqësimin e Hazret Mesihut të Premtuar a.s., Kalifi i tij i Pestë, Hazret Mirza Masroor Ahmadi a.t.b.a. orvatet dhe së bashku me të, i gjithë Xhemati i tij ndërkombëtar përpiqet me të gjitha fuqitë për t'ia larguar fesë Islame akuzat e vëna nga armiqtë apo ata që e keqkuptuan këtë fe kaq paqedashëse. Hazret Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar, jo vetëm që mbajti fjalime dhe ligjërata për t'ia treguar të vërtetën botës, por duke qenë një prijës shumë i dashur i Xhematit të tij, ai gjithashtu ua mëson vazhdimisht miliona anëtarëve të Xhematit, sesi

mund ta arrijmë këtë qëllim. Veç kësaj, Ai ka udhëtuar shumë, për të përhapur mesazhin e paqes dhe për t'i sjellë ndërmend çdokujt që t'i respektojë të drejtat e njerëzve. Gjatë udhëtimeve të tij, Hazret Kalifi i Pestë a.t.b.a. ka takuar liderët e botës si në Lindjen e Largët, ashtu edhe në Evropë, në Amerikën Veriore dhe gjithashtu në Afrikë, për të diskutuar për problemet që po përballlet sot bota, qofshin shoqërore, qofshin ekonomike apo politike. Ai gjithashtu ka takuar prijës të feve apo komuniteteve të ndryshme, për të ndarë me ta vlerat unike dhe idetë thelbësore që janë të njëjta në çdo fe dhe që ngrenë statusin moral të njerëzimit, duke krijuar një atmosferë të dashurisë e dhembshurisë. Një shembull shumë të vogël të veprimtarisë së tij në këtë fushë, me anë të këtij numri të *Vërtetësisë*, po ju sjellim një dokumentar në të cilin flasin liderë, politikanë të ndryshëm të shumë vendeve të botës dhe e përgëzojnë Xhematin Mysliman Ahmadi për përhapjen e mesazhit të Islamit, të paqes e të dashurisë në mbarë botën. Por, kjo nuk është diçka që ka nisur ky Xhemat për herë të parë. Në fakt, në shkallën më të lartë të të praktikuarit, ky mësim i paqes, u realizua nga Profeti ynë i dashur Hazret Muhammedi paqja e mëshira e Allahut gjithmonë qofshin mbi të dhe ndjekësit e tij. Fjalimi i së premtes i Kalifit të Pestë të Mesihut të Premtuar që vjen në këtë numër të revistës, hedh mjaft dritë mbi këtë temë. Xhemati Mysliman Ahmadi njeh vetëm atë Islam, që është Islam i dashurisë dhe dhembshurisë, Islam që jep mesazhin e vërtetë të paqes dhe të sigurisë. Me anë të kësaj reviste, me shumë modesti, ju ftojme ju të gjithë që ta zbuloni Islamin e vërtetë të Xhematit Mysliman Ahmadi, i themeluar nga Hazret Mirza Ghulam Ahmadi, Mesihu i Premtuar dhe Imam Mahdiu paqja e Allahut qoftë mbi të.

Samad Ghori

“S’ka dhunë në çështjen e fesë.”

KOMENTIMI I KURANIT TË SHENJTË

Nga Hazret Mirza Mahmood Ahmadi, Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar r.a. (1889-1965)

Allahu i Madhërishëm, në Kuranin e Shenjtë thotë:

“S’ka dhunë në çështjen e fesë. Tashmë është e dalluar e drejta nga e shtrembra. Ai që kundërshton shejtanin dhe beson në Allahun, ka kapur lidhjen më të fortë që nuk këputet kurrë. Allahu është i Gjithëdëgjueshëm dhe i Gjithëdijshtëm.”¹

Hazret Mirza Mahmud Ahmadi, Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar r.a., duke shpjeguar këtë ajet, thotë:

“Është e çuditshme se si feja Islame akuzohet se ajo u mëson besimtarëve të saj se ata mund ta përhapin fenë me dhunë. Ndërsa, feja Islame në njërën anë thotë *“Luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që luftojnë me ju.”*² dhe në anën tjetër gjithashtu sqaron *“S’ka dhunë në çështjen e fesë.”*³ Kjo do të thotë, se urdhri i luftës nuk duhet keqkuptuar dhe se luftërat nuk do të lejohen edhe për të konvertuar njerëzit e tjerë në myslimanë. Madje, urdhri i luftës është vetëm për t’u mbrojtur nga armiqtë dhe për të evituar

intrigat e tyre. Nëse Islami do të lejonte dhunën, atëherë si është e mundur që në një vend në Kuran, ai jep leje për luftën dhe në të njëjtën sure deklaron se *“S’ka dhunë në çështjen e fesë.”* A nuk tregon kjo qartazi se Islami ndalon çdolloj dhune në çështjen e fesë. Edhe fjalët që i vijnë këtij deklarimi e sqarojnë mjaft këtë

çështje. Në fakt kjo është veçse një akuzë e rreme që kanë ngri-

tur dijetarët e krishterë se

feja Islame i bën njerëzit myslimanë me tehun e shpatës. E vërteta është, Islami ishte feja e parë që i dha botës këtë mësim të bukur, duke thënë: *“S’ka dhunë në çështjen e fesë.”*

“Tashmë është e dalluar e drejta nga e shtrembra.” Kjo fjali është shpjeguese. Domethënë e sqaron pohimin e bërë pak më parë. Meqë Allahu e ndaloi dhunën në çështjen e fesë, atëherë mund të lindë pyetja: kur feja është diçka shumë e vlerësuar, atëherë pse mos të detyrohen njerëzit për ta përvetësuar atë? Përgjigja ndaj kësaj pyetje është se tashmë u bë qartë se cila është e drejtë dhe cila është e gabuar. Andaj, nuk ka nevojë që të imponohet

الْقُرْآنُ الْكَرِيمُ

1 El-Bekare 2:257

2 El-Bekare 2:191

3 El-Bekare 2:257

diçka. Dhuna fillon atëherë kur nuk mund të provohet diçka me argument. Për shembull, një fëmijë kur ende nuk është i pjekur për të vendosur gjërat në mënyrë të duhur, atëherë prindërit e detyrojnë që ai të mos i sjellë dëm vetes. Por kur ai rritet dhe arrin në moshën e pjekurisë së duhur, askush nuk mund ta detyrojë atë.

Pra, Allahu i Madhërishëm thotë se çdo gjë në fenë Islame është përmendur me argumente të qarta dhe ato nuk kërkojnë dhunë për t'u realizuar. Madje Islami e hedh poshtë mendimin që feja të imponohet me zor ose të zbatohet nga frika apo lakmia. Siç thotë Allahu i Madhërishëm në Kuranin e Shenjtë: *"Kur vij në hipokritët te ti (o Muhammed), ata të thonë: 'Vërtetë je i Dërguari i Allahut.' Ndërkohë, Allahu e di që ti je i Dërguari i Tij, por Allahu gjithashtu dëshmon se hipokritët sigurisht po gënjejnë."*⁴

Nëse Islami do të lejonte dhunën në përhapjen e fesë, atëherë si do të ishte e mundur që rreth hipokriteve të flitej kështu në Kuran. Sepse, në këtë situatë ata do të ishin pasojë e mësimi të Kuranit. Askush nuk mund të shpresojë që Islami do të krijojë një xhemat të devotshmëve me dhunë. Prandaj, është krejtësisht gabim që të mendosh se Islami e lejon dhunën për të përhapur fenë.

Sërish, në një ajet tjetër, Kurani i Shenjtë thotë: *"Luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që luftuan me ju. Por mos e teproni. Vërtet, Allahu nuk i do ata që e teprojnë."*⁵

Edhe në këtë ajet, Islami i porositi myslimanët të luftojnë për hir të fesë vetëm kundër atyre që luftuan me myslimanët për fenë dhe përdorën dhunë për t'i larguar ata nga feja e tyre. Por, edhe në

këtë rast urdhri i Allahut për myslimanët është që ata mos ta teprojnë. Nëse kundërshtarët do të tërhiqen apo të heqin dorë nga dhuna, atëherë edhe myslimanët duhet të heqin dorë nga lufta. Shkurt, në Kuranin e Shenjtë, Allahu i Madhërishëm lejon luftën jo për të zhdukur fe të ndryshme, por e lejon për t'i mbrojtur ato. Siç e sqaron Ai në ajetin e mëposhtëm të Kuranit:

*"Atyre që janë sulmuar, u lejohet (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi. Në të vërtetë Allahu është i Fuqishëm që t'i ndihmojë ata, që janë dëbuar nga shpëtitë e tyre padrejtësisht, vetëm sepse thanë: 'Zoti ynë është Allahu.' Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t'u mbrojtur nga njerëjtjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Vërtetë, Allahu e ndihmon atë që e ndihmon Allahun. Allahu është vërtetë i Fortë dhe i Plotfuqishëm."*⁶

Sa të qarta janë këto ajete që tregojnë se lufta fetare lejohet vetëm atëherë kur një popull ndalohet të thotë "Allahu është Zoti ynë." Domethënë, kur dikush ndërhyr në çështjen e fesë dhe dëshiron të rrëzojë vende të shenjta të popujve të tjerë dhe i detyron të ndryshojnë fetë e tyre, ose tenton t'i vrasë ata, në këto rrethana, sipas Islamit, i shtypuri është i lejuar të luftojë kundër njerëzve të tillë. Sepse Islami ka ardhur si një fe dëshmitare dhe mbrojtëse e jo e egër dhe mizore....

"Ai që kundërshton shejtanin dhe beson në Allahun ka kapur lidhjen më të fortë që nuk këputet kurrë." Në këtë ajet, fjala arabe që është përdorur për të shprehur kuptimin e lidhjes është *"urrvah"*, që do të thotë (1)

4 El-Munafikun 63:2

5 El-Bekare 2:191

6 El-Hexh 22:40-41

dorezë, (2) diçka në të cilën mbështetet ose besohet, (3) “*urrvah*” gjithashtu do të thotë diçka që herë pas here i nevojitet njeriut dhe ai shpesh kthehet tek ajo gjë, (4) diçka që zgjatet shumë dhe nuk prishet dhe (5) më e mira e pasurisë.

Sipas këtyre kuptimeve, (1) Allahu fenë e përcakton si diçka shumë të dobishme që ndodhet në një enë dhe e këshillon njeriun që ta kapë dorezën e saj për ta siguruar atë për veten. (2) Feja është pikërisht ajo gjë që i jep mbështetje njeriut për të mos u rrëzuar. Duke iu ngjitur shkallëve, për shembull, njeriu merr mbështetje nga një litar apo diçka tjetër. Feja është pikërisht ajo mbështetje, me anë të së cilës, njeriu shpëton nga rrëzimi. (3) Duke përdorur fjalën “*urrvah*”, Allahu gjithashtu na tregon se vetëm feja është ajo që do të na ndihmojë për një kohë të gjatë, në këtë botë, po ashtu edhe në botën tjetër. Lidhjet e tjera të njeriut janë të përkohshme dhe me kalimin e kohës, ato zhduken njëra pas tjetrës. Sigurisht që edhe lidhje të ngushta farefisnore apo miqësore, gjatë jetës së tij, e ndihmojnë shumë njeriun. Por në shumë raste edhe ato dobësohen ose shpëputen fare. Atëherë, ai kupton se lidhja më e fortë dhe më e bekuar është ajo e fesë së vërtetë.”⁷

Urdhri i parë nga Allahu i Madhërishëm për luftë ishte ai që është përmendur në ajetet e mëposhtme të sures *El-Haxh*:

“Atyre që janë sulmuar, u lejohet (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi. Në të vërtetë Allahu është i Fuqishëm që t’i ndihmojë ata, që janë dëbuar nga shtëpitë e tyre padrejtësisht, vetëm sepse thanë: “Zoti ynë është Allah.” Sikur Allahu të mos u kishte dhënë

*njerëzve mundësinë për t’u mbrojtur nga njeri tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Vërtetë, Allahu e ndihmon atë që e ndihmon Allahun. Allahu është vërtetë i Fortë dhe i Plotfuqishëm.”*⁸

Këto ajete janë zbritur më datën 12 safer, 02 hixhri (kalendari islamik), ose më 15 gusht të vitit 623, kur kishte kaluar vetëm një vit nga mërgimi i Profetit Muhammed s.a.v.s. nga Meka në Medinë. Kjo do të thotë se myslimanët, më përpara, dymbëdhjetë vite në Mekë dhe një vit në Medinë nuk bënë asnjë lloj lufte. Mirëpo, gjatë gjithë kësaj periudhe, ata u bojkotuan, disa prej tyre u vranë pamëshirë, u përballën me lloj-lloj torturash dhe më në fund u detyruan të mërgonin nga vatrata e tyre, duke humbur gjithçka nga pasuria materiale. Mizoritë e mekasve i ndoqën edhe në Medinë, deri atëherë kur myslimanët kishin ngelur me të vetmen rrugëzgjdhje: për të shpëtuar jetën, ata duhet t’u përgjigjeshin sulmeve të armiqve. Ky është sfondi historik i ajeteve të lartpërmendura. Duke shpjeguar këto ajete, Hazret Mirza Mahmud Ahmadi, Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar, në komentimin e tij për Kuranin e Shenjtë, thotë:

“Në këto ajete arsyetohet fakti se pse myslimanëve, në rrethana specifike, u është dhënë leje nga Zoti i Madhërishëm për të bërë luftë mbrojtëse. Islami nuk mëson si krishterimi: “*në qoftë se dikush të qëllon mbi faqen e djathtë, ktheja dhe tjetrën.*”⁹ Por, ai thotë se nëse ty të bëhet mizori e padrejtësi dhe armiku të dëbon nga shtëpia jote, vetëm për arsye se ti thua

7 Mirza Mahmood Ahmad, *Tefsir-e-Kabir*, vëll. 2, f. 585-588, Kadian, shkurt, 2004

8 El-Hexh 22:40-41

9 Mateu 5:39

Allahu është Zoti ynë, atëherë ti duhet t'i përgjigjesh. Nëse je ndër të shtypurit, Allahu do të vijë për të të ndihmuar dhe Ai është i Plotfuqishëm që të të ndihmojë ty. Allahu thotë në këto ajete se ky urdhër është, në fakt, për të vendosur pagën. Sepse në mungesën e këtij urdhri, nëse nuk do të ngrihej një popull për të vënë drejtësinë, do të rrëzoheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Kështu që, ai mysliman që ngrihet për të luftuar me atë që ndërhyt në çështjen e fesë, ai nuk e ndihmon thjesht veten, por i mbron të gjitha fetë. Prandaj, edhe Allahu me siguri do ta ndihmojë atë. Allahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm, kështu që, edhe ai do të fitojë nga fuqia e Allahut. Sepse, një mysliman i tillë e bën këtë luftë duke menduar se kur të fitojë, ai mund të falë namazet me xhemat, të paguajë zekatin, t'i këshillojë njerëzit e tjerë për të mirat dhe t'i ndalojë nga të këqijat, të gjitha këto janë në fakt sipas dëshirës së Allahut dhe është Ai që jep rezultatin përfundimtar. Në këtë mënyrë Allahu tregon se ai që vepron sipas pëlqimit të Allahut, patjetër do të fitojë. Prandaj, ai nuk duhet të ketë frikë nga kundërshtimi, sado i ashpër të jetë. E vërteta u kundërshtua edhe në kohën e popullit të Nuhut a.s., Adit dhe Ibrahimit a.s., por gjithnjë fitoi e vërteta. Rrënojat e kundërshtarëve të këtyre profetëve ende gjenden në botë. Prandaj, duhet të mësoni duke parë këto shenja. Dhe nuk duhet që t'i shikoni thjesht nga sytë, por nga zemra. (Këto gjëra janë përmendur në ajetet e sures El-Haxh që i pasojnë ajetet e komentuara)

Nga këto ajete bëhet shumë e qartë se sipas mësimave të Islamit, lufta

fetare lejohet vetëm atëherë kur një popull mësyhet e sulmohet për një kohë të gjatë, dhe mizorët nuk e lejojnë të thonë se Allahu është Zoti i tij, domethënë, ndërhyjnë në çështjen e fesë së tij dhe tentojnë ta kthejnë nga feja Islame ose detyrojnë njerëzit të heqin dorë nga feja Islame, madje i vrasin nëse i afrohen Islamit, vetëm me njerëzit e tillë mund të bëhet luftë apo *xhihad* fetar. Përveç kësaj, çdo luftë tjetër do të jetë me qëllime politike ose kombëtare, e cila ka mundësi të bëhet edhe midis dy popujve myslimanë. Por një luftë e tillë nuk mund të quhet *xhihad* dhe myslimanët në përgjithësi nuk do të jenë të detyruar të marrin pjesë në të. Në të mund të luftojnë vetëm myslimanët vendas. Kjo luftë mund të jetë për atdhedashurinë, e jo për fenë. Hazret Profeti Muhammed s.a.v.s. thotë "*Hubbul vetni minal iman*", d.m.th. atdhedashuria është gjithashtu pjesë e besimit.

Në këto ajete gjithashtu është përmendur që populli i shtypur kur merr fuqinë, atëherë ai ka për detyrë t'i mbrojtë të gjitha fetë dhe të ketë parasysh respektin ndaj vendeve të tyre të shenjta. Pas fitores, ai nuk duhet ta shpërdorë pushtetin, por duhet të kujdeset për të varfrit, kombin dhe të orvatet me të gjitha mundësitë e tij për të eliminuar çrregullime dhe probleme të tjera sociale. Sepse Islami ka ardhur si fe dëshmitare dhe mbrojtëse e jo e egër dhe mizore."¹⁰

E përgatiti: Samad Ghorri

10 Mirza Mahmood Ahmad, *Tefsir-e-Kabir*, vëll. 6, f. 62-63, Kadian, shkurt, 2004

Mëshirojini banorët e tokës, që të mëshiroheni nga Ai në qiell

Disa thënie të Hazret Profetit Muhammed paqja dhe bekimet e Allahut gjithmonë qofshin mbi të



Hazret Abu Hurejrah r.z. rrëfen se Profeti i shenjtë ^{s.a.v.s.} ka thënë: Vërtet, Allahu i Madhërishëm në Ditën e Kiametit do të thotë:- O biri i Ademit, unë isha i sëmurë dhe ti nuk më vizitove? Robi do të thotë:- O Zoti im, si të të vizitoja Ty, kur Ti je Zot i të gjitha botëve? Allahu i Lartësuar do të thotë:- A nuk e ke ditur se filan robi Im ishte i sëmurë, përse nuk i bërë vizitë? A nuk e di ti se po t'i kishe bërë vizitë atij, do të Më kishe gjetur Mua aty afër tij? O biri i Ademit, Unë kam kërkuar prej teje ushqim, por ti nuk më ke dhënë! Robi do të thotë:- O Zoti im, si do të të jepja ushqim, kur ti je Zot i të gjitha botëve? Allahu i Madhërishëm do të thotë:- A nuk e ke ditur se filan robi Im të ka lypur ushqim, por ti nuk i ke dhënë! A nuk e ke ditur se po ta ushqej atë, do ta kishe marrë shpërblimin tënd prej Meje? O biri i Ademit, unë të kam kërkuar ujë, por ti nuk më ke dhënë! Robi do të thotë:- O Zoti im, si do të të kisha dhënë Ty ujë, kur Ti je Zot i të gjitha botëve? Allahu i Lartësuar do të thotë:- A nuk e ke ditur se filani robi Im të ka kërkuar ujë, por ti nuk i ke dhënë! Po t'i kishe dhënë ujë atij, ti do ta kishe marrë shpërblimin tënd prej Meje!

(Sahih Muslim, Kitabul Birri ves silah, Bab fadlu ijadatil marid)

Hazreti Abu Hurejrah r.z. rrëfen se Profeti i shenjtë s.a.v.s. ka thënë:- Me anë të lëmoshës (sadaka), nuk pakësohet pasuria e njeriut. Ai që fal gabimin e dikujt, Zoti i fal atij më shumë respekt e nder. Njeriu nuk nënçmohet kur ai fal gabimin e dikujt.

(Musnad Ahmad bin Hanbal, vol. 2, f. 235)

Hazret Abdullah bin Masudi r.z. rrëfen se Profeti i shenjtë s.a.v.s. ka thënë:- Allahu thotë: Të gjitha krijesat e Mia janë familja Ime. Pra, Allahu e do më shumë atë njeri prej krijesave të Tij që sillet mirë ndaj familjes (krijesave) së Tij dhe ua plotëson nevojat e kërkesat e tyre.

(Mishkatul Mesabih, vol. 2, f. 217, Kitabul aadab, Bab esh-shefkah, ver-rehmah alal khelk, El-fesluth-thalith, hadithi 4998, Darul kutub El-ilmija, Bejrut, 2003)

Hazreti Abdullah bin Amr r.z. rrëfen se Profeti i shenjtë s.a.v.s. ka thënë:- Allahu xh.sh. do t'i mëshirojë ata që mëshirojnë. Mëshirojini banorët e tokës, që të mëshiroheni nga Ai në qiell.

(Sunan Abu Daud, Kitabul Adab, Bab fir rrahmah)

Abdur Rahman bin Abi Lejla rrëfen se Sahl bin Hunejfi dhe Kejs bin Sa'di ishin të ulur në vendin e quajtur Kadsia, kur pranë tyre kaloi një xhenaze. Ata të dy u ngritën në këmbë. Kur atyre u tha se kjo është xhenaze e një dhimmiu (jomyslimani), ata të dy thanë:- Një herë kaloi një xhenaze pranë Profetit të shenjtë s.a.v.s., ai u ngrit në këmbë për ta nderuar atë. Atëherë i ishte thënë: Kjo është xhenaze e një çifuti. Duke dëgjuar këtë, Profeti i shenjtë s.a.v.s. tha:-

“A nuk ishte edhe ai njeri!”

(Sahih Buhari, Kitabul Xhenaiz, Bab man kama lixhenazati jehudi, hadithi 1312, Darul Kitab El-Arabi, Bejrut, botimi i parë, 2004)



Ç'është xhihadi dhe pse ISLAMI pati nevojë për të?

Disa thënie të Hazret Mesihut të Premtuar a.s.

Hazret Mesihu i Premtuar, themeluesi i Xhematit Mysliman Ahmadia a.s., duke shpjeguar çështjen e xhihadit, thotë:

“Shumë njerëz të kësaj epoke dhe të kohës së mesjetës nuk e kuptuan filozofinë e çështjes së xhihadit e realitetin e tij, dhe bënë shumë gabime, pasi ajo është një çështje shumë delikate. Dhe na vjen turp për të pranuar faktin se për shkak të gabimeve të tyre fatale, armiq të Islamit gjetën rast për të sulmuar pandershmërisht një fe të tillë kaq të pastër e të shenjtë si Islami, që është vetëm pasqyra e ligjit të natyrës dhe që shfaq madhështinë e Zotit të Gjallë. Duhet të dini se fjala “*xhihad*” është e prejardhur nga fjala “*xhuhd*”, që do të thotë “*me u përpyk*”. Kjo fjalë me kuptim figurativ u përdor për luftërat fetare...

Këtu do t'i përgjigjemi pyetjes se **ç'është xhihadi dhe pse Islami pati nevojë për të?** Duhet bërë e qartë se feja Islame, që nga fillimi i saj hasi shumë probleme, dhe të gjitha grupet e tjera ishin bërë armiq të saj. Është e zakonshme që kur vjen ndonjë profet apo peygamber nga Zoti i Madhërishtëm, ai krijon një grup njerëzish, që jobesimtarëve u

duket, i drejtë, përparimtar dhe me vullnet shumë të fortë. Atëherë, grupe të tjera jobesimtarësh fillojnë ta shikojnë me lakmi dhe sigurisht që lind në zemrat e tyre njëfarë armiqësie ndaj grupit të profetit. Sidomos, dijetarë të feve të ndryshme dhe ata që ruajnë karriget e tyre, inatosen ashpër me të... dhe duke iu nënshtruar plotësisht *nefsit* që urdhëron për të keqen, bëjnë komplete për të krijuar sherr. Madje disa prej tyre e kuptojnë që ata kot po i sjellin dëm një robi zemërmirë të Zotit dhe kështu do të jenë nën zemërimin e Zotit, edhe veprat e tyre që bëjnë vazhdimisht kundër tij, i dëshmojnë qartë vetes gjendjen mëkatore të zemrës së tyre. Por, megjithëkëtë, zjarri i fortë i lakmisë i merr dhe i çon ata në poshtërsi të thella armiqësore. Pikërisht këto kanë qenë shkaqet edhe në kohën e Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s. të cilat jo vetëm që i ndaluan dijetarë të krishterë, hebrenj dhe idhujtarë të Mekës nga pranimi i së vërtetës, por i nxitën në armiqësi të thellë. Atëherë, ata mendonin të bënin çdo gjë për ta çrrënjësuar Islamin nga faqja e dheut. Ngaqë në numër myslimanët ishin pak në fillim, andaj këto grupe kundërshtarë, të cilat për shkak të mendjemadhësisë që u rrënjosej në zemrat e në trutë e tyre, gjithnjë i jepnin

epërsi vetes qoftë në pasuri, qoftë në nder qoftë në numrin e tyre të bollshëm. Madje, filluan një armiqësi të hidhur kundër myslimanëve, domethënë es'habëve të Profetit Muhammed s.a.v.s., pasi kundërshtarët mizorë nuk e donin që ky filiz i ri që ishte mbjellë nga qielli të rrënojesej. Ata u përpoqën deri në fund për t'i zhdukur myslimanët e drejtë, duke u bërë atyre tortura më të rënda, sepse kishin frikë se forcimi dhe përparimi i myslimanëve do t'ia ndillte vdekjen fesë e popullit të tyre. Për shkak të kësaj frike, ata i vranë barbarisht shumë myslimanë. Për një kohë shumë të gjatë që përfshihet gjatë trembëdhjetë viteve, robërit besnikë të Zotit dhe krenaria e njerëzimit, vazhduan të copëtoheshin pa mëshirë nga shpatat e jomyslimanëve. Pastaj edhe fëmijët e tyre jetimë, gratë e tyre të paafata e të shkreta vriteshin nëpër rrugicat e Mekës. Edhe atëherë urdhri i Zotit për ta, në mënyrë të prerë, ishte se nuk duhej t'i përgjigjeshin së keqes me të keqen. Kështu që, të nderurit e të devotshmit e Zotit e zbatuan porosinë e Tij fjalë për fjalë. Qoshet dhe skutat janë lyer me gjakun e tyre, por ata nuk e kundërshtuan. Ata u flijuan si kurban por nuk u ankuan. Profetin e shenjtë të Zotit, mbi të cilin shumë selame qofshin nga qielli e nga toka, shpesh e qëlluan me gurë dhe trupin e tij të bekuar e bënë gjak, por ai njeri, si një mal i së vërtetës dhe këmbënguljes, i priti zemërhapur të gjitha ato lëndime. Armiqtë ua shtonin vazhdimisht torturat, vetëm duke parë durimin dhe modestinë e tyre të pashembullt. Si të thuash, ata në të vërtetë i kishin bërë gjuhë myslimanët. Atëherë Zoti që nuk donte që armiqtë t'i kalonin të gjitha kufijtë e dhunës dhe as nuk mund t'i linte robërit e Tij të shtypur e të shkretë, nëpërmjet fjalëve

të Tij të bekuara që janë në Kuranin e Madhërishëm, i njoftoi se Zoti e vrojtonte çdo gjë që u bëhej dhe tani u jep leje për t'iu përgjigjur sulmeve të armikut dhe se Ai është Zoti i Plotfuqishëm që nuk i lë mizorët pa marrë hakun. **Ky urdhër u quajt Xhihad.** Fjalët origjinale të kësaj shpalljeje ende janë ruajtur në Kuranin e Madhërishëm, ku thuhet:

"Atyre që janë sulmuar, u lejohet (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi. Në të vërtetë Allahu është i Fuqishëm që t'i ndihmojë ata, që janë dëbuar nga shtëpitë e tyre padrejtësisht,"¹

("Government angrezi aur xhihad", "Ruhani Khazain", vëll. 17, f. 1-4)

"Betejat e Profetit të shenjtë s.a.v.s. dhe të es-habëve të tij kanë pasur qëllim që të mbroheshin nga sulmet e mosbesimtarëve, ose për të vendosur paqe apo për t'i mposhtur me shpatë ata që donin ta pengonin fenë me shpatë. Mirëpo, sot cili prej armiqve e nxjerr shpatën për të penguar fenë? Kush e pengon dikë që të bëhet mysliman, dhe kush pengon që të thirret ezani në xhami?"

("Tirjakul Kulub" f. 16, "Ruhani Khazain", vëll. 15, f. 158-159)

"Ata që edhe duke e quajtur veten myslimanë, kujtojnë se fenë Islame duhet ta përhapim me shpatë e nuk i dinë fare të mirat dhe dobite të kësaj feje ndërsa veprimtaria e tyre ngjan me atë të egërsirave."

("Tirjakul Kulub" f. 16, "Ruhani Khazain", vëll. 15, f. 167)

"Mesihu i Premtuar erdhi në këtë botë që ta hedhë poshtë mendimin për

¹ El-Hexh 22:40-41

të përdorur shpatën në emrin e fesë. ... Tani Zoti dëshiron dhe ka vendosur që t'i largojë të gjitha akuzat që i janë vënë trupit të pastër të fesë Islame nga njerëz të pandershëm.”

(“Malfuzat”, vëll. 3, f. 176)

“Kjo mënyrë e xhihadit, të cilën e ndjekin shumë njerëz të egër të kësaj kohe, nuk është aspak islamike. Madje kjo mënyrë barbare, që është përhapur te disa myslimanë, vjen si rezultat i *nefsit* të tyre që urdhëron për të keqen ose ajo është e shkaktuar nga lakmia e tyre e kotë për ta arritur xhenetin.”

(“Government angrezi aur xhihad”, “Ruhani Khazain”, vëll. 17, f. 9-10)

“Unë e di shumë mirë se kush jemi ne e kush është Xhemati ynë. Ndihma e përkrahja e Allahut të Madhërishëm do të manifestohet për ne, atëherë kur do të ecim rrugës së drejtë dhe do ta ndjekim plotësisht e sinqerisht Profetin e shenjtë s.a.v.s.; kur mësimin e pastër të Kuranit do ta bëjmë *modus operandi* (metodë pune) për vete, dhe t'i verifikojmë këto mësim me anë të veprave e gjendjeve tona, jo thjesht me fjalë boshe. Nëse ne do ta zgjedhim këtë qëndrim, atëherë, me bindje të plotë mbani në mend se nëse të gjithë njerëzit së bashku do të dëshirojnë të na shkatërrojnë, ne nuk do të shkatërrohemi, sepse Allahu i Madhërishëm është me ne. *Inshallah*.”

(Gazeta “El-Hakam”, 24 shtator, 1904, f. 4)

“...Mbanimendse Allahui Madhërishëm e do shumë bamirësinë. Dhe Ai dëshiron që të keni simpati ndaj krijesave të Tij. Sepse nëse Atij do t'i pëlqente keqbërësja,

Ai do të na urdhëronte për këtë, mirëpo Allahu është i Madhëruar dhe është larg kësaj të mete. ... Pra, ju të gjithë që keni krijuar një lidhshmëri me mua, mbani mend se duhet të silleni mirë ndaj çdo njeriu, pa marrë parasysh se cilës fe i takon ai, dhe duhet të bëni bamirësi ndaj çdo njeriu, sepse ky është mësimi i Kuranit të Shenjtë:

“Ata, për hir të dashurisë së Zotit, i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të robëruarit.”²

Ata skllëvër dhe robër (në kohën e Profetit të shenjtë ^{s.a.v.s.}) që vinin, më shumë ishin mosbesimtarë. Tani, ju mund të shihni se sa e madhe dhe e përkushtuar në Islam është simpatia ndaj njerëzve. Sipas mendimit tim, mësimi i përsosur moral nuk është askund përveç në Islam. Kur unë të shërohem e të përmirësohet shëndeti im, unë *Inshallah* do të shkruaj një traktat rreth mësimave morale, sepse dëshiroj t'i sqaroj qartazi qëllimet e mia, ndërkohë ky traktat do të jetë një mësim e udhëzim i kuptueshëm për Xhematin tim, dhe t'i paraqes e t'i nënvizoj rrugët e pëlqimeve të Allahut të Lartësuar. Unë pikëllohem thellë kur shikoj ose dëgjoj se filani bën këtë apo atë punë që nuk u përshtatet mësimave të Islamit. Unë nuk kënaqem me këto gjëra. Unë akoma e shoh Xhematin tim si një foshnjë që bën dy hapa e rrëzohet katër herë. Mirëpo, unë kam besim të plotë se Allahu i Lartësuar këtë Xhemat do ta bëjë të përsosur. Prandaj, duhet që edhe ju të bëni përpjekje, të mundoheni e të rrini të angazhuar në lutje që Allahu xh.sh. të tregojë mëshirën e Vet, sepse asgjë nuk është e mundur pa mëshirën e Tij. Kur Ai mëshiron, hapen të gjitha rrugët.”

(“Malfuzat”, vëll. 4, f. 218-219, Indi, 2003)

“Mbani mend se janë dy urdhra të Allahut të Madhërishëm. Së pari, mos i vini Allahut ndonjë partner, as në qenien e Tij e as në atributet e Tij. Së dyti, silluni mirë e me dashamirësi ndaj krijesave të Zotit. Të jesh mirënjohës, nuk do të thotë që ti të sillesh mirë e me mirënjohje vetëm ndaj vëllezërve e ndaj pjesëtarëve të farefisit tënd, por të sillesh me mirënjohje ndaj çdokujt prej krijesave të Allahut të Madhërishëm. Mos

mendoni se ai është hindu

apo i krishterë. Unë

me të vërtetë ju

them se Allahu i

Madhërishëm

e mori

përsipër vetes

përgjegjësinë

që t’ju sigurojë

drejtësinë; Ai

nuk dëshiron që ju

ta mbani atë. Sa më

butë të silleni e sa më

shumë të shfaqni përlulësi,

aq më shumë do të gëzohet Zoti

me ju. Armiqtë tuaj ia dorëzoni Allahut

xh.sh. Dita e Kiametit është afër. Ju nuk

duhet të brengoseni për shkak të atyre

dhimbjeve e vuajtjeve që ju sjellin armiqtë

tuaj. Unë shoh dhe perceptoj se ju do të

ballafaqoheni më shumë me vështirësi e

me vuajtje nga duart e tyre, sepse gjuha e

atyre që del jashtë rrethit të civilizimit e

të edukimit punon aq egërsisht, mu ashtu

sikurse çahet ndonjë digë nga ku rrjedh

ujë furishëm. Njeriu i dëlirë dhe i pastër

duhet t’i kontrollojë fjalët e tij.”

(“Malfuzat”, vëll. 9, f. 164-165, Angli, 1984)

“Pra, simpatia ndaj krijesave të Zotit është një gjë e tillë, të cilën nëse njeriu e braktis dhe largohet prej saj, atëherë ai dalëngadalë bëhet shtazë e egër. Njerëzimi kërkon që njeriu mund të quhet njeri derisa sillet mirë, me simpati e me mirënjohje ndaj vëllait të vet, duke mos bërë dallim me askënd. Siç ka thënë Sadiu:

Qeniet njerëzore janë si organe të një trupi.

Mbani mend, rrethi i

simpatisë, sipas meje,

është një rreth shumë

i madh. Njeriu nuk

duhet të përjashtojë

asnjë popull e asnjë

individ nga ky rreth.

Unë nuk dëshiroj të

them, siç thonë të

paditurit e kësaj kohe,

që ju ta veçoni e ta

kufizoni simpatinë tuaj

vetëm për myslimanët. Jo,

por unë ju them që të silleni

mirë e me simpati ndaj të gjithë

njerëzve të Zotit, edhe në qoftë se ai është

hindu ose mysliman apo i takon ndonjë

feje tjetër. Unë nuk e vlerësoj fjalën e

atyre njerëzve që dëshirojnë ta kufizojnë

simpatinë e tyre vetëm për popullin e

vet.”

(“Malfuzat”, vëll. 4, f. 216-217, Indi, 2003)

Hazret Muhammedi, Profeti i pages

paqja dhe mëshira e Allahut gjithmonë qofshin mbi të

Fjalimi i së premtes i Hazret Kalifit të Pestë të Mesihut të Premtuar i mbajtur më 10 mars të vitit 2006

Unë, edhe më parë kam folur disa herë lidhur me akuzat e ngritura nga ana e jomyslimanëve kundër Profetit të shenjtë s.a.v.s. që thonë se ai, *naudhubillah* (d.m.th. *kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga kjo ide*), e solli një fe që asgjë nuk mban më vete, përveç ashpërsisë, vrazhdësisë, vrasjes e shkatërrimit, dhe se në Islam nuk ka ndonjë koncept të tolerancës fetare, të vetëpërmbytjes e të lirisë. Për këtë arsye, ndikimet e këtij mësimi janë bërë pjesë psikike e myslimanëve. Në këtë pikëpamje, unë edhe më parë kam folur disa herë se, fatkeqësisht, ka disa elementë dhe grupe në mesin e myslimanëve, që bëhen shkak për lindjen dhe krijimin e këtij koncepti. Fatkeqësisht, kjo ishte ideologjia e këtyre myslimanëve që i dha rast botës jomyslimane, veçanërisht në Perëndim, që të thotë mendime absurde, shumë të paturpshme e të neveritshme për Profetin tonë të dashur s.a.v.s. Sidoqoftë, ne jemi të vetëdijshëm se aktet e këtyre sekteve e grupeve janë tërësisht kundër mësimëve të Islamit e kundër rregullave të sjelljes. Mësimet e Islamit, në të vërtetë, janë aq

të bukura e tërheqëse saqë asnjë person i paparagjykuar nuk mund të mbetet pa u ndikuar nga bukuria e tyre.

Mësimi i bukur i Islamit lidhur me sjellje të mira ndaj jomyslimanëve

Kurani i Shenjtë në mënyrë përsëritëse paraqet mësimet të bukura të Islamit lidhur me sjellje të mira ndaj jomyslimanëve. Islami bën porosi që të ruhen të drejtat e tyre, që ndaj tyre të sillen me drejtësi e me paanësi, që t'u jepet liria fetare, dhe nuk duhet të shtrëngohen në çështje të fesë, etj. Aty ka shumë porosi lidhur me myslimanët e me jomyslimanët. Pa dyshim, në Kuran lejohet që të bëhet luftë në rrethana të veçanta; ajo lejohet vetëm në rast se armiku të sulmon e fillon luftën, prish marrëveshje, bën padrejtësi brutale ose bëhet tiran. Po edhe në këto rrethana dhe në këto situata, asnjë grup ose parti e ndonjë vendi nuk ka të drejtë të bëjë luftë, por kjo është detyra e një qeverie që të marrë vendim se si mund t'i jepet fund tiranisë. Kjo nuk është detyra



Hazret Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar a.t.b.a. duke mbajtur fjalimin e të premtës në xhaminë e Bejtulfutuhut të Londrës

e ndonjë organizate xhihadi që ta marrë përsipër këtë çështje.

Modeli shembullor e i shkëlqyer i sjelljeve të Profetit të shenjtë s.a.v.s. përskundër mizorive e padrejtësive të mosbesimtarëve të Mekës e të armiqve të Islamit

Edhe në kohën e Profetit të shenjtë s.a.v.s. janë krijuar rrethana të veçanta të luftërave, që i detyruan myslimanët të luftonin për mbrojtjen e tyre. Sidoqoftë, siç thashë, organizata xhihadi në këtë kohë, me parulla e aksione të tyre militante, pa ndonjë arsye e autoritet ligjor, iu dhanë rast e inkurajim të tjerëve, që ta sulmonin Profetin e shenjtë s.a.v.s. me sulme të paturpshme e të neveritshme, dhe vazhdojnë ta sulmojnë edhe sot. Ndërsa, Profeti i shenjtë

s.a.v.s. ishte personifikim i mëshirës; një mirëbërës ndaj njerëzimit dhe një mbrojtës i madh i të drejtave njerëzore, që nuk e humbiste asnjë shans për t'i sjellë dobi edhe armikut, bile edhe në kohën e ndonjë beteje. Çdo hap i jetës së tij, çdo vepër e tij, në të vërtetë çdo moment i jetës së tij është një dëshmi e plotë, që e vërteton dhe e saktëson faktin se ai ishte personifikim i përkryer i mëshirës me një zemër që i tejkaloi të gjithë të tjerët, në plotësimin e kërkesave të mëshirës e të dhembshurisë. Ai veproi ashtu në kohën e paqes, gjatë luftërave, në vendin e tij e jashtë vendit, në punë të përditshme e në vlerësimin e marrëveshjeve të bëra me njerëzit e feve të tjera. Ai i vendosi standarde të larta të lirisë së ndërgjegjes dhe të tolerancës fetare. Ai kur hyri në Mekë si një ngadhënjimtar e pushtues i madh, por ai i fali njerëzit e pushtuar dhe ua dha lirinë e pakufizuar fetare. Kështu ai

krijoi një shembull të shkëlqyer lidhur me këtë mësim të Kuranit të Shenjtë:

Nuk ka dhunë në çështjen e fesë

(El-Bekare, 2:257)

Besimi fetar është çështja e zemrës dhe e mendjes së çdo njeriu. Unë dëshiroj vetëm që ju ta pranoni fenë e vërtetë, e kështu do ta bëni jetën tuaj më mirë në këtë botë e në botën e Ahiretit, e do të siguroni falje për vete. Mirëpo, unë ju them troç se në çështje të fesë nuk ka shtrëngim. Vërtet, e tërë jeta e Profetit është e mbushur me ngjarje të tilla të tolerancës, të lirisë fetare e të ndërgjegjes. Disa prej atyre ngjarjeve unë do t'i përmend këtu. Periudha 13 vjeçare e vështirësive dhe e vuajtjeve në Mekë, pas deklaratës së tij, se është Profeti i Zotit, njihet prej të gjithëve. Profeti i shenjtë s.a.v.s. dhe es-habët e tij i duruan torturat e vuajtjet e mëdha. Banorët e Mekës i shtrinin ata në zallin përcëllues të mesditës dhe gurë të nxehtë u viheshin mbi gjokset e tyre. Ata u rrahën me kamxhik. Ata ua vrisnin gratë, duke i çjerrë këmbët e tyre. Ata u vranë e u bënë martirë. Edhe vetë Profeti i shenjtë u bë shenjë e sulmit të tyre. Një herë, kur ai falte namazin, dikush i vuri plancin e një deveje mbi shpinën e tij, e ai nuk mundi të çohet nga pesha e asaj. Gjatë vizitës së tij për në Taif, fëmijët e qëllonin me gurë, përdornin kundër tij një gjuhë banale e fjalë shumë të turpshme, kurse prijësit e tyre i inkurajonin e i nxisnin ata. Ai u plagos aq shumë sa që u zhyt në gjak, sa edhe këpuçët e tij u mbushën me gjak. Po ashtu, në Sho'b Abi Talib, ai me familjen dhe me ithtarët e tij u rrethua për disa vjet. Ata nuk kanë pasur me vete as ushqim për të ngrënë e as ujë për të pirë. Edhe fëmijët vdisnin urie. Një *sahabi* (shok i Profetit

s.a.v.s.) në errësirën e natës ndjeu diçka të butë nën këmbët e veta, të cilën ai e mori dhe e futi në gojë, duke menduar se është një gjë për të ngrënë. Kjo ishte gjendja e tyre e urisë dhe e shtrëngimit. Një gjendje mjaftë dëshpëruese. Më në fund, të shtrënguar e të detyruar nga këto rrethana, ata vendosën të migronin për në Medinë. Por armiku nuk i la ata të qetë edhe gjatë largimit edhe pasi arritën në Medinë, e sulmuan qytetin. Ata u përpoqën që t'i nxisnin çifutët e Medinës kundër tyre. Pra, në rrethana të tilla, për të cilat kam folur shkurtimisht, nëse krijohet situata e luftës, dhe i shtypuri ta ketë mundësinë t'ia kthejë përgjigjen tiranit, atëherë edhe ai në raste të tilla bën përpjekje që t'i japë përgjigje tiranit me dhunë. Thuhet se çdo gjë lejohet në luftë. Mirëpo, Profeti ynë s.a.v.s. vendosi standarde të larta të mëshirës e të zemërbutësisë edhe në këto situata. Kishte kaluar një kohë shumë e shkurtër, qëkurse ata dolën nga Meka, dhe plagët e vuajtjeve e të torturave akoma ishin të freskëta. Profeti i shenjtë s.a.v.s. e ndjente dhembjen e ithtarëve të vet më shumë se sa dhembjen e tij, prapëseprapë ai nuk i shkeli mësimet, principet e porositë islamike. Ai nuk i prishi cilësitë e veta dhe moralet e larta të qenësishme dhe që ishin pjesë e mësimëve të tij. Ju mund të shihni se çfarë bëjnë këto shtete Perëndimore kundër atyre me të cilët janë duke bërë luftë, dhe shikojeni, në krahasim të sjelljeve të tyre, modelin e bekuar e të shkëlqyer të Profetit të shenjtë s.a.v.s. Lidhur me këtë, ka një hadith që e ruan historinë e asaj kohe.

Në luftën e Bedrit, vendi ku trupat myslimanë zbritën, nuk ishte ndonjë vend i përshtatshëm. Hubab bin Munzeri e pyeti Profetin e shenjtë s.a.v.s., duke iu drejtuar atij:- O Profet i Allahut xh.sh.,

vendimin për zgjedhjen e këtij vendi a e more në bazë të shpalljes Hyjnore, apo e zgjodhe vetë nga pikëpamja strategjike? Profeti i shenjtë s.a.v.s. iu përgjigj:- E zgjodha këtë vend nga pikëpamja strategjike, meqë gjendet në një lartësi dhe mendoj se do të jetë i përshtatshëm. Ai i tha: Ky nuk është një vend i përshtatshëm. Më mirë të shkojmë te burimi i ujit e ta zëmë atë, duke bërë një rezervuar. Në këtë rast ne do të kemi mundësi të pimë ujë, ndërsa armiku jo. Duke dëgjuar këtë, ai tha:- Mirë, pajtohem me ju. Prandaj, ata u nisën në drejtim të ujit e zbritën atje. Pas një kohe të shkurtër, disa njerëz nga fisi Kurejsh erdhën që të merrnin ujë. Es-habët u munduan t'i pengonin ata që të merrnin ujë, mirëpo Profeti i shenjtë s.a.v.s. u tha:- Mos i pengoni, i lejoni të marrin ujë.

(Es-Siratun Nabëvijah, li ibni Hesham, f. 424, Gezvah Bedr El-Kubra, mashvarah, El-Habab Ala Rasulilahi s.a.v.s., Darul Kutub El-ilmijjah, Bejrut, botimi i parë, 2001)

Islami nuk është përhapur me tehun e shpatës, por me anë të sjelljeve, moraleve të larta, me anë të mësimave të veta dhe me anë të lirisë së ndërgjegjes e të fesë

I tillë ishte standardi i lartë i karakterit të Profetit të shenjtë s.a.v.s., që ai e shfaqte edhe ndaj atyre armiqve, të cilët para pak kohe i kishin bllokuar furnizimin e ushqimit e të ujit për fëmijët myslimanë. Duke e lënë anash këtë, ai nuk i pengoi fare ata ushtarë armiq që kishin ardhur për të marrë ujë nga rezervuari që ishte nën kontrollin e tij, sepse një gjest i tillë ishte kundër normave të moralit. Akuza më e rëndë që ngrihet kundër Islamit është se ai është përhapur *me tehun e shpatës*.

Njerëzit që kishin ardhur te çezma për të marrë ujë edhe mund të torturoheshin që të mos merrnin ujë dhe mund të shtrëngoheshin që t'i pranonin disa kushte të besimtarëve. Paganët e Arabisë në shumë beteja kishin vepruar në këtë mënyrë. Mirëpo, Profeti i shenjtë s.a.v.s. nuk veproi kështu. Në këtë rast mund të thuhet se ai e mori këtë hap për shkak se pozita e myslimanëve ishte shumë e dobët e ata nuk kishin fare forca e fuqi, ndaj për t'iu shmangur luftës, ishte bërë ky lëshim mirënjohje. Mirëpo, kjo nuk është e vërtetë. Të gjithë myslimanët, bile edhe fëmijët, e dinin shumë mirë se paganët e Mekës ishin të etshëm për gjakun e myslimanëve, bile kur ata shihnin myslimanë, zemëroheshin aq shumë sa që u zbriste gjak në sytë e tyre. Prandaj, askush nuk ka pasur ndonjë mendim të tillë të vetëkënaqësisë, e veçanërisht kur është fjala për Profetin e shenjtë s.a.v.s. Gjithçka që ai bëri dhe sjelljet e mëshirës e të zemërgjerësisë që i shfaqti, ishte vetëm për shkak se ai kishte mëshirë për tërë njerëzimin, se ai vendosi në botë vlerat njerëzore, sepse ai, pa dyshim, kishte për detyrë që t'ia paraqiste botës atë mësim me anën e të cilit do të njiheshin vlerat morale e njerëzore islamike.

Aty ka një ndodhi të një armiku të Islamit që ishte dënuar me vdekje. Atij jo që ju fal jeta prej Profetit të shenjtë s.a.v.s., por i ishte dhënë liri që ta praktikonte fenë e vet, duke jetuar në mesin e myslimanëve. Këtë ngjarje e përmend këtu:

Ikramah, biri i Ebu Xhehlit, luftoi, si babai i vet, gjatë tërë jetës kundër Profetit të shenjtë s.a.v.s. Në kohën e fitores së Mekës, megjithëse Profeti i shenjtë s.a.v.s. kishte deklaruar amnisti të përgjithshme, sulmoi me anë të një trupi ushtarësh dhe shkaktoi gjakderdhje në Kaba (Qabe). Për shkak të këtyre krimeve të luftës, Ikramah ishte i dënuar me vdekje. Meqë, në atë

kohë, askush nuk mund të qëndronte para myslimanëve, edhe ai, për të shpëtuar jetën, iku në drejtim të Jemenit. Gruaja e tij erdhi te Profeti i shenjtë s.a.v.s. dhe kërkoi falje për të, dhe Profeti i shenjtë s.a.v.s., duke shfaqur mëshirë dhe bujari e fali. Mandej, ajo shkoi mbas burrit të saj që t'i tregonte se Profeti i shenjtë s.a.v.s. e ka falur atë dhe pastaj ta merrte me vete. Ikramah nuk mund ta besonte se Profeti i shenjtë s.a.v.s. e ka falur, pavarësisht nga fakti se ai kishte bërë mizori e padrejtësi të mëdha, kishte vrarë shumë myslimanë dhe kishte luftuar deri në ditën fundit; si pra mund të falej ai? Sidoqoftë, gruaja e bindi disi atë dhe e solli prapë në Mekë. Kur Ikramah erdhi në oborrin e Profetit të shenjtë s.a.v.s. që të vërtetonte këtë lajm se, a në të vërtetë e kishte falur atë, duke bërë ndaj tij një mirënjohje aq të madhe. Profeti i shenjtë s.a.v.s. së pari u ngrit në shenjë respekti ndaj Ikramahut, sepse ishte prijësi i popullit armik, ndaj duhej të nderohej. Mandej, Ikramahut i tha se unë vërtetë të kam falur ty.

(Muatta Imam Malik, Kitabun Nikah, Nikahul mushriki idha aslamat zeuxhatuhu kablahu, hadithi 1156, Darul Fikr, Bejrut, botimi i tretë, 2002)

Ikramahu kërkoi një sqarim prej tij: A më fale edhe pse dua të qëndroj në fenë time? Kjo do të thotë se ai nuk e kishte pranuar fenë Islame dhe qëndronte në fenë e tij të idhujtarisë. Profeti i shenjtë s.a.v.s. i tha:- Po, unë të kam falur. Duke dëgjuar këtë, Ikramahu bërtiti me zë e duke iu drejtuar Profetit të shenjtë s.a.v.s. i tha:- O Muhammed, ti me të vërtetë je shumë i mëshirshëm, zemërhapur, i dhembshur dhe i sjellshëm ndaj farefisit tuaj. Pra, duke e parë mrekullinë e moralit të shkëlqyer e të mirënjohjeve të tij, Ikramahu e përqafoi fenë Islame.

(Es-Siratu Halabiah, vol. 3, f. 132, Bab dhikru magaziah s.a.v.s. fet'h makkah sharrafahallahu ta'ala, Darul Kutub El-Ilmijjah, Bejrut, botimi i parë, 2002)

Po, në këtë mënyrë, është përhapur Islami; me sjellje shembullore e me lirinë e ndërgjegjes e të fesë. Pra, kjo ishte shigjeta e sjelljeve të shkëlqyera dhe e lirisë së fesë që e mposhti personin si Ikramahu! Profeti i shenjtë s.a.v.s. të burgosurve dhe skllëvërve u kishte dhënë leje e liri të plotë fetare, ndërsa përhapja e mesazhit të Islamit ishte në bazë të porosisë Hyjnore që të përhapeshin mësimet e Islamit ndër ata që nuk dinin gjë për to. Dhe qëllimi kryesor ishte që njerëzit t'i afroreshin Zotit, dhe po ashtu kjo propagandë bëhej në favor të tyre.

Një ngjarje e një të burgosuri shënohet si vijon:

Seid bin Abi Seidi rrëfen se ai dëgjoi Abu Hurejrahun r.a. duke thënë se kur Profeti i shenjtë s.a.v.s. dërgoi një ekspeditë në drejtim të Nexhdit, që zunë një njeri nga fisi Banu Hanifah, i quajtur Thumama bin Athal. Ata e sollën me vete dhe e lidhën me një shtyllë të xhamisë. Atëherë Profeti i Shënjtë s.a.v.s. doli para tij dhe i tha:- Ç'mendon ti, o Thumama, si do të sillemi me ty? -Kam mendim të mirë, tha ai. Nëse do të më vrasësh, ke vrarë njeriun e gjakut; po nëse më fal, atëherë do të falësh një njeri që do të jetë mirënjohës. Nëse ti dëshiron pasuri, merr sa të duash (populli i tij mund të jepte shumë pasuri për hir të tij). E lanë ashtu deri sa agoi dita e re. Profeti i shenjtë s.a.v.s. doli para tij e i tha:- Ç'mendon ti, o Thumama? -Ashtu siç të thashë dje, dha përgjigje ai. Mandej, e lanë ashtu. Prapë në ditën e tretë,

Profeti i shenjtë s.a.v.s. doli përsëri para tij dhe i tha:- Ç'mendon ti, o Thumama? -Unë të thashë çfarë desha unë. Nëse do të më falësh, do të falësh një njeri që do ta çmojë mirënjohjen tënde, tha ai. Profeti i shenjtë s.a.v.s. dha urdhër që ai të lirohej. Prandaj, ata e liruan. Ai shkoi në kopshtin e hurmave afër xhamisë dhe u la, pastaj hyri prapë në xhami dhe tha *shehadetin*:

Unë dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut xh.sh., dhe tha:- O Muhammed, pasha Zotin, nuk ka pasur ndonjë fytyrë në tokë që e kam urreyer më tepër se fytyrën tënde, kurse tani fytyra jote është bërë për mua fytyra më e dashur; pasha Zotin, nuk ka pasur fe që e kam urreyer më shumë se fenë tënde, por tani feja jote është bërë për mua feja më e dashur; pasha Zotin, nuk ka pasur në sy të mi qytet më të urreyer se qyteti yt, mirëpo tani qyteti yt është bërë për mua qyteti më i dashur. Kalorësit e tu më zunë, kur unë desha të shkoja për në *Umra*. Ç'thua, o Profeti i shenjtë s.a.v.s.? Ai e përgëzoi dhe e uroi se e përqafoi fenë Islame, dhe e porositi që të shkonte për *Umra*. Kur arriti në Mekë, dikush i tha: Ti je bërë *sabi* (pafe). Ai iu përgjigj:- Jo, pasha Zotin, por, përkundrazi, e përqafova Muhammedin, të Dërguarin e Allahut. Ju, pasha Zotin, nuk do të merrni asnjë kokërr gruri në Jamama, derisa nuk jep leje Profeti i shenjtë s.a.v.s.

(Sahih Buhari, Kitabul Maghazi, Bab vefdi bani hanifah, ve hadith Thama bin Ethal,, hadithi 4372, Darul Kutub El-Arabi, Bejrut, botimi i parë, 2004)

Në një hadith tjetër rrëfëhet se kur ai shkoi për në *Umra*, mosbesimtarët e Mekës u përpoqën ta rrihnin ose e rrahën, ai tha se ju nuk do të merrni

asnjë kokërr gruri, derisa nuk jep leje Profeti i shenjtë s.a.v.s. Pra, ai shkoi te populli i tij dhe eksporti i drithit u ndërpre. Situata u keqësua mjaft. Mandej, Abu Sufjani shkoi te Profeti i shenjtë s.a.v.s. me kërkesë që të lejohet eksporti i grurit, sepse njerëzia filloi të vdiste urie; dhe kërkoi mëshirë për popullin e vet. Profeti i shenjtë s.a.v.s. nuk tha që ju do ta merrni drithin vetëm atëherë kur të pranoni Islamin. Por, përkundrazi, ai i dërgoi një mesazh Thumamait që të mos e ndalojë eksportimin e drithit, sepse ky është një akt tiranie. Kjo është padrejtësi. Fëmijët, të rinjtë, pleqtë e të sëmurët kanë nevojë për ushqim dhe duhet t'u sigurohet.

(Es-Siratun Nabëvijah, li Ibni Hesham, f. 888, uthira Thumama bin Ethal El-henfi ve Islamuhu, Darul Kutub El-ilmijjah, Bejrut, botimi i parë, 2001)

Tani, shihni se Thumamait nuk i ishte thënë se ti tani je nën kontrollin tonë, pranoje Islamin. Përkundrazi, ai ishte sjellë shumë mirë gjatë atyre tri ditëve, e mandej standarde më të larta të sjelljes janë shfaqur ndaj tij kur e liruan atë. Po ashtu, në anën tjetër, edhe Thumamah kishte largpamësi e urtësi sa që menjëherë pas lirimit, e dorëzoi veten në robërinë e Profetit të shenjtë s.a.v.s., duke thënë se në këtë robëri është mirësia ime materiale e shpirtërore.

Po ashtu, Profeti i shenjtë s.a.v.s. nuk e detyroi një skllav çifut duke i thënë: ti je skllavi im dhe je nën kontrollin tim, ndaj vepro ashtu siç të them unë. Kur ai u sëmurë shumë rëndë, dhe Profeti i shenjtë s.a.v.s. vërejti se jeta e tij ishte në rrezik, ai u shqetësua dhe kishte merak që ai, jetën të përfundonte në rrugën e drejtë, që ai të falej prej Zotit.. Ai nuk donte që skllavi të ndahej nga kjo botë,

pa e pranuar Sheriatin e fundit të Zotit. Prandaj, Profeti i shenjtë s.a.v.s. shkoi t'i bënte vizitë dhe duke qëndruar pranë sh-tratit të tij, me fjalë e me ton shumë mal-lëngjyes i tha:- Pranoje Islam!

Hazret Anesi r.a. rrëfen:

Profeti i shenjtë s.a.v.s. kishte një djalosh çifut që i shërbente atij. Ai u sëmure, dhe Profeti i shenjtë s.a.v.s. shkoi t'i bënte atij vizitë. Duke qëndrua pranë kokës së tij, ai i tha:- Pranoje Islam! Djaloshi shikoi babain e tij që i rrinte pra-në shtratit, që i tha të birin:- Bindu dhe pranoje Abul Kasimin (d.m.th. Profet Muhammedin s.a.v.s.), e kështu djaloshi e përqafoi fenë Islame.

(Sahih Buhari, Kitabul Xhenaiz, Bab idha eslama es-sabijju famata, hadithi 1356, Darul Kutub El-Garbi, Bejrut, botimi i parë, 2004)

Pra, ai e përqafoi fenë Islame, për shkak se i kishte parë vetë sjelljet e mira e të mëshirshme të Profetit të shenjtë s.a.v.s., kur ishte në robërinë e tij. Ai me siguri do të kishte menduar se Islami është një fe e vërtetë dhe se vetëm aty ka shpëtim të vërtetë. Ai kurrë nuk do të ketë men-duar se një personifikim i dashurisë e i zemërgjerësisë, siç ishte Profeti i shenjtë s.a.v.s., do të mund të mendonte keq për të. Pa dyshim, ai ishte i vërtetë dhe gjith-një i thërriste të tjerët në drejtim të së vërtetës e në drejtim të veprave të mira, dhe i këshillonte të tjerët në mënyrën më të mirë. E tillë ishte ajo liri që e krijoi ai, dhe në botë nuk ka ndonjë shembull të tillë të kësaj lirie.

Profeti i shenjtë s.a.v.s. e pëlqente lir-inë e ndërgjegjes, të fesë e të jetës, dhe e urrente skllavërinë edhe para se të bëhej Profet i Zotit. Kur pas martesës, Hazret

Hadixheja ia dorëzoi Profetit të shen-jtë s.a.v.s. tërë pasurinë dhe skllëvërit e saj, ai asaj i tha:- Nëse ti ma dorëzon tërë pasurinë tënde, atëherë gjithçka do të jetë në dorën time dhe unë do të ve-proj ashtu siç do ta vendos vetë. Ajo iu përgjigj:- Për këtë arsye unë vendosa të të dhuroj ty. Profeti i shenjtë s.a.v.s. aty për aty tha:- Unë i liroj skllëvërit. Ajo i tha:- Unë t'i dhashë ty, bëje siç ta merr mendja, e asgjë nuk është më në dispozi-cionin tim. Pra, Profeti i shenjtë s.a.v.s. menjëherë i mblodhi të gjithë skllëvërit e saj dhe u tha:- Sot ju të gjithë jeni të lirë. Përveç kësaj, ai ndau një pjesë të madhe të pasurisë së saj në mesin e të varfërve e nevojtarëve.

Një ndër skllëvërit që ai e liroi ishte edhe Zejdi. Ky sa më dukej ishte më i mençur e më i shkathët se të gjithë skllëvërit e tjerë. Edhe pse i ishte dhënë liria, dhe i ishte hequr vula e skllavërisë, prapëseprapë ai vendosi që të mbetej përgjithmonë skllav tek Profeti i shenjtë s.a.v.s. Prandaj, ai Profetit të shenjtë s.a.v.s. i tha:- Shumë mirë, ju më liruat, por unë nuk dëshiroj të lirohem. Unë do të qëndroj me ju si skllavi juaj. Prandaj, ai qëndroi bashkë me Profetin s.a.v.s., dhe dashuria e lidhsh-mëria e tyre reciproke vazhdoi të rritej. Zejdi që me origjinë rridhte nga një familje e pasur, ishte rrëmbyer në fëmi-jëri e mandej ishte shitur e ishte blerë nga banditët. Ai ishte shitur disa herë e më në fund arriti këtu. Prindërit e farefisi i tij e kërkonin gjithandej dhe mësuan se djali i tyre është në Mekë. Ata erdhën në Mekë, dhe duke e kërkuar atë mësuan se djali gjendej tek Profeti i shenjtë s.a.v.s. Ata ia ofruan Profetit të shenjtë s.a.v.s. një sasi të madhe të hollash, që të lirohej djali i tyre, duke i thënë se nëna e tij ishte në një gjendje shumë të rëndë mjerimi e

pikëllimi. Profeti i shenjtë s.a.v.s. atyre u tha:- Unë e pata liruar Zejdin dhe ai është i lirë të shkojë kudo, dhe se unë nuk dëshiroj t'i marr të hollat. Prindërit e tij i thanë:- O Zejd, eja të shkojmë! Mirëpo, Zejdi iu përgjigj:- Unë ju kam takuar juve dhe kjo mjafton, dhe kur të kem rast do të takohem edhe me nënën time. Tani për tani, unë nuk mund të vij me ju. Unë jam skllav i Profetit të shenjtë s.a.v.s. dhe nuk mendoj që të ndahem prej tij. Unë e dua Profetin s.a.v.s. më shumë se sa mund të dojë ndokush nënën e babën e vet. Prindërit e farefiset e Zedit e lutën atë me këmbëngulje, por ai refuzoi të shkonte me ta. Duke e parë dashurinë e Zedit, Profeti i shenjtë s.a.v.s. tha:- Zedi ishte i lirë edhe më përpara, por sot ai është djali im. Prindërit e Zedit u kthyen në vendin e tyre, kurse Zedi mbeti te Profeti i shenjtë s.a.v.s.

(Përmbledhur nga "Dibaça Tefsirul Kuran", f. 112, Nazarat Isha'at Rabvah, Ziaul Islam Press, Rabvah)

Pas Pejgamberllëkut, vlerat e Profetit të shenjtë s.a.v.s. të lirisë u zbkuruan edhe më shumë. Përveç natyrës së tij të qenësishme, tani kishte filluar të merrte porosi Hyjnore lidhur me të drejtat e skllavëve, dhe nëse dikush nuk do të mund t'i plotësonte, atëherë ai detyrohej t'i lironte ata. Një hadith na dëshmon se një herë një *sahabi* (shoku i Profetit) e rrihte skllavin e tij. Kur Profeti i shenjtë s.a.v.s. e vuri re këtë, ai shprehu keqardhjen e zemërimit e tij. Duke parë zemërimin e Profetit të shenjtë s.a.v.s., ai *sahabi* e liroi skllavin. Atëherë, Profeti i shenjtë s.a.v.s. tha:- Po të mos e liroje atë, do të meritoje ndëshkimin e Allahut xh.sh.

(Sahih Muslim, Kitabul Iman, Bab suhbatil Mamalik, hadithi 4200, 4201, Darul Fikr, Bejrut, 2004)

Pra, shihni, kjo është liri! Një shembull i lirisë së ndërgjegjes që ka të bëjë me njerëzit e feve të ndryshme, të cilën e kishte praktikuar Profeti i shenjtë s.a.v.s. në Medinë, ku sundonte ai.

Në një hadith, Abu Hurejrah rrëfen se një herë dy persona grindeshin. Njeri prej tyre ishte mysliman, kurse tjetri çifut. Myslmani i tha:- Unë betohem në emër të asaj Qenieje që e zgjodhi Muhammedin mbi të gjitha botët dhe që i dhuroi epërsi mbi të gjithë. Çifuti tha:- Unë betohem në emër të asaj Qenieje që i dhuroi epërsi Musait mbi të gjitha botët dhe e zgjodhi atë. Me të dëgjuar këtë, myslimani ia flakëroi atij një shuplakë. Çifuti u ankua te Profeti i shenjtë s.a.v.s. Ai së pari kërkoi sqarim prej atij myslimani e mandej i tha:-

"Mos më jepni epërsi ndaj Musait."

(Sahih Buhari, Kitabul Khusumat, Bab ma jedhkuru fil eshkhas vel khusumah bejnal muslim vel jehud, hadithi 2411, Darul Kitab El-Arabi, Bejrut, botimi i parë, 2004)

Ky ishte standardi i lirisë – i lirisë së ndërgjegjes e i fesë, në qeverinë e tij. Pas migrimit në Medinë, Profeti i shenjtë s.a.v.s. hyri në një marrëveshje me çifutët e me fiset e tjera, me qëllim që të arrihej paqe. Me që myslimanët ishin shumicë, qoftë për nga numri ose për shkak të atyre njerëzve që iu bashkuan myslimanëve, edhe pse nuk ishin myslimanë, drejtimi i qeverisë ishte në duart e Profetit të shenjtë s.a.v.s. Mirëpo, kjo nuk do të thoshte se popujt e tjerë dhe ndjenjat e tyre nuk respektoheshin. Me gjithë dëshminë e Kuranit se ai është Profeti më i zgjedhur prej të gjithë Profetëve, ai nuk pranoi që t'i jepej epërsi ndaj Profetëve të tjerë, që atmosfera të mos prishej. Pasi e dëgjoji ankesën e atij çifuti, ai duke e qortuar myslimanin, i tha:- Mos i përzieni

Profetët në grindjet tuaja; po nëse sipas mendimit tuaj unë jam Profeti më i zgjedhur prej të gjithëve, edhe Allahu xh.sh. jep dëshmi për këtë, prapëseprapë të keni të qartë se nuk duhet që në qeverinë tonë të lëndohet dikush, për shkak të asaj se është thënë diçka për Profetin e tij. Unë nuk do ta lejoj këtë. Nëse doni që të respektohem, atëherë i respektoni të gjithë Profetët e tjerë. Pra, këto ishin standarde të drejtësisë e të lirisë së ndërgjegjes e të shprehurit të Profetit të shenjtë s.a.v.s. të cilat ai i vendosi që të tregohej një kujdes ndaj ndjenjave të vetes gjithashtu edhe ndaj ndjenjave të të tjerëve. Bile, në shumë raste, ai tregonte më shumë kujdes ndaj ndjenjave të të tjerëve.

Shembulli i shkëlqyer praktik i Profetit të shenjtë s.a.v.s. lidhur me vendosjen e vlerave njerëzore e tolerancës fetare

Shfaqet edhe me një shembull tjetër nga jeta e Profetit të shenjtë s.a.v.s., lidhur me vendosjen e vlerave dhe sjelljeve njerëzore.

Abdur Rahman bin Abi Lejla rrëfen se Sahl bin Hunejfi dhe Kejs bin Sa'di ishin të ulur në vendin e quajtur Kadsia, kur pranë tyre kaloi një xhenaze. Ata të dy u ngritën në këmbë. Kur atyre u tha se kjo është xhenaze e një *dhimmiu* (jomyslimani), ata të dy thanë:- Një herë kaloi një xhenaze pranë Profetit të shenjtë s.a.v.s., ai u ngrit në këmbë për ta nderuar atë. Atëherë i thanë: Kjo është xhenaze e një çifuti. Duke dëgjuar këtë, Profeti i shenjtë s.a.v.s. tha:-

"A nuk ishte edhe ai njeri!"

(Sahih Buhari, Kitabul Xhenaiz, Bab man kama lixhenazati jehudi, hadithi 1312, Darul Kitab El-Arabi, Bejrut, botimi i parë, 2004)

Ashtu duhet shfaqur nderi e respekti ndaj feve të ndryshme e gjithashtu ndaj njerëzve. Sjellje të tilla dhe shembuj të tillë krijojnë një atmosferë të tolerancës fetare, të dashurisë e të paqes. Jo si vepimet e njerëzve të sotëm, të dhënë pas interesave materiale që nuk krijojnë asgjë veçse atmosferë të urrejtjes.

Në një hadith tjetër thuhet se, në kohën e fitores së Khejberit, myslimanët i gjetën disa kopje të Tevratit. Çifutët shkuan te Profeti i shenjtë s.a.v.s. dhe e lutën atë, që Libri i tyre i shenjtë t'u kthehej atyre. Profeti i shenjtë s.a.v.s. menjëherë i urdhëroi es-habët e tij që çifutëve t'ua kthenin Librat e tyre.

(Es-Siratul Halabijah, vol. 3, f. 62, Bab dhikri magazijah s.a.v.s., Gazvah Khaiber, Darul Kutub El-Ilmijjah, Bejrut, botimi i parë, 2002)

Edhe pse çifutët dënoheshin për shkak të krimeve të tyre, prapëseprapë Profeti i shenjtë s.a.v.s. nuk lejoi që të silleshin ndaj armikut në mënyrë që të lëndohej për shkak të ndjenjave fetare.

Këto janë disa ngjarje individuale që i kam përmendur. Unë edhe më parë kam përmendur se ishte bërë një marrëveshje në Medinë. Ndaj dëshiroj t'i përmend disa kushte të asaj marrëveshjeje, që arritën tek ne me anë të disa haditheve, e që shpjegojnë se si Profeti i shenjtë s.a.v.s. bëri përpjekje për të krijuar një atmosferë të tolerancës në atë shoqëri; dhe çfarë dëshironte ai për të vendosur paqe, me qëllim që të vendosej paqe e dinjiteti njerëzor në shoqëri. Ja disa kushte të asaj marrëveshjeje:

1. Myslimanët e çifutët do të jetonin me simpati, mirësjellje, sinqeritet e me dashuri reciproke, dhe nuk do të bënin

- padrejtësi e mizori ndaj njëri-tjetrit. (Megjithëse çifutët nuk e respektonin këtë kusht dhe vepronin kundër tij, prapëseprapë Profeti i shenjtë s.a.v.s. sillej me ta me butësi e me zemërgjerësi, derisa erdhi koha kur padrejtësitë e tyre i kishin kaluar kufijtë, dhe atëherë ishin marrë disa aksione kundër tyre).
2. Kushti i dytë ishte se çdo popull do të kishte lirinë e fesë. Megjithëse myslimanët ishin në shumicë, prapëseprapë ithtarët e feve të tjera ishin të lirë ta praktikonin fenë e tyre
 3. Kushti i tretë ishte se jeta e pasuria e të gjithë banorëve do të ruheshin e do të respektoheshin, përveçse kur dikush kryente ndonjë padrejtësi ose krim (dhe këtu nuk ka pasur ndonjë dallim. Do të silleshin të gjithë njësoj, pa marrë parasysh nëse fajtori është mysliman apo jomysliman. Për sa i përket sigurimit të pasurisë, ajo ishte detyra e të gjithëve, e banorëve dhe e qeverisë).
 4. Të gjitha mosmarrëveshjet e grindjet do të paraqiteshin te Profeti i shenjtë s.a.v.s. dhe do të gjykoheshin sipas direktivave të Zotit. (Direktiva e Zotit do të thotë se gjykimi do të bëhet sipas Sheriatit të çdo populli. Mirëpo, çdo çështje do të parashtrohej te Profeti i shenjtë s.a.v.s., sepse ai ishte prijësi kryesor në atë kohë. Tani, disa të krishterë e ngrinin akuzën sikur ishte bërë padrejtësi e mizori në disa gjykime në çështje të çifutëve, kur ato gjykime ishin bërë sipas Sheriatit të tyre, ashtu sikurse ata kishin kërkuar vetë, sipas marrëveshjes).
 5. Asnjë palë nuk do të dilte për luftë pa marrë leje nga Profeti i shenjtë s.a.v.s. Pra, duke jetuar nën pushtetin e tij, çdokush do t'i bindej qeverisë. (Tani, shihni se ç'parashikon ky kusht? Ky është udhërrëfyes për këto organizata xhihadi. Ju nuk mund të bëni xhihad pa marrë leje nga qeveria e atij vendi ku jetoni, përveçse kur të hyni në ushtrinë e atij vendi, e mandej kur shteti bën luftë, ju keni të drejtë të merrni pjesë në të).
 6. Nëse ndonjë popull do t'i sulmonte myslimanët ose çifutët, atëherë këta të dy do të ngreheshin kundër atij populli. (Kjo do të thotë se këta të dy do të ndihmonin njëri-tjetrin, dhe nëse në rast pajtimi me armikun do të fitonin ndonjë dobi, atëherë ajo dobi do të ndahej barabartë në mes të atyre të dyve).
 7. Çifutët nuk do t'u jepnin ndonjë ndihmë, përkrahje a strehim Kurejshve të Mekës. (Sepse ata i dëbuan myslimanët nga Meka. Myslimanët gjetën strehim në Medinë, prandaj ata që jetonin nën këtë qeveri nuk duhej të nënshkruanin ndonjë marrëveshje me ta e as nuk duhej marrë ndonjë ndihmë prej tyre).
 8. Çdo popull do ta bartte vetë ekonominë e tij. Sipas kësaj marrëveshjeje, asnjë fajtor, tiran a njeri i padrejtë nuk do të përjashtohej nga dënimi, pa ndonjë diskriminim, qoftë ai mysliman apo çifut.

(Përmbledhur nga "Sirat Khatamunnabijin s.a.v.s." autori Mirza Bashir Ahmad, f. 279, Islam International Publications Ltd., Islamabad, Tilford, UK, 2003)

Kjo ishte liria dhe toleranca absolute fetare kur e shohim se si Profeti i shenjtë s.a.v.s. e lejoi delegacionin e të krishterëve nga Nexhrani që të adhuronin në xhaminë e Profetit të shenjtë s.a.v.s. Ata adhuronin duke iu drejtuar lindjes. Es-habët e Profetit të shenjtë s.a.v.s. ishin

të mendimit se nuk duhej t'u lejohej që të vepronin në këtë mënyrë, mirëpo Profeti i shenjtë s.a.v.s. tha:- S'prish punë.

Një evident tjetër, lidhur me këtë liri, ishte ajo letër imuniteti që Profeti i shenjtë s.a.v.s. ia dha popullit të Nexhranit, ku ishte shkruar se ai i nënshkruari do t'i ruajë kufijtë e të krishterëve (të Nexhranit) me anë të forcave ushtarake myslimane. Përveç kësaj, kjo do të ishte detyra e myslimanëve që t'i ruanin Kishat, vendet e adhurimit e hanet e tyre, pa marrë parasysh se ku gjenden, në qytete, male, në vende të largëta ose nëpër pyje. Ata do të kishin liri të plotë të adhuronin sipas fesë së tyre, dhe kjo gjithashtu ishte detyra e myslimanëve që ta ruanin lirinë e tyre fetare. Profeti i shenjtë s.a.v.s. gjithashtu deklaroi se meqë këta janë banorët e një shteti islamik, andaj është detyra e myslimanëve që t'i ruajnë. Marrëveshja flet qartë se myslimanët nuk do të kishin të drejtë t'i fusnin të krishterët në ekspeditat e tyre luftarake, pa pëlqimin e dëshirën e tyre. Priftërinjtë e tyre dhe prijësit fetarë nuk do të largoheshin nga posti i tyre, dhe do të vazhdonin t'i kryenin detyrat e ngarkuara. Nuk do të kishin pengesë në adhurimin e tyre. Vendet e tyre të adhurimit nuk do të përdroreshin në asnjë mënyrë për qëllime të tjera publike. Kjo do të thotë se ato nuk do të shndërroheshin në hane e në bujtina e as nuk do të përdroreshin për ndonjë qëllim tjetër pa lejen e tyre. Nuk do të merrej *xhizja* (taksë) prej dijetarëve fetarë e prej priftërinjve, kudo që ishin ata. Nëse një mysliman do të kishte gruan e krishterë, ajo do të kishte liri të plotë që të adhuronte sipas fesë së saj. Secili do të kishte liri të plotë që të shkonte te dijetarët e tij për të marrë këshilla. Për sa i përket riparimit të Kishave, nëse të krishterët kërkonin

ndihmë financiare e morale, myslimanët duhej t'u jepnin ndihmë, sepse kjo nuk do të ishte borxh e as mirënjohje, por një ndihmë e tillë do ishte një formë që do ta përforconte këtë marrëveshje. Pra, duhej të kryenin aktivitete të tilla shoqërore për përforcimin e marrëdhënieve të mira reciproke e për t'i dhënë ndihmë njeri-tjetrit.

(Përmbledhur nga "Zadel Ma'ad, fi hadji khairil ibad", hissa III, f. 187-188, vëf. Nexhran, përkthim në gjuhën urdu nga Sejyed Rais Ahmad Xhafarri, Akademia Nafis, Keraçi, 1990)

Pra, këto ishin standarde të lirisë fetare e tolerancës së Profetit të shenjtë s.a.v.s. Me gjithë këtë realitet, ta akuzosh Profetin e shenjtë s.a.v.s. se e përhapri Islamin me dhunë e me tehun e shpatës, është në të vërtetë një padrejtësi e madhe.

Hazret Mesihu i Premtuar a.s. shkruan:

“Në një kohë kur populli i Librit dhe idhujtarët e Mekës ishin bërë njerëz më të shturur e të pamoralshëm, duke kryer vepra të paturpshme mendonin se bënë bamirësi të mëdha. Ata nuk frenoheshin së bëri krime, dhe bënë kundërvajtje. Allahu xh.sh. i mbrojti të papërkrahurit e të shtypurit nga duart e tyre, duke ia dhuruar Profetit të shenjtë s.a.v.s. drejtimin e qeverisë. Meqë toka e Arabisë ishte e shfrenuar, dhe njerëzit nuk ishin nën sundimin e ndonjë mbreti, andaj çdo grup jetonte i shfrenuar dhe pa norma morale, pasi nuk kishte ndonjë ligj. Meqë nuk kishte ndonjë ligj, njerëzit ditë për ditë bënë më shumë krime. Pra, Allahu xh.sh. duke e mëshirua atë vend, e dërgoi Profetin e shenjtë s.a.v.s. jo vetëm si një Profet, por e bëri edhe Mbret të atij vendi, dhe e përsosi Kuranin si një kod ligjesh që i përfshinte në vete të gjitha direktivat lidhur me çështjet financiare, kriminale e ligjore.

Prandaj, Profeti i shenjtë s.a.v.s., në kapacitet të vet, ishte Mbret dhe njerëzit e të gjitha feve i drejtoheshin atij për të gjitha çështjet e tyre për gjykim. Është vërtetuar nga Kurani se njëherë i ishte paraqitur Profetit të shenjtë s.a.v.s. një grindje në mes të një myslimani e të një çifuti. Pas hulumtimeve, Profeti i shenjtë s.a.v.s. deklaroi se çifuti kishte të drejtë dhe dha gjykim kundër myslimanit.

Pra, disa persona injorantë që nuk e lexojnë Kuratin me vëmendje të plotë, e konsiderojnë çdo aspekt nën sferën e peygambërllekut të Profetit të shenjtë s.a.v.s., kurse ndëshkimet e dënimit e tilla jepeshin në pozitën e Kalifit (mbretit)." (Kjo do të thotë se ajo ishte detyra e qeverisë.)

"Pas Hazret Musait a.s., Izraelitë kishin Profetë të veçuar nga Mbretërit. Mbretërit bënin paqe dhe vendosnin rendin publik me anë të proceseve politike. Sidoqoftë, në kohën e Profetit të shenjtë s.a.v.s., të dyja këto pozita i ishin dhuruar atij nga Zoti. Përveç personave kriminelë, si ishin sjellë të tjerët është mjaftë e qartë nga ky ajet:

Dhe thuaju atyre të cilëve u ishte dhënë në Libri dhe analfabetëve: A e keni pranuar Islamin? Nëse e përqaftuan Islamin, atëherë ata, me të vërtetë, janë të përdhur. Por nëse ata kthehen mbrapa, ti ke për detyrë vetëm t'ua përcjellësh mesazhin.¹

Ky ajet nuk do të thotë se kjo gjithashtu është detyra juaj që të luftoni me ta. Është e qartë nga ky ajet se urdhri i luftës ishte vetëm kundër njerëzve kriminelë që i vrishnin myslimanët ose krijonin çrregullime në vend dhe bënin vjedhje e plaçkitje. Luftëra të tilla ishin zhvilluar nën drejtimin e një mbreti, e jo nën drejtimin e një profeti. Siç Allahu xh.sh. deklaroi:

Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë, por mos e teproni.

Vërtet, Allahu nuk i do ata që e teprojnë.^{2"}

("Çeshmae Marifet" "Ruhani Khazain", vol. 23, f. 242-243)

Pra, si ishte e mundur që ai Profet s.a.v.s., të cilit i ishte zbritur një Sheriat i tillë, të vepronte kundër dekreteve Hyjnore?! Pa dyshim, ai deklaroi një amnisti të përgjithshme në kohën e fitores së Mekës, pa e kushtëzuar këtë amnisti me pranimin e Islamit. Një shembull të këtillë amnistie e kemi parë më herët. Amnistia kishte forma të ndryshme por asnjë formë nuk ishte e kushtëzuar me pranimin e Islamit, se nëse do ta pranoni Islamin, ju do të keni amnisti, përndryshe jo. Ishte një amnisti e hapur për të gjithë ata që hynin në vende të ndryshme të përcaktuara për amnisti, që tuboheshin nën flamuj të ndryshëm, që hynin në Qabe e që hynin në shtëpi të caktuara për këtë amnisti. Ky ishte një shembull aq i lartë e madhështor sa që nuk mund ta gjejmë askund shoqin e tij. Vërtet, ishte një deklaratë e pakushtëzuar e bërë me këto fjalë:

Sot nuk ka qortim kundër jush

Mijëra e mijëra *salavate* dhe bekime qofshin mbi këtë Profet të shenjtë s.a.v.s. që i krijoi këta shembuj të shkëlqyer dhe që na këshilloi të veprojmë në këtë mënyrë. Allahu xh.sh. na faltë mundësi që t'i ndjekim mësimet e tij. *Amin!*

E përktheu në shqip:
Mohammad Zakaria Khan

1 (Ale Imran, 3:21)

2 (El-Bakara, 2:191)

JETA E HAZRET EBU BEKRIT

(ALLAHU QOFTË I KËNAQUR ME TË)

Pozita e lartë e sahabëve të Profetit të shenjtë ^{savs}:

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, dhe gjithë atyre që i pasuan me vendosmëri e përkushtim; Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte të tilla nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ata do të jetojnë përgjithmonë në to. Kjo është fitore madhështore.”

[Et-Teubah 9:101]

“Muhamedi i Dërguar i Allahut dhe ata që janë me të, janë shumë të fortë ndaj jobesimtarëve ndërsa të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut.”

[El-Fet’h 48:30]

I Dërguari i Allahut ^{savs} ka thënë:

“Periudha më e mirë e umetit tim është ajo në të cilën kam ardhur unë.”¹

Hazret Mesihu i Premtuar ^{alchiselam} thotë:

“Sigurisht të gjithë sahabët janë si gjymtyrë për të Dërguarin e Allahut ^{savs}. Nëse disa prej tyre ishin si sy, të tjerët ishin si veshë disa ishin si duar, të tjerët si këmbë. Të gjitha veprimet dhe përpjekjet e tyre u shfaqën në përputhje me ato gjymtyrë dhe kështu ata u munduan të fitonin pëlqimin e Zotit të botëve dhe Krijesit të gjithësisë.”²

Hazret Ebdullah bin Masu’d ^{ra} thotë:

“Ata ishin njerëz më të shquar të këtij umeti. Zemrat e tyre ishin të pastra ndërsa dituria ishte shumë e thellë. Ata ishin të pastër nga çdo lloj formaliteti. Kombi, i cili Allahu e zgjodhi për shoqërimin e të Dërguarit të Tij dhe për themelimin e fesë së Tij, e njohën lartësinë e asaj feje, ndoqën gjurmët e tij dhe qëndruan fort te moralet e tij, sigurisht ata ishin mbi dijen e vërtetë.”³

JETA E HAZRET EBU BEKRIT ^{ra}

I pari nga kalifët e drejtë pas Profetit të shenjtë ^{savs} quhej Ebdullah ibni Uthman, apo si njihet gjerësisht Hazret Abu Bekri ^{ra}. Ai lindi 2 vjet pas lindjes së të Dërguarit të Allahut ^{savs}. Para ardhjes së Islamit, ai dallohej ndër krerët e fisit kurejsh për shkak të moraleve dhe virtyteve të larta. Në kohën para Islamit, kur poezia dhe pirja e alkoolit konsideroheshin cilësitë e burrërisë dhe madhështisë, Hazret Ebu-Bekri ^{ra} gjithmonë i shmangej dhe kaloi një jetë të pastër edhe para Islamit.

Hazret Ebu Bekri ^{ra} gëzon nderin e madh se ishte i pari prej meshkujve që pranoi thirrjen e të Dërguarit të Allahut ^{savs}. Veç këtij ai kishte krenari se ishte i pari që shoqëroi Profetin e shenjtë ^{savs} në falje (namaz).

Një herë i Dërguari i Allahut ^{savs} përmendi se si Hazret Ebu Bekri ^{ra} kishte pranuar Islamin. Ai tha: “Kujtdo që i përcolla mesazhin e Islamit, ngurroi në

pranimin e tij, përveç Ebu Bekrit, që u bë mysliman pa asnjë druajtje.”

Aisheja ^{ra} rrëfen se kur u mblodhën 38 sahabët (shokët) e Profetit të shenjtë ^{savs}, Ebu Bekri ^{ra} propozoi që tani ata duhet të përhapin mesazhin e Islamit në mënyrë të hapur. Profeti i shenjtë ^{savs} iu përgjigj: “O Ebu Bekr! Jemi akoma shumë pak veta.” Por Hazret Ebu Bekri ^{ra} nguli këmbë derisa Profeti i shenjtë ^{savs} pranoi këtë propozim. Të gjithë myslimanët shkuan në Qabe. Ebu Bekri ^{ra} u ngrit nga vendi dhe zuri të fliste, teksa i Dërguari i Allahut ^{savs} ishte ulur dhe e dëgjonte. Për pak çaste idhujtarët mekasë i mësynë myslimanët e paktë dhe personi i parë që u bë pre i persekutimit ishte po ai që guxoi që shpallte mesazhin e Islamit në mënyrë të hapur. Ebu Bekri ^{ra} e plagosur e shpurën në shtëpi. Pas pak, kur e mori veten, fjalët e para që nxori nga goja ishin: “Si është i Dërguari i Allahut ^{savs}?” Ai u qetësua vetëm kur iu tha se Profeti ^{savs} ishte mirë e shëndoshë. Me vështirësi mbërriti në shtëpi ku qëndronte Profeti i Shenjtë ^{savs}. I Dërguari i Allahut ^{savs} e puthi dhe e përqafoi. Ebu Bekri ^{ra} tha me shumë përulësi: “O i Dërguari i Allahut! Mos u shqetësoni fare për mua. Ata nuk më kanë bërë kurrgjë. Vetëm më kanë plagosur fytyrën.” Atë ditë edhe nëna e Ebu Bekrit përqafoi Islamin.

Hazret Ebu Bekri ^{ra} ishte shumë i ndjeshëm. Dashuria e Allahut dhe të Dërguarit të Tij ^{savs} ishte ngulitur në zemrën e tij. Ai mezi përmbante ndjenjat. Shpeshherë kur ai ishte zhytur në kujtimin e Zotit, ato emocione shfaqeshin në formën e lotëve që rridhnin përmes syve. Kur ai udhëhiqte namazin, nga hidhërimi qante me dënësë derisa i mbytej zëri dhe i Dërguari i Allahut ^{savs} i thoshte për ta ngritur atë.

Vajza e tij, nëna e besimtarëve, Aisheja ^{ra} transmeton se në një natë të ndritur me

dritë hëne, i Dërguari i Allahut ^{savs} ishte shtrirë duke u mbështetur në prehrin tim. Unë e pyeta duke i treguar qiellin “O i Dërguari i Allahut! A ka dikush që ka kryer aq vepra të mira sa janë yje në qiell.” Ai u përgjigj: “Po, Umeri”. (Domethënë Hazret Umeri ibn Hat-taab ^{ra} Kalifi i dytë). Unë e pyeta se si vlerësohen veprat e Ebu Bekrit në krahasim me veprat e Umerit. I Dërguari i Allahut ^{savs} u përgjigj: “Të gjitha veprat e mira të Umerit janë barabartë me një vepër të Ebu Bekrit.”

Gjatë kohës së kalifatit të Umerit ^{ra}, kur një herë para tij u përmend emri i Ebu Bekrit ^{ra}, kujtimet e shokut të dashur ia përlotën sytë. Shtjella e fuqishme e kujtimeve e kaploi trimin, kalifin Umer ^{ra}, dhe imagjinata e tij e çoi midis ngjarjeve të kaluara, mes shkretëtirës, brenda një shpelle të errët dhe të kobshme. I mallëngjyer nga emocionet dhe i ngërthyer nga ndjenjat, Umeri ^{ra} tha me zë të mbytur, se nëse do të ishte e mundur do të kisha vetëm një dëshirë, që të merreshin të gjitha veprat e mia nga llogaria ime dhe të më jepej vetëm një ditë e veçantë dhe një natë e veçantë nga jeta e Ebu Bekrit ^{ra}.

Nata duhet të jetë ajo kur Ebu-Bekri ^{ra} hyri në shpellën e *Thorrit* bashkë me të Dërguarin e Allahut ^{savs} gjatë emigrimit nga Meka për në Medinë. Kur ata mbërritën te hyrja e shpellës, Ebu Bekri ^{ra} i tha Profetit të Shenjtë ^{savs} “Pasha Allahun! Ju nuk do të hyjni brenda, para se të hyj unë. Nëse dikush është fshehur brenda, le të më sulmojë mua.” Me të thënë këto fjalë ai hyri në shpellë dhe e pastroi mirë pjesën e brendshme. E grisi çarçafin e tij copa-copa dhe mbylli të gjitha vrimat që gjendeshin në shpellë. Çarçafi përfundoi, po akoma mbetën dy vrima. Ebu Bekri ^{ra} vuri këmbët mbi ato vrima dhe i tha Profetit të shenjtë ^{savs} që të hynte brenda. I Dërguari i Allahut ^{savs} hyri brenda dhe

pas pak u shtri në prehrin e Ebu Bekrit^{ra} dhe atë e zuri gjumi. Teksa pushonte i Dërguari i Allahut^{savs}, një gjarpër kafshoi këmbën e Ebu Bekrit^{ra}. Dhimbja ishte therëse dhe e papërballueshme, por Ebu Bekri^{ra} kishte frikë se nëse do të lëshonte ndonjë rënkim, kjo mund të shqetësonte Profetin e shenjtë^{savs}. Ebu Bekri^{ra} ishte në një sprovë midis forcës së dashurisë dhe aftësisë së durimit. Por përsëri dashuria ia doli mbanë. Ebu Bekri^{ra} tregoi shembullin e durimit dhe qëndrueshmërisë që vështirë gjendet në histori.

Dhimbja po rritej në çdo çast. Një lot u derdh nga syri dhe dalëngadalë ra mbi faqen e të Dërguarit të Allahut^{savs}. Profeti^{savs} u zgjua. Ai e pyeti “O Ebu Bekr! Çfarë ndodhi?”. Ai iu përgjigj: “Më ka kafshuar gjarpri.” I Dërguari i Allahut^{savs} e leu këmbën me pështymë dhe dhimbja u zhduk shpejt. Thuhet se ndikimi i helmit u shfaq shumë vonë dhe pikërisht ky helmim u bë shkak i vdekjes së tij.

Umeri^{ra} vazhdoi fjalën duke thënë: “Dhe dita duhet të jetë ajo kur pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut^{savs} arabët menjëherë u rebeluan dhe refuzuan të paguanin *zeqatin*. Ebu Bekri i butë dhe i dhembshur, sytë e të cilit gjithmonë rrinin të përlotur në dashurinë e Zotit dhe të Profetit të tij^{savs}, kur u vendos në pozitën e kalifit, shpalli me vendosmëri, “Nëse këto fise arabe do të më refuzojnë në të (zeqatin), qoftë edhe mbi litarin e devesë, unë edhe për atë do të luftoj me ta.” Umeri^{ra} tha: “Unë i thashë ‘O Kalifi i Profetit! Ki mëshirë dhe fali.’ Por Ebu Bekri^{ra} m’u përgjigj me zotërim: “O Umer! Ti që ishe trim dhe i fortë tani u bërë i dobët në Islam? Kur mesazhi i Zotit mbërriti në pikën më të lartë përmes Profetit të shenjtë^{savs} dhe feja u përsos, si mund të lejoj unë që ajo fe të dobësohet gjatë jetës sime.”

Çdo fjalë dhe çdo veprim i Ebu Bekrit

^{ra} ishte hija e modelit të të Dërguarit të Allahut^{savs}? Ishte aq i zhytur në dashurinë e Profetit^{savs} sa mund të zbërthente edhe shenja të mpërhta të Profetit, të cilët nuk mund të kuptonin sahabët e tjerë. Hazret Sa’id El-Khudrri^{ra} transmeton se një herë të Dërguari i Allahut^{savs} erdhi te *mimberi* për të mbajtur hytben dhe tha: “Allahu ia parashtrroi bekimet e kësaj bote dhe ato që kishte në dorën e Tij një robi të Tij dhe i dha të drejtën për të zgjedhur atë që pëlqente prej tyre. Atëherë robi e zgjodhi atë që kishte Zoti e Tij.” Hazret Ebu-Bekri^{ra} gjithashtu ishte i pranishëm në atë mbledhje. Lotët i rridhnin nga sytë dhe në këtë gjendje ai iu drejtua Profetit të shenjtë^{savs} “O i Dërguari i Allahut! Prindërit e mi sakrifikofshin për ty.” Hazret Sa’idi thotë: “Ne u habitëm se pse Ebu-Bekri u mallëngiye ndërsa *sahabët* i thoshin njëri-tjetrit: Nuk dimë, Çfarë i ndodhi Ebu Bekrit? I Dërguari i Allahut^{savs} na tregonte për një rob, të cilit Allahu i dha të drejtën, ndërkohë ky po thotë: “Prindërit e mi sakrifikofshin për ty.” Por në fakt Ebu Bekri^{ra} ishte më i dituri prej nesh, sepse ai kishte kuptuar se ai robi nuk ishte tjetër përpos të Dërguarit të Allahut^{savs} që së shpejti do të bashkohej me Zotin e tij përgjithmonë.”⁴

Kur Profeti i shenjtë^{savs} ndërroi jetë, Hazret Umeri^{ra}, që nuk ishte përgatitur për të përballuar këtë fatkeqësi, nxori shpatën dhe deklaroi se i Dërguari i Allahut^{savs} nuk ka ndërruar jetë dhe se është i gjallë. Kur Ebu Bekri^{ra} erdhi, ai pa fytyrën e Profetit të shenjtë^{savs}, e puthi dhe tha: “Prindërit e mi sakrifikofshin për ty. Pasha Zotin, në dorën e të Cilit është shpirti i Ebu Bekrit, Allahu kurrësi nuk do t’ju japë nga dy vdekje.” Me të thënë këto fjalë ai doli jashtë dhe deklaroi këtë shpallje me plotë zotërim: “Nëse dikush adhuronte Muhamedin, le të dijë që Muhamedi^{savs} ka ndërruar jetë. Ndërsa

ai që i besonte Zotit të Madhërishëm, le të mësojë se Ai është i Gjallë dhe i Përhershëm, që nuk ka asnjë fund.” Pastaj recitoi këtë ajet:

“Muhamedi është vetëm i Dërguar, të gjithë profetët para tij kanë ndërruar jetë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahut. Dhe Allahu do t'i shpërblejë falënderuesit.”

[Ale-Imran 3:145]

Fjalët e Hazret Ebu Bekrit^{ra} u ngulën si gozhdët në zemrat e besimtarëve dhe Hazret Umeri^{ra} heshti dhe u ul. Hazret Ibne Ab-baas^{ra} tha: “Neve na u duk sikurse ai ajet kishte zbritur po në atë ditë, pavarësisht se ne kishin recituar atë shumë herë.”

Çfarë ishte ajo që paraqiti të dobët dhe të butë Hazret Ebu Bekrin në momentin më delikat të historisë së Islamit, si njeri më i fortë dhe më trim? Çfarë ishte ajo fuqi, që shndërroi një të përlulur dhe të prekshëm në burimin e forcës, bashkimit dhe fuqisë për të gjithë myslimanët?

Ajo forcë ishte ndihma hyjnore e Zotit të Plotfuqishëm që e vendosi në pozitën e kalifatit dhe u bë vetë forca dhe fuqia e tij. Kur Hazret Ebu Bekri^{ra} zuri pozitën e kalifit, ishte një moment delikat për Islamin. Islami përballonte kryengritjen e brendshme në formën e braktisjes së fesë dhe shumëkush kishte refuzuar të paguante zeqatin. Në disa vende numri i ushtrisë kryengritëse tejkalonte 100 mijë veta, ndërkohë ushtria myslimane nën flamurin e Hazret Ebu Bekrit^{ra} ishte vetëm 10 mijë ushtarë, të cilën i Dërguari i Allahut^{savs} kishte porositur të nisej drejt Sirisë nën komandën e Hazret Usama bin Zejdit^{ra}. *Sahabët* menduan se nëse edhe këta ushtarë do të niseshin në këtë ekspeditë, atëherë nuk do të mbetet asnjë siguri për Medinën gjatë kryengritjes. Hazret Umeri^{ra} dhe Hazret

Aliu^{ra} dhe disa nga *sahabët* formuan një delegacion dhe u takuan me *Kalifin* për ta ndaluar nisjen e kësaj ushtrie. Por Kalifi i Profetit, Hazret Ebu Bekri^{ra} nuk pranoi asnjë këshillë dhe tha: “A pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut^{savs}, veprimin e parë që do të bëjë i biri i Kahafës të jetë për të ndaluar ushtrinë, nisjen e të cilit kishte porositur vetë Profeti i shenjtë^{savs}? Jo, unë kurrësi nuk mund ta ndaloj këtë ushtri. Nëse gjithë Arabia përfshihet në kryengritje, le të përfshihet, dhe nëse nuk mbetet asnjë masë sigurie për Medinë, le të mos mbetet. Pasha Zotin, nëse ushtria e armikut hyn në Medinë dhe qentë zvarritin kufomat e grave myslimane, unë akoma do të përcjell këtë ushtri, për të cilin kishte porositur vetë i Dërguari i Allahut^{savs}. Ky guxim dhe kjo burrëri, ky besim dhe kjo bindje sigurisht i ishte dhuruar prej Zotit, të cilën e vërtetoi vetë rrjedha e ngjarjeve e mëvonshme.

Hazret Ebu Bekri sakrifikoi gjithçka për hir të Allahut dhe Profetit të Tij^{savs}. Në moshën 61 vjeçare, pas një sëmundjeje që zgjati afërsisht gjysmë muaj, Hazret Ebu Bekri^{ra} u nda nga jeta. Hazret Mesihu i Premtuar^{alchisalam} përshkruan morale të larta të Hazret Ebu Bekrit^{ra} duke thënë:

“Hazret Ebu Bekri^{ra} përvetësoi veshjen e përlësisë dhe varfërisë. Ai kishte një lidhje të fortë me prijësin e tij Profetin e shenjtë^{savs} dhe shpirti i tij ishte rrënjësor në shpirtin e të Dërguarit të Allahut^{savs}.”

1 Muslim 4/1963-1964

2 Hazret Mirza Ghulam Ahmad, *Sirrul Khilafa, Rruhani Khezain*, vëll. 8, f. 341

3 Sherrehus-suneh lilbaghvi, vëll I, f. 214-215

4 Buhariu, Libri i epërsive të sahabëve

MENDJEMADHËSIA

ARMIKU MË I MADH

I BESIMTARIT

Feja Islame synon të kultivojë të gjitha ato morale të larta të njeriut, të cilat i mundësojnë arritje të mëdha shpirtërore si dhe e pajisin me aftësi dhe mundësi për të përballuar sfidat e jetës. Ai jo vetëm që përcakton ato cilësi që njeriu duhet t'i përvetësojë për t'u përparuar në udhën e jetës, por gjithashtu veçon ato të meta morale që mund të dobësojnë karakterin e tij dhe mund të pengojnë zhvillimin e tij shpirtëror, moral dhe kulturor. Kurani vazhdimisht na vë në dukje këto pengesa që duhen kapërcyer për të themeluar një shoqëri hyjnore ku sundon dashuria, drejtësia dhe harmonia.

Një ndër këto pengesa që ndalon rrugëtimin e besimtarit është mendjemadhësia. Ajo jo vetëm shkatërron të gjitha virtytet e një personi, por gjithashtu shkakton shumë probleme të tjera shpirtërore, morale dhe shoqërore. Në latinisht thuhet *ad augusta per angusta* d.m.th. për vende të larta janë rrugët e ngushta. Kështu që edhe për t'u lartësuar në udhën shpirtërore, besimtari patjetër duhet të heqë dorë nga mendjemadhësia dhe në vend të saj duhet të përvetësojë përlulesinë. Mendjemadhësia nuk është gjë tjetër përveç treguesi i injorancës që shoqërohet nga krenaria dhe kryelartësia. Ajo pakëson urtësinë. Ai që vuan nga

mendjemadhësia nuk gjen asnjë mangësi të vetja dhe gjithmonë kënaqet duke gjetur të metat të të tjerët. Në vend që të jetë i vetëdijshëm ndaj aftësive dhe kufizimeve të veta, vetëbesimi i tij nuk i njeh kufijtë. Nga frika që mos dihen dobësitë e tij, mendjemadhi jeton në një lëvizje duke maskuar boshllëkun e brendshëm. Në vend që të respektojë të tjerët, ai kërkon respekt nga çdokush. Mendjemadhësia helmon të gjitha marrëdhëniet e njeriut, me veten e tij dhe me të tjerët, por në radhë të parë me botën shpirtërore.

Mendjemadhësia dhe të gjitha tiparet e tjera egoiste bien shumë larg nga territori i botës shpirtërore. Liria nga mendjemadhësia fiton, kur njeriu fillon të vështrojë veten. Ne jemi përpjekur të përshkruajmë këtë sëmundje bashkë me ilaçet e saj të përmendura në Kuran, hadithe dhe thënie të Mesihut të Premtuar ^{alchislam}.

SIPAS KURANIT

Allahu i Madhërishëm, në Kuranin e Shenjtë, thotë:

Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijen frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.

O ju që keni besuar! Asnjë komb (prej jush) të mos tallet me kombin tjetër, se ai mund të bëhet më i mirë se ata (që tallen). Gjithashtu,

gratë të mos tallen me gratë tjera, se ato mund të jenë më të mira se këto (që tallin). Mos shpifni dhe mos qesëndisni njëri-tjetrin me nofka (të këqija)! Sa e shëmtuar është të thirret me emër të keq pas (pranimit të) besimit! Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës.

O ju që keni besuar! Mënjaroni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë prej Allahut! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.

O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise për ta njohur njëri-tjetrin.

Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Të asgjë nuk është e fshehtë.

[El-Huxhurat 49:11-14]

THËNIET E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT ^{savs}:

Disa hadithe rreth mendjemadhësisë, smirës dhe mospërfilljes.

Hazret Ebdullahu bin Mes'ud ^{ra} rrëfen se Profeti i shenjtë ^{savs} tha : ai që do të ketë një grimcë të imët të mendjemadhësisë, nuk do të hyjë në xhenet. Një njeri e pyeti: O i Dërguari i Allahut! Njeriut i pëlqen të ketë rroba të mira, të ketë këpuca të mira, të duket bukur. Profeti i shenjtë ^{savs} iu përgjigj se kjo nuk është mendjemadhësi. Ai shtoi që Allahu është *xhemil* (d.m.th. I Bukur) dhe e pëlqen bukurinë. Mendjemadhësi konsiderohet atëherë kur njeriu mohon të vërtetën, kur i konsideron të tjerët më të ulët se sa veten e tij, shikon me përbuzje dhe mospërfillje dhe sillet ashpër me ta.

[Muslim kitabul iman, tehrimul kibr ve bejanuhu]

Hazret Ebu Hurejrahu ^{ra} rrëfen që Profeti i shenjtë ^{savs} tha se ruhuni nga smira, sepse ajo i shkrumbon të gjitha mirësitë, ashtu siç zjarri i shkrumbon drunjte dhe kashtën.

[Ebu Da'ud kitabul edeb , babun fil hesed dhe Ibni Maxha, ebvabuz zuhud bauul hesed]

Hazret Enesi ^{ra} rrëfen që i Dërguari i Allahut ^{savs} tha: Mos mbani urrejtje ndaj njëri-tjetrit. Mos u sillni me smirë, mos veproni me indiferencë dhe mospërfillje dhe mos i shkëputni lidhjet e ndërsjella por bëhuni rob të Allahut dhe si vëllezër me njeri-tjetrin. Nuk është e drejtë për një mysliman që të zemërohet nga vëllai i tij dhe t'i prishë marrëdhëniet e tyre për më shumë se tri ditë.

[Buhariu, kitabul edeb, bab ma jenha enit tahasad, Muslim]

Hazret Ebu Ejub Ensari ^{ra} transmeton që Profeti i shenjtë ^{savs} tha që nuk është e lejuar për një mysliman që të jetë i inatosur me vëllanë e tij për më shumë se tri ditë dhe për këtë arsye as mos të takohen, dhe kur ndeshen në rrugë, të kthejnë kokën nga njëri tjetri. Më i miri prej tyre, është ai që bën hapin e parë në selam.

[Ebu Da'ud, kitabul edeb, bab fimen juhsheru akhahul muslim, Buahriu, kitabul istedhan, babus selam]

Hazret Isai alehiselam thotë:

“... kushdo që e lartëson veten do të poshtërohet, dhe kush e poshtëron veten do të lartësohet”

[Luka 14:11]

NGA SHKRIMET E MESIHUT TË PREMTUAR alehiselam:

Hazret Mesihu i Premtuar ^{alehiselam} shkruan:

“Unë ju them me gjithë çiltërsinë, që në ditën e gjykimit, pas *shirkut*¹, nuk ka ligësi më të madhe se sa mendjemadhësia.

Është një bela që poshtëron njeriun në të dy botët. Mëshira e Zotit mund t'i vijë në ndihmë çdo besimtari, por jo arrogancit. Edhe shejtani pohonte që besonte në njësinë e Zotit, por meqenëse vuante nga mendjemadhësia, edhe Ademin, që ishte i dashuri i Zotit, e pa me përbuzje dhe i bëri kritikë, prandaj ai u shkatërrua dhe e zuri mallkimi. Pra, mëkati i parë përmes të cilit u shkatërrua një njeri për gjithmonë ishte mendjemadhësia.”

[*Aina Kamalat-e-Islam (Pasqyra e mrekullive të Islamit), Rruhani Khazain, vëll. 5, fq. 598*]

“Unë e këshilloj xhematin tim që t'i shmanget mendjemadhësisë, sepse ajo është shumë e urryer para Zotit të Madhërisëm. Por ndoshta ju nuk e kuptoni se çfarë është mendjemadhësia. Prandaj kuptojeni prej meje sepse unë flas me frymën e Zotit.

Çdokush që e shikon vëllanë e tij me mospërfillje duke menduar se është më i ditur, më i mençur ose më i aftë se ai, është mendjemadh, ngaqë ai nuk e konsideron Zotin burim të mençurisë dhe diturisë së tij, por e çmon veten si diçka. A Zotit nuk i takon fuqia që ta shkallojë atë, dhe vëllait të tij, të cilin ky e konsideronte të ulët, t'ia japë mençurinë, diturinë dhe aftësitë më të mira se të tij. Po kështu ai i cili, duke u frymëzuar nga ideja e pasurisë, pozitës dhe madhësisë së tij, vëllanë e tij e sheh me përçmim, është gjithashtu mendjemadh, sepse ai nuk kujton që pasuria, pozita dhe madhështia e tij, të gjitha ia ka dhënë Zoti. Ai është i verbër dhe nuk e di që Zotit i takon fuqia, që t'i shkaktojë një fatkeqësi, që po atë çast ai të bjerë në gjendje më të ulët, ndërsa vëllait të tij, të cilin e konsideronte të ulët, t'i japë pasurinë më të madhe se sa atij. Po kështu ai, që mburret për shëndetin e tij fizik, ose krenohet për hijeshinë,

tiparet e bukura, fuqinë dhe mundësitë trupore, kurse e qesëndis vëllanë e tij me përqeshje dhe mospërfillje duke i ngjitur nofka tallëse dhe u tregon të tjerëve cenet e tij fizike, është gjithashtu arrogant. Ai nuk e di që Zoti mund ta kapë atë në befasi, duke i shkaktuar të meta fizike dhe duke e çuar në një gjendje më të keqe se vëllai i tij, ndërsa atij, i cili u përqesh, t'ia bekojë gjymtyrët dhe organet që ato të mos dobësohen e as të gjymtohen për një kohë të gjatë, sepse Zoti bën gjithçka që do Ai. Po ashtu, arrogant është edhe ai që përtan në lutje duke varur shpresat në forcat e veta, ngase ai nuk zbuloi burimin e të gjitha fuqive dhe forcave dhe e vlerësoi veten si diçka. Prandaj o të dashurit e mi! Mbajini mend këto gjëra, që të mos quheni arrogantë në vlerësimin e Zotit në mënyrë të pavetëdijshme. Ai që korrigjon shqiptimin e një fjale të vëllait të tij nga mendjemadhësia, gjithashtu merr pjesë në mendjemadhësi. Ai që nuk i dëgjon fjalët e vëllait të tij me vëmendje dhe ia kthen shpinën, edhe ai përfshihet në mendjemadhësi. Ai që inatoset kur vëllai i tij i varfër ulet pranë tij, merr pjesë në mendjemadhësi. Ai që e vështron atë, që është angazhuar në lutje, me përbuzje dhe qesëndisje, merr pjesë në mendjemadhësi. Ai që nuk mundohet t'i nënshtrohet të Dërguarit dhe Profetit të Zotit merr pjesë në mendjemadhësi. Ai që nuk ua kushton vëmendjen fjalëve të tij dhe as nuk i lexon shkrimet e tij, merr pjesë në mendjemadhësi. Prandaj përpikuni të mos keni asnjë grimcë mendjemadhësie që të mos shkatërroheni dhe të fitoni shpëtimin me gjithë familjen. Përkuluni para Zotit dhe e doni aq fort sa dikush mund ta dojë dikë në këtë botë, dhe frikësohuni prej Zotit tuaj, aq sa dikush mund të ketë frikë prej dikujt në këtë botë. Bëhuni me zemër të

çiltër me qëllime të sinqerta, me zemër të butë dhe të përlurur dhe larg nga çdo lloj ligësie, që të fitoni mëshirën.”

[*Nuzul-ul-Mesih, Rruhani Khaza'in, vëll. 18, fq. 402-403*]

Mbajeni mend që arroganca gjithmonë e shoqëron gënjeshtren. Gënjeshtër më e keqe është ajo që shoqëron arrogancën. Prandaj Allahu i Madhërishëm, para se gjithash, e prish kokën e arrogantit.

[*Aina Kamalat-e-Islam "Pasqyra e mrekullive të Islamit", Rruhani Khazain, vëll. 5, fq. 599*]

“Mendjemadhësia dhe ligësia janë mëkate. Një gabim i vockël mund t'i prishë të gjitha veprat tuaja të mira, të fituara gjatë një periudhe prej shtatëdhjetë vjetësh. Thuhet se ishte një herë një njeri i shenjtë që jetonte në një mal. Kishte pasur shumë kohë që nuk kishte rënë shi atje. Një ditë ra shi, por ra mbi gurë dhe nëpër shkëmbinj. Atij i shkoi ndërmend që fushat dhe kopshtet kishin nevojë më shumë për shi dhe se shumë ujë ra kotë mbi këta shkëmbinj. Ai mendoi që do të ishte më mirë po të binte ky shi edhe në arat e lëruara. Për këtë Zoti i hoqi atij gjithë shenjtërinë. Ai u pikëllua pa masë dhe i kërkoi ndihmë një tjetër njeriu të shenjtë. Ky i tregon këtij përfundimisht se kishte shkaktuar zemërimin e Zotit përmes kritikës së Tij.”

[*Melfuzat, vëll. VI, fq. 57*]

“Mendjemadhësia shfaqet në shumë mënyra. Kjo del nganjëherë nga syri i njeriut kur e vështron tjetrin që nënkuptohet se ai e konsideron tjetrin më të ulët se sa vetveten. Herë ajo del nga gjuha dhe shfaqet nga koka ose herë nga duart dhe këmbët. Me pak fjalë, mendjemadhësia ka shumë burime dhe besimtari duhet t'u shmangët të gjitha këtyre burimeve dhe

nuk duhet të ketë asnjë gjymtyrë që të ketë erën e krenarisë dhe të shfaqë mendjemadhësinë. ...

Shumëkush mendon për vetë që është i përlurur, por ai vuan nga një farë mendjemadhësie. Prandaj njeriu duhet të ruhet nga të gjitha format e mendjemadhësisë. Herë mendjemadhësia shfaqet përmes pasurisë. Pasaniku mendjemadh i konsideron të tjerët si fukarenj dhe pyet se kush është ai që të barazohet me të. Nganjëherë mendjemadhësia lind nga fisi ose kombi, kur ai mendon se kombi i tij është më i lartë se sa kombi i tjetrit. ...

... Disa herë mendjemadhësia lind nga dituria. Kur dikush bën ndonjë gabim, ky mendjemadh menjëherë ia kap gabimin dhe gërthet fort duke i thënë atij se nuk di të shqiptojë mirë asnjë fjalë. Shkurt, janë gjithfarë mendjemadhësish që mund ta largojnë njeriun nga mirësia dhe paraqiten pengesa në sjelljet me njerëzit me dashamirësi. Të gjitha këto duhen shmanjur. Por kjo kërkon njëfarë vdekjeje. Derisa një person nuk pranon vdekjen e tillë, nuk zbret bekimi i Zotit mbi të e as nuk mban përgjegjësinë për të.

[*Melfuzat, vëll. VI, fq. 401-403*]

Çfarë kërkon përlulësia prej nesh. Ajo kërkon që ne mos t'i referohemi vetes përveç mëkateve dhe të metave që i kemi. Ne duhet të dimë fare mirë që burimi i çdo lloj bekimi është vetëm Allahu, Ndihmues, Mbështetës dhe Krijuesi i universit. Ne duhet të përvetësojmë jetën e devotshme dhe të çiltër duke iu lutur Zotit, jo për të fituar respektin ose vetëlavdërimin, por vetëm për ta falënderuar Zotin dhe gjithmonë me një shpirt mirënjohjeje për të gjitha ato bekime dhe favore që Ai na ka dhënë neve.

Allahu na mundësoftë. Amin



Dhjetë gjëra të kota

Imam Ibnu ul Kejjim al Xhevzijjah

1. Dituria që nuk shfrytëzohet.
2. Veprimi që bëhet pa sinjeritet dhe që nuk bazohet mbi modele të ndershme të tjerëve.
3. Paraja që lihet mënjane dhe nuk shfrytëzohet nga pronari as në këtë botë dhe as në botën e ahiretit nuk sjell shpërblim për të.
4. Zemrës së cilës i mungon dashuria, mallëngjimi ndaj Zotit, dhe dëshira për të fituar afërsinë e Tij.
5. Trupi që nuk i nënshtrohet Zotit dhe as nuk i shërben Atij.
6. Dashuria ndaj Zotit që nuk i nënshtrohet porosive të Tij dhe që nuk kërkon pëlqimin e Tij.
7. Koha që nuk harxhohet për t'i shlyer mëkatet apo në kërkim të mundësive për të bërë vepra të mira.
8. Mendja që mendon vetëm për gjëra të kota.
9. Shërbimi i atyre që nuk të afrojnë drejt Zotit e as nuk të sjellin dobi në jetën tënde.
10. Shpresa dhe frika prej çdokujt që qëndron nën autoritetin e fuqisë së Allahut; ndërsa ai vet nuk mund t'i sjellë vetes asnjë dobi apo dëm; as vdekje, as jetë; e as nuk mund të ringjallet.

Megjithatë, më të rëndësishmet nga të gjitha këto janë, humbja e vetes dhe humbja e kohës. Humbja e vetes vjen si rezultat, kur dikush i jep epërsi jetës së kësaj bote në krahasim me jetën e Ahiretit, ndërkohë humbja e kohës rrjedh nga shpresa e pareshtur. Shkatërrimi dhe humbja vjen nga ndjekja e dëshirave vetjake dhe nga shpresa e pareshtur, ndërsa çdo lloj mirësie gjendet vetëm në ndjekjen e rrugës së drejtë dhe përgatitjen e vetes për takimin me Zotin.

Sa e çuditshme është se kur robi përballet me ndonjë problem (tokësor), ai kërkon ndihmën e Zotit, por ai kurrë, para se të vdesë nga injoranca, neglizhenca, përmëshja e dëshirave të veta dhe angazhimet e ndryshme, nuk i lutet Atij për të shëruar zemrën e tij. Në të vërtetë, kur vdes zemra, ai kurrsesi nuk do të ndjejë rëndësinë apo ndikimin e mëkateve.

[Imam Ibnul Kejjim El-Xhevzijjah A Collection of Wise Sayings (El-Fava'id), Umm Al-Qura, Al-Mansura, Egjipt, 2004, f. 179, ISBN. 977-599-799-2]

1 Shirk: t'i bësh shok Allahut

PAQJA POLITIKE

(pjesa e parë)

Hazret Mirza Tahir Ahmadi, Kalifi IV i Xhematit Mysliman Ahmadia

1. Paqja politike duhet të ekzaminohet me kujdes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
2. Islami nuk hedh poshtë tërësisht ndonjë sistem politik
3. Monarkia
4. Përkufizimi i demokracisë
5. Përkufizimi islamik i demokracisë
6. Dy shtyllat e konceptit islamik të demokracisë.
7. Parapëlqehen konsultime të ndër-sjella
8. Konfuzioni për natyrën e vërtetë të qeverisjes islamike
9. Autoriteti Hyjnor
10. Mullahizmi
11. Ndarja e besnikërive midis shtetit dhe fesë
12. A duhet të ketë feja autoritet legjislativ ekzekutiv?
13. Drejtimi i shtetit islamik
14. Marrëdhëniet ndërkombëtare; parimi i drejtësisë absolute i zbatueshëm njëloj për të gjithë
15. Roli i Organizatave të Kombeve të Bashkuara

Paqja politike duhet të ekzaminohet me kujdes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Për sa i përket politikës kombëtare, çështja kryesore është se cili sistem politik është i mirë apo i keq për njeriun? Sërish, ne duhet të zbulojmë nëse dështimi i sistemeve politike dhe defektet e tyre të qenësishme janë përgjegjëse për vuajtjet dhe pakënaqësitë e një populli, apo ka ndonjë arsye tjetër? A duhet të fajsohet sistemi apo ata që e drejtojnë atë? A është e mundur që udhëheqjet politike të pamoralshme, egoiste, lakmitare apo të korruptuara që hipin në pushtet me anë

të mjeteve demokratike të jenë vërtet të mira dhe të dobishme për shoqërinë, për shembull rastet e diktaturave të mira?

Për të vendosur dhe garantuar paqen ndërkombëtare, Islami ka një këshillë për politikanët bashkëkohorë.

Islami vë theks të posaçëm në futjen e parimeve morale absolute në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore, pa përjashtuar politikën.

Islami nuk hedh poshtë tërësisht ndonjë sistem politik

Ne fillojmë nga vëzhgimi se asnjë sistem politik nuk është përmendur në

Islam si një sistem i vetëm i vlefshëm në raport me të tjerët.

Nuk ka dyshim, Kurani i Shenjtë flet për një sistem demokratik, ku drejtuesit mund të zgjidhen nga populli, por ky nuk është i vetmi sistem i rekomanduar nga Islami. Dhe as që mund të jetë privilegj themelor i një feje universale për të zgjedhur një sistem të veçantë të qeverisjes, pa vështirimin e duhur ndaj faktit se nuk është praktikisht e mundur për një sistem të vetëm të jetë i aplikueshëm për të gjitha rajonet dhe shoqëritë e botës.

Demokracia nuk është zhvilluar aq sa duhet, madje as në kombet më të përparuara të botës sa për të arritur stadin e shtetit, që është vizioni politik përfundimtar i demokracisë. Me lindjen e kapitalizmit dhe ndërtimin e makinerisë jashtëzakonisht të fuqishme në vendet kapitaliste, zgjedhje të vërteta demokratike nuk mund të mbahen kudo. Duke i shtuar kësaj problemë të rritur të korupsionit, daljen e mafies dhe grupeve të tjera shtypëse, kushdo mund të arrijë në përfundim, me siguri, se, demokracia nuk është në duar të sigurta, madje edhe në vendet më demokratike të botës. Atëherë, si mund të jetë e përshtatshme në vendet e Botës së Tretë? Pra, të thashë se demokracia perëndimore mund të triumfojë në vendet afrikane, aziatike apo vendet amerikano-jugore, apo të ashtuquajturat vende islamike të botës, do të ishte një pretendim jorealit dhe i zbrazët.

Unë mendoj, mësimet islamike nuk refuzojnë ndonjë sistem politik të botës, por Islami e le këtë në zgjedhjen e popullit dhe traditave të vendosura, historikisht, që mbizotërojnë në çdo vend. Ajo që thekson Islami nuk është forma e qeverisjes, por sesi duhet të realizohet ajo në praktikë.

Në Islam, mund të ekzistojnë sisteme të ndryshme qeverisjeje, si monarkia, sundimi feudal, demokracia etj, por me kusht që ato të sigurojnë një qeverisje që duhet të jetë sipas idealit islamik në kryerjen e detyrës ndaj nënshtetasve.

Monarkia

Monarkia është përmendur në mënyrë të përsëritur në Kuranin e Shenjtë, duke mos u kundërshtuar si një institucion.

Një profet i Izraelit kujton izraelitët e Talut-it:

Dhe profeti i tyre u tha: “Sigurisht, Allahu ka dërguar Talutin si mbretin tuaj.” Ata thanë: “Si mund të bëhet ai mbreti ynë, kur ne e meritojmë më shumë mbretërinë sesa ai!? Dhe ai as nuk ka ndonjë pasuri të madhe.” Ai u përgjigj: “Allahu atë e ka zgjedhur për ju dhe i ka dhënë më shumë dije dhe trup. Dhe Allahu ia jep pushtetin e Vet kujt të dojë, Allahu është Gjithëpërfshirës (dhe) i Gjithëdijshëm. (El-Bekare 2:248)

Në Kuranin e Shenjtë monarkia është përmendur gjithashtu edhe në kuptim më të gjerë duke i cilësuar vetë njerëzit si monarkë:

Dhe (kujto) kur Musai i tha popullit të vet: “O populli im! Kujtoni bekimin e Allahut ndaj jush, kur prej jush bëri profetë dhe ju bëri mbretër dhe ju dha atë që nuk ia kishte dhënë askujt në botë.” (El-Majda 5:21)

Sërish, mbretëritë e krijuara apo të zgjeruara nga pushtimi, në përgjithësi, nuk gëzojnë një reputacion të mirë, siç i gjejmë në vargjet për mbretëreshën e

Shebës që këshillon këshillin e saj.

Vendimi i mbretëreshës Sheba është ekspozuar si vijon:

Ajo tha: “Sigurisht, kur mbretërit pushtojnë ndonjë vendbanim, e rrënojnë atë dhe e poshtërojnë parinë e tij. Kështu veprojnë ata. (En-Neml 27:35)

Mbretërit mund të jenë të mirë apo të këqij, sigurisht, ashtu si edhe kryeministrit e zgjedhur në mënyrë demokratike apo presidentët.

Por Kurani i Shenjtë përmend një kategori mbretëresh që ishin caktuar nga Zoti. Një ndër ta është edhe mbreti Sulejman (Solomon) ^{a.s.}, që nuk ishte vetëm një mbret i besuar nga çifutët dhe të krishterët, por edhe një profet i Zotit sipas Kuranit të Shenjtë.

Kjo tregon se nganjëherë detyrat e profetizmit dhe të sovranitetit kombinohen në një person dhe ata janë sovranë të caktuar drejtpërdrejtë nga Zoti.

Një lloj tjetër sovraniteti, i cili jepet përmes autoritetit të një profeti, është përmendur në Kuranin e Shenjtë. Ajeti që pason ilustron këtë fakt:

“O besimtarë! Binduni Allahut, binduni të Dërguarit dhe atyre që kanë autoritet mes jush. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, ia drejtoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Fundit. Kjo për ju është më mirë dhe shpjegimi më i qartë.” (En-Nisa 4:60)

Kemi zgjedhur këtë ajet jo vetëm që të rendisim kategoritë e sovranitetit, por për të theksuar se sipas Kuranit të Shenjtë, nganjëherë zgjedhjet demokratike nuk

janë medoemos më të drejtat. Është plotësisht e mundshme që shumica dërrmuese e popullsisë të mos arrijë të njohë cilësitë thelbësore të udhëheqësit të madh të një person dhe të protestojë kundër zgjedhjes së tij, nëse ai është imponuar mbi ta. Nga të gjitha kriteret politike, caktimi i tij do të ishte qortuar si diktatorial. Zgjedhja mund të jetë kundër vullnetit të popullit, por është sigurisht jo kundër interesit publik.

Një dobësi në formën demokratike të zgjedhjeve është se masat e bëjnë zgjedhjen e tyre në bazë të përshtypjeve sipërfaqësore dhe vlerësimeve më të fundit, prandaj nuk janë në gjendje për të gjykuar vetë cilësitë e sigurta të udhëheqësit, të cilat duhet të jenë më të përshtatshmet për dobietë themelore të tyre.

Duket se, në historinë e popullit të preferuar të Zotit, ka pasur kohë kur mbi jetesa e tyre politike kërkonte ndërhyrje hyjnore. Në kohë të tilla, Zoti ndërmerr zgjedhjen e një mbreti, sovranin apo liderin në duart e Tij. Nga kjo nuk mund të gjykohej se të gjithë monarkët, që kanë qenë udhëheqës, janë të zgjedhur në mënyrë hyjnore nga Zoti, apo të jenë shenjtëruar si të tillë. Ky koncept i gabuar, që ka qenë i zakonshëm në sistemin mesjetar të krishterë, nuk është marrë në konsideratë nga Kurani i Shenjtë. Për shembull, Mbreti Riçard ankohet:

As të gjitha ujërat e trazuara të deteve nuk mund të lajnë balsamin e një Mbreti të shenjtë. (Shekspir).

Përkufizimi i demokracisë

Koncepti i demokracisë, pavarësisht origjinës së tij greke, është bazuar në përcaktimin e shkurtër të Abraham Linkolnit: *qeverisja e popullit, nga populli,*

për popullin, është një klishe shumë interesante, por rrallë e aplikuar në tërësinë e saj në ndonjë vend në botë.

Pjesa e tretë e këtij përkufizimi për popullin është shumë e turbullt dhe plot me rreziqe. Çfarë mund të deklarohet, se është për popullin, me besim të plotë? Në një sistem të sundimit të shumicës, mund të ndodhë shumë shpesh kur ajo që është konsideruar të jetë për popullin, është thjesht për shumicën dhe jo për pakicën e mbetur.

Në një sistem demokratik, është e mundur gjithashtu që vendime të rëndësishme të merren vetëm mbi bazën e një shumice absolute. Megjithatë, kur ju shqyrtoni dhe analizoni më tej faktet dhe shifrat, zbuloni se është, në fakt, vendimi i pakicës, i kaluar në mënyrë demokratike dhe imponuar mbi shumicën. Një nga mundësitë e shumta është që partia drejtuese është votuar në pushtet mbi një shumicë të thjeshtë bazë, duke siguruar një shumicë pakicë në shumë zona elektorale. Sërish, nëse pjesëmarrja në ditën e votimit është disi e ulët, bëhet e dyshimtë, nëse partia sunduese gëzon në fakt mbështetjen e shumicës. Edhe nëse partia lind nga një shumicë e përgjithshme e elektoratit, shumë gjëra mund të ndodhin gjatë periudhës së qëndrimit të saj. Opinioni publik mund të ndryshojë në mënyrë drastike, kështu që, qeveria e mbledhur nuk është më përfaqësuese e vërtetë e shumicës. Mbi të gjitha, një proces gradual i ndryshimit të frymës nga elektorati shfaqet në çdo ndryshim të qeverisë.

Edhe nëse qeveria mbetet popullore me votuesit e saj, nuk është e pangjashme që, kur disa vendime të rëndësishme janë bërë, një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të partisë sunduese nuk janë dakord me zemër me shumicën, por mund

të kenë votuar për partinë nga besnikëria ndaj saj. Nëse këta anëtarë bëjnë pjesë në forcën e partisë sunduese mbi partinë e opozitës apo partive, atëherë, më shpesh, i ashtuquajtimi vendim i shumicës në realitet do të jetë një vendim pakice, i imponuar mbi popullin.

Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se koncepti i asaj që është parë si e mirë për popullin ndryshon herë pas here. Nëse vendimet nuk janë marrë mbi parimet absolute, por janë hedhur nga dikush që mendon se këto vendime janë të mira për popullin, apo janë mbështetur si të tilla nga partia, atëherë kjo mund të çojë në një ndryshim konstant në politikë herë pas here. Ajo që duket e mirë sot, mund të jetë e keqe nesër dhe e mirë ditën tjetër.

Për një njeri të thjeshtë, kjo mund të jetë një situatë e ngatërruar. Eksperimentimi i komunizmit në një shkallë të tillë të madhe, për gati gjysmë shekulli, ishte mbi të gjitha bazuar në sloganin e njëjtë për popullin. Jo të gjitha shtetet socialiste ishin diktatoriale.

Gjithashtu, duhet të përmendet vija që ndan shtetet socialiste nga ato demokratike, për sa i përket qeverisë nga populli, e cila është shumë delikate dhe nganjëherë jo ekzistuese. A mundet dikush të kundërshtojë qeveritë botërore të zgjedhura në vendet socialiste, kur ato janë sjellë në pushtet nga populli? Sigurisht, në një shtet totalitar, është e mundur të diktohet zgjedhja e kandidatëve për elektoratin në mënyrë të atillë, duke u lënë atij pak hapësirë për të zgjedhur ndonjë alternues. Megjithatë, taktika të njëjta autoritare mund të përdoren, përveç pak përjashtimeve në botën Perëndimore, edhe në vende me sistem demokratik të qeverisjes.

Në fakt, demokracisë në shumë vende të botës nuk i është lënë dorë e lirë dhe zgjedhjet janë rrallë nga populli. Me mjetet zgjedhore, me pazarllëqe, sundim të frikës, përmes taktikave të policisë dhe masave të tjera të korruptuara të ngjashme, shpirti dhe thelbi i demokracisë në botë janë dobësuar me falsifikim, kështu që është lënë fare pak demokraci.

Përkufizimi i demokracisë sipas Islamit

Sipas Kuranit të Shenjtë, njerëzit janë të lirë të zgjedhin, të adoptojnë çdo sistem të qeverisjes që u përshtatet atyre. Demokracia, sovraniteti, sistemet fisnore apo feudale janë të vlefshme, po qe se ato janë të pranuar nga populli si trashëgimi tradicionale e shoqërisë së tyre.

Megjithatë, duket se në Kuranin e Shenjtë demokracia është e preferuar dhe e lëvdur më së shumti. Myslimanet janë këshilluar të kenë një sistem demokratik, ndonëse jo saktësisht sipas modelit të demokracisë së stilit Perëndimor.

Islami nuk paraqet një përkufizim të zbrazët të demokracisë në Kuranin e Shenjtë. Ai trajton vetëm parimet e domethënies vitale dhe ia le pjesën tjetër popullit. Ndiq dhe përfito, ose largohu dhe të jesh i shkatërruar.

Dy shtyllat e konceptit islamik të demokracisë

Ka vetëm dy shtylla në konceptin islamik të demokracisë.

Këto janë:

1. Procesi demokratik i zgjedhjeve të bazohet në besim dhe integritet.

Islami mëson kurdoherë që ju të ushtroni të drejtën e votës, bëjeni këtë me vetëdijen se Zoti ju mbikëqyr ju dhe do t'ju llogarisë përgjegjës për vendimin tuaj. Votoni për ata që janë më të aftë për të kryer detyrën e tyre kombëtare dhe janë në vetvete të besueshëm. E nënkuptuar në këtë mësim është kërkesa që ata që kanë të drejtë të votojnë, duhet të ushtrojnë të drejtën e votës, vetëm nëse ka rrethana jashtë kontrollit të tyre apo ekzistojnë pengesa në ushtrimin e kësaj të drejte.

2. Qeveritë duhet të funksionojnë mbi parimin e drejtësisë absolute.

Shtylla e dytë e demokracisë islamike është që sa herë që ju të merrni vendime, merrini ato mbi parimin e drejtësisë absolute. Qoftë çështje drejtësie politike, fetare, sociale apo ekonomike, nuk duhet të komprometohet kurrë. Pas formimit të qeverisë, votimi brenda partisë duhet gjithashtu të mbetet i orientuar ndaj drejtësisë. Prandaj, nuk duhet të lejohet të ndikojë në procesin e marrjes së vendimit interesi partizan apo konsiderata politike. Në përfundim, çdo vendim i marrë në këtë frymë është i detyruar të jetë vërtet i popullit, nga populli dhe për popullin.

Parapëlqehen konsultime të ndërsjella

Thelbi i demokracisë është diskutuar shumë qartësisht në Kuranin e Shenjtë dhe, për sa i përket këshillës ndaj mysli-manëve, ndonëse monarkia nuk është përjashtuar kurrë si një institut jofetar dhe jo besimtar, demokracia është sigurisht më e preferuar ndaj të gjitha formave të tjera të qeverisjes.

Duke përshkruar shoqërinë ideale myslimane, Kurani i Shenjtë deklaron:

“Çdo gjë që ju është dhënë juve, është një kënaqësi e përkohshme në jetën e kësaj bote, por ajo që është tek Allahu është më e mirë dhe më e përhershme për ata që besojnë dhe mbështeten te Zoti i tyre; dhe për ata që ruhen prej gjynaheve të mëdha dhe mbrapshtive dhe që kur i zemëron dikush, falin; për ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin dhe këshillohen për punët e veta me njeri-tjetrin; për ata që shpenzojnë prej asaj që u kemi dhënë Ne; dhe për ata që, kur i godet ndonjë padrejtësi e madhe, e mbrojnë veten.” (Esh-Shura 42:37-40)

Fjalët arabe AMRO HUM SHOORA BAINAHUM (**këshillohen për punët e veta me njeri-tjetrin**) lidhen me jetën politike të shoqërisë myslimane, duke treguar qartësisht që në çështjet e qeverisjes, vendimet e saj janë bërë përmes konsultimeve të ndërsjella, të cilat, sigurisht, sjellin në mendje një nga pjesët e para të përkufizimit të demokracisë, d.m.th, *qeveri e popullit*. Vullneti i përbashkët i popullit bëhet vullneti sundues i popullit përmes konsultimit të ndërsjellë.

Pjesa e dytë e përkufizimit të demokracisë lidhet me shprehjen *nga populli*. Kjo i referohet qartësisht pjesës pasuese të ajetit:

“Allahu ju urdhëron që amanetet t’jua ktheni atyre që u përkasin.” (En-Nisa 4:59)

Kjo do të thotë se sa herë që ju të

shprehni vullnetin tuaj për të zgjedhur qeveritarët tuaj, gjithmonë jepjani *amanetin* atij që e meriton.

E drejta e popullit për të zgjedhur qeveritarët e tij sigurisht që është përmendur, por rastësisht. Por theksi vihet mbi çështjen se si duhet ushtruar kjo e drejtë. Myslimanëve u kujtohet se kjo nuk është vetëm një çështje e vullnetit të tyre personal që ata mund ta ushtrojnë në çfarëdo mënyre që ata dëshirojnë, por shumë më tepër se kaq, është një çështje përgjegjësie kombëtare. Në çështjet e *amanetit*, juve nuk ju lihen shumë zgjedhje. Ju duhet të kryeni detyrën me gjithë ndershmërinë, integritetin dhe me shpirt vetëmohues. *Amaneti* duhet t’i jepet atij, kujt i takon vërtet.

Shumë dijetarë myslimanë e citojnë këtë varg thjesht për të treguar se Islami parashtron sistemin dhe teorinë e demokracisë si të kuptuar në filozofinë politike Perëndimore, por kjo është vetëm pjesërisht e vërtetë.

Sistemi i konsultimit i përmendur në Kuranin e Shenjtë nuk ka hapësirë për politikën partiake të demokracive Perëndimore bashkëkohore dhe as nuk i jep licencë stilit dhe frymës së debateve politike në parlamentet e zgjedhura në mënyrë demokratike dhe dhomave përfaqësuese. Duke qenë se ne e kemi diskutuar këtë aspekt në hollësi, nuk ka nevojë për gjë tjetër këtu.

Gjithashtu duhet të vihet re në lidhje me pjesën e dytë të përkufizimit të demokracisë sipas këtij koncepti të konsultimit të ndërsjellë, e drejta për të votuar i përket votuesve, thuajse absolutisht pa ndonjë kusht apo gjendje që dhuron këtë të drejtë.

Sipas normave të vendosura të demokracisë, votuesi mund të votojë në favor të një marionete, apo edhe ta prishë apo të hedhë fletën e votimit në një kosh, në vend të kutisë së votimit. Ai do të mbetet i paqortueshëm dhe as që mund të censurohet për shkeljen e ndonjë parimi të demokracisë.

Sipas përkufizimit Kuranor, sidoqoftë, një votues nuk është zot plotësisht i votës së tij, por mbartës i një *amaneti*. Si i tillë, ai duhet të kryejë detyrën e tij drejtësisht dhe drejtpërdrejt dhe ta hedhë atë ku ai ndjen se ajo përket vërtet. Ai duhet të jetë vigjilent dhe i vetëdijshëm se do të konsiderohet përgjegjës për aktin e tij para Zotit.

Në këndvështrimin e këtij koncepti islamik, nëse një parti politike ka caktuar një kandidat dhe një anëtar i veçantë i partisë mendon se kandidati i tyre nuk do të arrijë të kryejë detyrën e tij kombëtare, ai anëtar, më parë duhet të lërë partinë sesa të votojë për dikë që nuk e meriton besimin. Besnikëria ndaj partisë nuk lejohet të bjerë ndesh me zgjedhjen e tij.

Serish, një detyrë mund të kryhet në mirëbesim. Veç kësaj, çdo votues duhet të marrë pjesë plotësisht në ushtrimin e të drejtës së votës gjatë zgjedhjeve, vetëm nëse ai nuk është i aftë për ta bërë këtë. Përndryshe, ai do të ketë dështuar në kryerjen e detyrës së tij. Koncepti i abstenimit apo shmangia nga ushtrimi i të drejtës së votës që ka ndodhur në SHBA, ku njoftohet se thujse gjysma e elektoratit aktualisht e kanë bezdi të votojnë, nuk ka hapësirë në konceptin islamik të demokracisë.

Konfuzioni për natyrën e vërtetë të qeverisjes islamike

Po bëhet popullore midis mendimtarëve politikë islamikë të epokës aktuale të pretendojnë se Islami mbështet demokracinë. Sipas filozofisë së tyre politike, duke qenë se Zoti është autoriteti përfundimtar, sovraniteti i përket Atij.

Autoriteti Hyjnor

Sovraniteti absolut i përket Zotit. Kurani i Shenjte përmbledh zotërimin e Tij në ajetin që pason:

I lartësuar është Allahu, Sundimtari i Vërtetë. S'ka zot tjetër përveç Atij, Zotit të Fronit Madhështor.” (*El-Muminun* 23:117)

Parimi themelor, se përfundimisht të gjitha të drejtat për të drejtuar i përka-sin Zotit dhe Ai është Zot i sovranitetit, është përmendur në mënyra të ndryshme në Kuranin e Shenjte nga i cili ajeti i mësipërm është veçse një shembull.

Në drejtimin e çështjeve politike, sovraniteti i Zotit është shprehur në dy mënyra:

Ligji (*Shariah*) si i prejardhur nga Kurani i Shenjtë, transmetimi i Profetit të shenjtë të Islamit dhe gjithashtu nga traditat e vendosura që i atribuohen atij nga myslimanët e mëparshëm, janë supreme. Ato përmbajnë porosi thelbësore për legjislacionin dhe asnjë qeveri e zgjedhur në mënyrë demokratike nuk mund të përzi-het me Vullnetin e shprehur të Zotit.

b) Asnjë proces legjislativ nuk do të jetë i vlefshëm në kundërshtim të parimit të lartpërmendur.

Për fat të keq, megjithatë, nuk ka njëzëshmëri midis dijetarëve të sekteve të ndryshme të Islamit për sa i përket

ndarjes së qartë të ligjeve (Shariah). Mbi këtë, gjithë dijetarët ranë dakord se legjislacioni është privilegj i Zotit dhe Ai ka shprehur Vullnetin e Tij përmes ajeteve të Kuranit.

Në lidhje me mënyrën në të cilën qeveritë myslimane duhet të drejtojnë, ideja popullore është se qeveria, si përfaqësuese e popullit në çështjet e përditshme administrative, punët dhe masat, duhet të bëhet ndihmuese në shprehjen e Vullnetit të Zotit. Duke qenë se sovraniteti i përket popullit me anë të delegimit të pushtetit, si pasojë, një sistem i tillë është demokratik.

Mullahizmi

Ky është këndvështrimi i ngurtë i të ashtuquajturit ortodoksi, që do të arrinte në një të kuptuar me tendencat moderne demokratike të popullsisë myslimane, me kushtin që Mullahut (përkthimi me i afërt “klerik” mysliman) t’i jepet e drejta përfundimtare të gjykojë vlefshmërinë e vendimeve demokratike mbi bazën e *Sheriatit*.

Nëse pranohet, kjo kërkesë do të jetë e barasvlershme të vendoset autoriteti legjislativ përfundimtar jo në duart e Zotit, por në duart e ortodoksëve apo ndonjë shkolle tjetër të klerit. Kur ju e mendoni pushtetin e tmerrshëm të vendosur në duart e tyre në sfondin e diferencave fundamentale që mbizotërojnë midis klerit mysliman vetë në lidhje me të kuptuarit e tyre se çfarë është dhe çfarë nuk është *Sheriati*, pasojat duken tronditëse. Ka aq shumë shkolla të jurispruencës midis ortodoksisë. Madje edhe brenda çdo shkolle të jurispruencës, kleri nuk është gjithmonë unanim mbi çdo dekret. Sërish, pozicioni i tyre për të

gjetur se cili është Vullneti aktual i Zotit i shprehur në *Sheriatin* islamik ka ndryshuar në periudha të ndryshme të historisë.

Kjo paraqet një problem kompleks për botën bashkëkohore të Islamit që ende duket të jetë në kërkim të identitetit të tij të vërtetë. Po bëhet përherë më e qartë midis intelektualëve myslimanë se e vetmja pikë takimi midis klerit është kërkesa e tyre e pa kompromentuar për forcimin e *Sheriatit*.

Revolucioni iranian ka nxitur më tej oreksin e *mullahut* në vendet ku myslimanët *sunitë* janë shumicë. Sipas tyre, nëse Komejni munda t’ia dalë mbanë, përse ata duhet të dështojnë? Përtej kësaj gjendet fantazia e tyre – toka e ëndrrave të tyre.

Masat janë të paqarta. A do të preferonit Fjalën e Zotit dhe atë të Profetit të shenjtë të Islamit, apo do të donit më mirë të kishit njerëz që udhëheqin dhe formojnë manifestet tuaja politike në një shoqëri pa perëndi dhe pa frikë? Kjo pyetje është shumë e vështirë për një person të zakonshëm, që është në një gjendje të ngatërruar dhe hutimi. Masat në shumë vende myslimane admirojnë Islamin dhe do të ishin gati të vdisnin për Vullnetin e Zotit dhe nderin e Profetit të shenjtë të Islamit, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Por ka diçka brenda tërë skenarit që i lë ata të ngatërruar, të shqetësuar dhe shumë të shqetësuar. Pavarësisht nga dashuria e tyre për Zotin dhe atë të Profetit të shenjtë, kjo evokon një memorie shumë të përgjakur të qeverisjeve në të shkuarën që ishin ose nën ndikimin e *mullahëve* apo shfrytëzimit të *Mullahizmit* në favor të politikës së tyre.

Sa për politikanët myslimanë, ata duken të jenë të ndarë dhe të paven-dosur. Disa nuk mund të rezistojnë të mos e shfrytëzojnë këtë situatë duke u

rreshtuar me *mullahun* dhe duke i marrë ata në patronazh. Megjithatë, ata ushqejnë shpresën e fshehtë, që në kohën e zgjedhjeve, nuk do të jetë *mullahu*, por ata që do të zgjidhen si kampionë të fuqishëm të *Sheriatit*. Masat do të preferonin t'u besonin atyre më shumë si gardianë të *Sheriatit* sesa *mullah*. Jeta do të ishte më e lehtë dhe më realiste në duart e tyre, sesa nën kontrollin e ngurtë dhe të pa kompromentuar të "kujdestarëve të parajsës" (d.m.th. të *mullahëve*). Por janë edhe disa politikanë të tjerë myslimanë, më të ndershëm midis tyre që e parashikojnë e konsiderojnë këtë të jetë një lojë e rrezikshme. Mjerisht! Ata po kthehen shpejt në pakicë. Duket sikur politika dhe hipokrizia kanë qëndruar në njërën anë dhe e vërteta dhe ndershmëria kanë ngelur në anën tjetër. Në një vështrim të gjerë, intelektualët priren gjithmonë e më shumë drejt demokracisë. Ata e duan Islamin, por kanë frikë nga sundimi i *mullahut*. Ata e shikojnë demokracinë jo si një alternativë ndaj Islamit, por e besojnë sinjerisht si një filozofi politike që ka parashtruar vetë Kurani i Shenjtë. Siç thotë ai:

"Për ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin dhe këshillohen për punët e veta me njeri-tjetrin; për ata shpenzojnë prej asaj që u kemi dhënë Ne..." (*Esh-Shura 42:39*)

"Dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh diçka, atëherë mbështetu tek Allahu. Vërtetë Allahu i do ata që mbështeten tek Ai." (*Ale Imran 3:160*)

Si rezultat i pastër i këtij refreni të luftës midis fraksioneve të ndryshme, vendet e reja islamike, si Pakistani, gjenden në një procedurë të komplikuar dhe kontradiktore. Elektorati kurrë nuk i pëlqen të shikojë *mullahët* në asamblетë kushtetuese në një numër të madh. Madje, edhe në lartësinë e etheve për ta vendosur *Sheriatin*, zor se pesë ose dhjetë për qind të *mullahve* ia dalin mbanë për të fituar zgjedhjet. Por, duke ia kushtuar veten Ligjit të Zotit si shkëmbim për mbështetje shtesë nga *mullahët*, politikanet e gjejnë veten në një pozitë shumë shqetësuese. Thellë në brendësi, ata janë plotësisht të bindur se pranimi i *Sheriatit* është një realitet paradoksal ndaj parimit të legjislaturës përmes një asambleje kushtetuese të zgjedhur në mënyrë demokratike.

Nëse autoriteti për organin ligjvënës gjendet te Zoti, që myslimani nuk mund ta mohojë, atëherë, si pasojë logjike, janë *mullahët* që zotërojnë privilegjet e të kuptuarit dhe përcaktimit të ligjit të *Sheriatit*. Në këtë skenar, tërë ushtrimi i zgjedhjes së organit legjislativ do të bëhet i kotë dhe i pakuptimtë. Sigurisht që anëtarë të Parlamentit do të kenë një punë të vetme, që të firmosin atje ku do t'u thonë *mullahët*.

Është tragjike që as politikanët dhe as intelektualët nuk janë përpjekur ndonjëherë saktësisht të kuptojnë formën apo format e qeverisjes që Kurani i Shenjtë parashtron vërtet apo njeh.

Vazhdon në numrin e ardhshëm

*Përktheu në gjuhën shqipe:
Çapajev Zera*



STATUSI I GRUAS NË ISLAM



“Oh bija ime! dëshiroja që të ishe djalë,” i tha gjykatësi Daniel Kadi 11-vjeçares *Elizabetë*, pas vdekjes së vël-lait të saj, njëzet e dy vjeçar, *Eleazarit*, djali i vetëm i *Kadi-t*. Tani ai kishte vetëm vajza për t’i rritur.

Elizabetë Kadi Stantoni ka përmendur këto fjalë në jetëshkrimin e saj, duke e cilësuar këtë, si momentin kur i lindi dëshira për të bërë gjithçka që deri atëherë bënin vetëm burrat. Babait të saj ajo iu përgjigj duke i thënë: “Do të mundohem të bëhem gjithkush në jetë siç ishte vëllai im”.¹ Nëse ideja ishte e paprovuar, të paktën pasioni jo. Përfundimisht gjatë jetës së saj ajo bëri atë, që shumë burra as nuk arrijnë të ëndërrojnë. Mbase babai i saj u shpreh në dëshpërim se s’kishte trashëgimtar, por ai frymëzoi vajzën e tij që të arrinte diçka në një botë që ishte vetëm për meshkujt.

Më vonë do ta gjejmë Elizabetan në krye të Kuvendit të *Seneca Falls* të vitit 1848. Një lëvizje që përfshiu gra të tjera me historinë pak a shumë të përafërt si *Lucy Mathews Stone*, *Martha Coffin Wright*, *Susan B. Anthony* dhe *Matilda Joslyn Gage* etj., që tërë jetën punuan për të fituar dinjitet e mundësi të barabarta për gratë amerikane në të gjitha sferat e jetës. Në një kohë kur industrializimi shfaqej në trajtën më gjakpirëse, kur gratë shfrytëzoheshin më keq se skllëvërit, u mohoheshin e drejta njerëzore, ligjore apo shoqërore, pjesë në

trashëgimi, e drejta e votimit, pronësisë apo tregtisë etj, kjo lëvizje shumë shpejt u bë zëri kryesor i grave amerikane, dhe pikënisja e shumë lëvizjeve të tjera në të gjitha vendet e botës që sot i njohim si të drejtat e grave apo të drejtat civile.

Përpjekja e Elizabetas synonte të shem-bte muret e diskriminimit ku shoqëria ndahej nëpër klasa dhe gjini, ku i dobëti shfrytëzohej nga kthetrat e materialistëve deri në pikën e fundit. Prandaj ajo u bë zëri i drejtësisë, barazisë dhe lirisë dhe simboli i kundërshtimit dhe ndryshimit. Pas shumë përpjekjeve ajo arriti të eliminonte ligjet shekullore që u mohonin grave të drejtat e tyre elementare dhe në rrënojat e tyre u ngrit kodi e sistemi i shoqërisë së re. Është për t’u habitur se shoqëritë ku gjatë shekujve gruaja përshkruhej si mëkatore, fajtoare e të gjitha mundimeve, fatzeze dhe e mohuar nga të gjitha të drejtat, sot gëzon barazinë gjinore në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, ndërkohë shoqëria, ku ruhej dinjiteti, nderi dhe të drejtat e saj në mënyrë më të spikatur, sot i mohon këto të drejta.

Kështu është shoqëria Islame që me më shumë se 1 miliard ndjekës dhe me një shtrirje të gjerë gjeografike përbën një pjesë të madhe të popullsisë botërore. Fatkeqësisht në shumë vende ku praktikohet feja Islame, si Afganistan, Pakistan,

Afrikë Veriore apo Lindje e Mesme, gratë trajtohen keq apo u mohohen shumë të drejta për shkak të kulturës së atyre vendeve. Këto stereotipe, në vende të ndryshme, që nuk përputhen aspak me pozitën, vendin dhe dinjitetin që Islami u jep atyre, kontribuojnë në formimin e perceptimit dhe idesë së gabuar rreth trajtimit të grave në Islam. Përveç këtij qëndrimi të mangët dhe të cungët ku bartësit e këtij mendimi nuk interesohen të studiojnë burimet Islame, është edhe ndikimi i propagandës së përhapur kundër Islamit, që njihet si *Islamofobia*².

Me anë të këtij shkrimi orvatemi të shqyrtojmë të drejtat e grave në aspekte dhe sfera të ndryshme të jetës njerëzore duke u referuar burimeve kryesore të Islamit, d.m.th. Kuranit të shenjtë dhe thënies së Profet Muhammedit ^{savs}. Para se ta nisim studimin tonë është me rëndësi të mësojmë gjendjen e gruas para 1400 vjetësh në qytetërime të mëdha dhe vendin e pozitën që i caktonin fetë e tjera. Le të kthehemi në histori për të parë fetë e mëdha se si e përshkruajnë ato gjininë femërore.

TRAJTIMI I GRUAS NË FE DHE KULTURA TË NDRYSHME

1.1. Hinduizmi

Sipas shkrimeve të fesë hinduiste, përshkrimi i një gruaje fisnike është: “një grua, mendja, gjuha dhe trupi i së cilës është në nënshtrim (të shoqit), do të fitojë më shumë famë në këtë botë, ndërsa, në botën tjetër, të njëjtën vendbanim me bashkëshortin e saj.”³

‘Ligjet e Manus’ është një shkrim i rëndësishëm për sa i përket rregullave fetare në hinduizëm. Atje shkruhet ‘Ditë e natë grua duhet të jetë në varësi të

meshkujve (të familjes) së saj.” Kjo sepse sipas Manus “ajo kurrë nuk është e denjë për liri”⁴ bile edhe brenda mureve të shtëpisë.⁵ Ajo nuk lejohet të kryejë sakrificat fetare, ndërsa mund të agjërojë vetëm për burrin e saj.⁶

1.2. Judaizmi

Trajtimi i gjinisë femërore në traditat Judo-Krishtere orientohet nga imazhi i Evës që paraqitet si joshëse në Bibël. Besohet se të gjitha gratë kanë trashëguar, nga nëna e tyre - Eva, fajin e saj. Prandaj të gjithë ato janë të pabesueshme, të dobëta moralisht dhe të liga. Prandaj menstruacioni, shtatzënia dhe rritja e fëmijëve u konsideruan dënim i merituar për to. Po të shqyrtojmë Dhjatën e vjetër do t'i gjejmë fjalët e Predikuesit, të birit të Davidit, mbretit të Jeruzalemit që përshkruan gruan në këtë mënyrë

“dhe gjeta një gjë më të hidhur se vdekja; gruan, zemra e së cilës është kurth dhe grackë dhe duart e së cilës janë pranga. Kush i pëlqen Perëndisë, i shpëton asaj; por mëkatari do të kapet nga ajo. Ja ajo që gjeta”, thotë Predikuesi, duke i shqyrtuar një për një gjërat, për të gjetur shkakun e tyre.”

[Predikuesi 7:26-27]

Në literaturën hebraike që njihet edhe nga kisha Katolike, lexojmë:

“Asnjë ligësi nuk mund t'i përngajë ligësisë së femrës... mëkati filloi nga një grua dhe fal saj ne të gjithë do të pësojmë vdekjen.”

[Ecclesiasticus 25:19,24]

Sipas rabinëve çifutë, femra u dënua me nëntë ndëshkime për shkak të daljes nga paraja:

“Gruas i dha (Zoti) nëntë mallkime dhe vdekjen: barra e gjakut të menstruacionit dhe gjakut të virgjërisë; detyrimi i shtatzënisë; detyra e rritjes së fëmijëve;

koka e saj është mbuluar sikurse mban zi; ajo shpon veshin e saj si një skllav apo shërbëtore të përhershme; ajo nuk duhet besuar si dëshmitare; dhe pas gjithçkaje – vdekja.”⁷

Gruaja le të mësojë në heshtje dhe me çdo nënshtrim.

“Nuk e lejoj gruan që të mësojë, as të përdori pushtet mbi burrin, por të rrijë në heshtje.”

[1 e Timoteut 2:11-12]

Sipas përshkrimit të Zanafillës:

“Atëherë Zoti Perëndi formoi njeriun nga pluhuri i tokës, i fryu në vrimat e hundës një frymë jete, dhe njeriu u bë një genie e gjallë.”

[Zanafilla 2:7]

Por pastaj duke parë që njeriu është i vetëm dhe kishte nevojë për ndihmë që i leverdiste Ai i çoi njeriut tërë kafshët e dheut dhe tërë zogjtë e qiellit por “nuk u gjend asnjë ndihmë e përshtatshme për të”.

“Atëherë Zoti Perëndi e futi në një gjumë të thellë njeriun, të cilin e zuri gjumi; dhe mori një nga brinjët e tij dhe e mbylli mishin në atë vend. Pastaj Zoti Perëndi me brinjën që i kishte hequr njeriut formoi një grua dhe e çoi te njeriu. Dhe njeriu tha “Kjo së fundi është kocka e kockave të mia dhe mishi i mishit tim. Ajo do të quhet grua sepse është nxjerrë nga burri.”

[Zanafilla 2:21-23]

Termi *ndihmë* është interpretuar historikisht si Eva ishte e varur prej Adamit dhe kishte një rol inferior. Sipas Zanafillës, Lameku ishte i pari që u martua dy herë. Judaizmi nuk jep asnjë udhëzim për numrin e grave. Andaj në Dhjatën e vjetër përmendet që: Esau mori 3 gra, Jakobi:2; Ashuri:2; Gideoni:shumë; Davidi:shumë; Solomoni:700; Abixhah:14 etj.

Një sërë vargësh cilësojnë femrat pro-na të prindërve të tyre dhe pas martesës, të burrave të tyre.

“Në rast se dikush shet bijën e tij si shërbëtore, ajo nuk do të shkojë ashtu si shkojnë skllavërit.”

[Eksodi 21:7]

Domethënë nëse do babai, ai mund ta shesë vajzën e tij. Ndonëse skllavërit liroheshin pas 6 vjetësh, femrat mbeteshin si shërbëtore përgjithmonë.

Sipas ligjit të përtërirë femra kur martohet duhet të jetë e virgjër dhe nëse ajo kishte marrëdhënie seksuale para martesës, pra, në shtëpinë e babait të saj, atëherë ajo dënohej me vdekje me gurë. Ndërkohë ligji nuk parashikonte ndonjë ndëshkim për mashkullin.

“Në qoftë se një burrë martohet me një grua, hyn tek ajo dhe pastaj fillon ta urrejë, dhe e padit për gjëra të turpshme dhe i nxjerr një nam të keq, duke thënë: “Mora këtë grua, por kur iu afrova nuk gjeta tek ajo shenjat e virgjërisë”, babai dhe nëna e së resë (vajzës) do të marrin shenjat e virgjërisë së saj dhe do t’ua tregojnë pleqve të qytetit, te porta; dhe babai i së resë (vajzës) do t’u thotë pleqve: “Unë ia dhashë time bijë për grua këtij burri, por ai filloi ta urrejë, dhe tani e akuzon për gjëra të turpshme, duke thënë: Nuk gjeta tek jote bijë shenjat e virgjërisë; por këto janë shenjat e virgjërisë të bijës sime”. Dhe do të shpalosin çarçafin përpara pleqve të qytetit. ...Por në qoftë se vërtetohet fakti dhe tek e reja (vajza) nuk janë gjetur shenjat e virgjërisë, atëherë do ta nxjerrin të renë (vajzën) te pragu i shtëpisë së babait të saj dhe njerëzit e qytetit të saj do ta vrasin me gurë, dhe ajo ka për të vdekur, sepse ka kryer një vepër të turpshme në Izrael, duke u bërë kurvë në shtëpinë e atit të saj. Kështu do të shkulësh të keqen nga gjiri juaj”

[*Ligji i Përtërirë 21:13-21*]

Ligji i Përtërirë gjithashtu nuk ia jep gruas të drejtën për të kërkuar divorc. Ky akt mund të kryhet vetëm nga burri dhe jo nga gruaja:

“Kur një njeri merr një grua dhe martohet me të, dhe më vonë ndodh që ajo nuk e kënaq më, sepse ai ka gjetur në të diçka të turpshme, le të shkruajë një shkresë ndarjeje, t’ia japë në dorë dhe ta dëbojë nga shtëpia e saj;”

[*Ligji i Përtërirë 24:1*]

1.3. Krishterimi

Feja krishtere trashëgon imazhin e gruas nga judaizmi dhe i jep një kuptim më të rëndë. Mëkati i saj do të luante rolin qendror në fenë krishtere sepse, qëllimi i ardhjes së Krishtit dhe sakrificës së tij ishte vetëm çlirimi i njeriut nga makthi i mëkatit që kreu Eva dhe kështu pastrimi i njerëzimit nga trashëgimi i mëkatit.

Në 1 e Korintasve shkruhet:

“...burri nuk duhet të mbulojë kryet, sepse është shëmbëllimi dhe lavdia e Perëndisë, kurse gruaja është lavdia e burrit, sepse burri nuk është nga gruaja, por gruaja nga burri, edhe sepse burri nuk u krijua për gruan, por gruaja për burrin”

[1 e Korintasve 11:7-9]

Shën Pauli u drejtohet grave në këtë mënyrë:

“Ju, gratë, nënshtrohuni burrave tuaj porsì Zotit, sepse burri është kreu i gruas, sikurse edhe Krishti është kreu i kishës, dhe ai vetë është Shpëtimtari i trupit. Ashtu si kisha i është nënshtroar Krishtit, kështu gratë duhet t’i nënshtrohen burrave të tyre në çdo gjë.”

[Efesianëve 5:22-24]

Gjuha e Sh. Tertullianit është akoma më e ashpër. Ai u drejtohet motrave të tij të dashura në fe, duke thënë:

“A dini se secila prej jush është një Evë? Nëse dënimi i Zotit mbi seksin tuaj qëndron edhe sot e kësaj dite, atëherë sigurisht edhe faji duhet të ekzistojë. Ju jeni derë hyrëse për djallin. Jeni ju që prekët pemën e ndaluar; ju jeni dezertoret e para të ligjit hyjnor. Ju jeni që e kandisët Adamin, të cilën as djalli nuk guxonte ta sulmonte. Ju shkatërruat aq lehtë imazhin e Zotit, njeriun. Për shkak të mëkatit tuaj edhe i biri i Zotit duhej të vdiste.”⁸

Sot Greqia e vjetër konsiderohet si djep i kulturës evropiane dhe grekët e lashtë mbahen si pararendësit e epokës së re. Por edhe atje gruaja nuk ishte në një gjendje tjetër:

“Gratë athinase gjithmonë ishin të parëndësishme, varur prej një mashkulli, prej babait të tyre, vëllait apo një burri nga fisi i tyre.”⁹

“Zakonisht miratimi i saj për martesë nuk konsiderohej si diçka e rëndësishme dhe pritej që ajo t’i nënshtrohej dëshirës së prindërve dhe burrin e padronin e saj ta merrte prej tyre, pavarësisht që ai mund të ishte krejtësisht i huaj për të.”¹⁰

Enciklopedia ‘Britanike’ përshkruan statusin ligjor të gruas që i jepte perandoria romake. Sipas këtij përshkrimi:

“Në ligjin romak gruaja historikisht trajtohej si plotësisht e varur. Nëse martohej, ajo dhe pasuria e saj kalonte te burri i saj... gruaja ishte prona e blerë e burrit të saj, dhe si një shërbëtore merrej vetëm për dobinë e tij. Gruaja nuk mund të ushtronte ndonjë detyrë civile apo publike, nuk mund të paraqitej si dëshmitare, garantuese, mësuese apo përgjegjëse. Nuk kishte të drejtë për të adoptuar as për t’u adoptuar ose të linte testamentin dhe të bënte marrëveshje.”¹¹

Tani në diskutimin e mëtejshëm do të kthehemi te Islami se si ai shquhet nga fetë

e tjera në aspekte të ndryshme të jetës njerëzore, d.m.th. shpirtërore, shoqërore dhe ekonomike dhe politike.

STATUSI I GRUAS NË ISLAM

1. Aspekti shpirtëror

Islami i jep gruas të gjitha të drejtat politike dhe shoqërore, që gëzon edhe mashkulli. Ajo përfiton të gjitha privilegjet që përpara ishin të caktuara vetëm për gjininë mashkullore. Përveç çështjeve materiale, barazia gjinore shtrihet edhe në sferën shpirtërore. Islami e shfajësoi gruan nga akuzat dhe fajësimet shekullore sipas të cilave ajo ishte fajtorë dhe përgjegjëse sepse ishte ajo që mëkatoi duke marrë mollën e ndaluar. Sipas Kuranit, të dy Ademi dhe Eva, kishin gabuar por ishin të pavetëdijshëm për atë veprim dhe pastaj të dy u penduan dhe Zoti ua fali të dyve. [el-Bakrrah 2:37, El-A'rraf 7:21-24]. Madje në suren Ta Ha [20:122] thuhet se ishte Ademi ^{alchiselman}, ai që nuk e zbotoi urdhrin e Allahut. Veç kësaj Kurani e quan këtë veprim gabim sepse nuk ishte bërë qëllimisht. Kështu Islami liroi bijtë e Evës nga dogma të rreme shekullore që i dënonte për atë krim që ajo nuk kishte kryer kurrë. Islami ia dha dinjitetin, nderin dhe vetëbesim që i mungonte gjatë shekujve të tërë. Kurani i Madhërishtëm e kurorëzoi femrën në pozicion të barabartë me burrin dhe e nënvizon barazinë shpirtërore në mënyrë të përsëritur. Fjala bie:

“Me të vërtetë që myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të sinqertët) dhe të drejtat (të sinqertat), duruesit dhe durueset, të përulurit dhe të përulurats, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe

përkujtueset, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.”

[El-Ehzab 33:36]

“... do t'ua pranojë pendimin besimtarëve dhe besimtareve. Vërtetë Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.

[El-Ehzab 33:74]

Islami u premtonte burrave dhe femrave mbrojtje të barabartë. Për shembull:

“Ata që i lëndojnë besimtarët dhe besimtare, duke i akuzuar për diçka që nuk e kanë bërë, në të vërtetë, i kanë ngarkuar vetes fajin për shpifje dhe një gjynah të qartë.”

[El-Ehzab 33:59]

“Pa dyshim, ata që i përndjekin besimtarët dhe besimtare e nuk pendohen, i pret dënimi i Xhehenemit dhe dënimi me djegie.”

[El-Buruxh 85:11]

Burrat dhe gratë do të shpërblehen baras në jetën e pastajme:

“Dhe kushdo që bën vepra të mira, qoftë ai mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhenet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi.”

[En-Nisa 4:125]

“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, me kusht që të jetë besimtar, Ne do t'i bëjmë që të kalojnë jetë të bukur dhe do t'i shpërblejmë sipas veprave më të mira, që kanë bërë.”

[En-Nahl 16:98]

“... ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, qofshin meshkuj apo femra, do të hyjnë në Xhenet. Aty do të begatohen pa kufizim.”

[El-Ghafir 40:41]

“Besimtarët dhe besimtare janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zeqatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t'i mëshirojë Allahu. Se, Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë. Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të

banojnë përgjithmonë, si dhe pallate të mrekulueshme në Xhenetin e Përjetësisë. Por kënaqësia prej Allahut është shpërblimi më i madh. Kjo është fitore madhështore.”

[Et-Taubeh 9:71-72]

“(Ai e bëri këtë) për t’i çuar besimtarët dhe besimtare të kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përherë, si dhe që t’ua largojë mangësitë atyre. Kjo, në sytë e Allahut, është fitorja më e madhe.”

[El-Fet’h 48:6]

(Allahu do t’u thotë): “O robërit e Mi, për ju sot nuk ka frikë dhe as që do të pikëlloheni. ... Hyni në Xhenet të gëzuar, ju dhe shokët tuaj.”

[Ez-Zukhruf 43:69-70]

“Sigurisht që atë ditë banorët e Xhenetit nuk do të mendojnë për gjë tjetër, veç lumturisë së tyre. Ata dhe gratë e tyre do të jenë në hije, të mbështetur në ndenjësë. Për ata do të ketë aty fruta dhe çdo gjë që dëshirojnë.”

[Ja Sin 36:56-58]

...ditën që do të shohësh besimtarët dhe besimtare, me dritën e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre (e do t’u thuhet): “Lajm i mirë sot për ju: (Ju gëzojnë) kopshtet e Xhenetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të banojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja më e madhe!”

[El-Hedid 57:13]

Kur Kurani i Madhërisëm flet për shpirtin e njeriut, ai nuk bën dallime gjinore.

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një shpirti, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkon prej njëri-tjetrit dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.”

[En-Nisa 4:2]

Këtu fjala “shpirt” përfshin të dy gjinitë, atë mashkullore dhe femërore. Ato janë dy pjesë përbërëse që së bashku kryejnë një funksion. Kjo vërteton që këta të dy i

përkasin të njëjtit lloj dhe specie dhe kanë të njëjtën prirje.

Këtu ndryshimi në formën dhe trajtën fizike thyhet dhe në sferën shpirtërore të dy shkrihen në një formë të vetme. Kjo barazi në gjendjen shpirtërore theksohet edhe më shumë kur Kurani deklaron se mashkulli dhe femra plotësojnë njeri-tjetrin. Ai thotë:

“Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre (dhe tha): “Unë nuk do t’ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni prej njëri-tjetrit. Prandaj, atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrat e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t’ua mbuloj veprat e këqija dhe do t’i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Shpërblimi më i mirë është tek Allahu.”

[Ale-Imran 3:196]

2. Aspekti Shoqëror

Familja është njësi bazë e çdo shoqërie, nën hijen e së cilës formohet dhe mishërohet e ardhmja. Është pikërisht ambienti i shtëpisë ku fëmija jo vetëm rritet por merr edhe mësimet e para të jetës. Ai ushqehet me moralet, vetitë dhe virtytet e larta pikërisht në prehrin e nënës. Aty fiton edukatën e duhur dhe merr formimin, botëkuptimin dhe zhvillimin e tërësisë së cilësive shpirtërore, mendore, fizike e kulturore etj.

Familja paraqet marrëdhënie shembullore midis burrit dhe gruas si dhe midis prindërve dhe fëmijëve. Prandaj Kurani ua mëson besimtarëve këtë lutje:

“edhe ata (besimtarë të devotshëm) që thonë: “O Zoti ynë, falna dhe na dhuro gëzim e qetësi nga ana e bashkëshortëve dhe bashkëshorteve tona e nga ana e trashëgimtarëve tanë, atë që është prehje për sytë tanë dhe bëna udhëheqës për të devotshmit!”

[El-Furkan 25:75]

Po kjo gjini që shfaqet herë si nënë, herë si vajzë, herë si motër dhe herë si grua dhe në shumë e shumë role të tjera në shoqëri, është shtylla kryesore e jetës familjare dhe asaj shoqërore në përgjithësi.

Le t'i kthehemi Islamit për të parë se çfarë udhëzimesh dhe mësimesh ai na jep për këto role shoqërore që ka një grua.

2.1. Vajza

Në dogmat fetare para Islamit lindja e vajzës krahasohej si humbje e madhe¹² dhe shkaku i mundshëm i turpërimit.¹³ Pikërisht ishte kjo ide për t'i trajtuar vajzat si burimet e mundshme të turpërimit që shkaktoi praktikën e vrasjes së vajzave në foshnjëri. Kurani, në radhë të parë, kundërshtoi dhe hodhi poshtë këtë praktikë me fjalë të ashpra:

"...kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet për çfarë faji ishte vrasë."

[Et-Tekvirr 81:9-10]

Duke kritikuar fort këtë sjellje diskriminuese ndaj vajzave Kurani i tërheq vëmendje lexuesve duke thënë:

"Dhe, kur ndonjëri prej tyre merr lajmin se i lindi një vajzë, fytyra i nxihet (nga hidhërimi) dhe ai ndrydh (ndjenjat). Ai fshihet nga njerëzit për shkak të lajmit të keq që mori dhe s'di: a ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit apo ta varrosë në dhé. Ah! Sa mbrapsht që gjykojnë ata!"

[En-Nahl 16:59-60]

Islami u kërkon myslimanëve trajtim të barabartë midis djalit dhe vajzës. Islami jo vetëm theu dhe eliminoi këtë zakon të rrezikshëm por i dha vajzës të drejta të barabarta brenda familjes. Prej thënieve të të Dërguarit të Allahut^{savs} shënojmë këtu poshtë disa që theksojnë sjellje të njëllojta:

Cilido që ka një vajzë dhe ai nuk e

varros atë për së gjalli, nuk e fyen e as nuk i jep epërsi djalit mbi të, Zoti do të fusë në xhenet.¹⁴

Cilido që i mbështet dy vajza derisa ato arrijnë pjekurinë, ai dhe unë do të vijmë në Ditën e Gjykimit si kështu (dhe ai tregoi dy gishta të tij të bashkuar).

Është një hadith që përforcon këtë mësim:

"Aisheja^{ra} rrëfen: Më erdhi një grua e varfër me dy vajza të saj. Unë i dhashë tri hurma. Ajo i dha nga një secilës dhe ia afroi vetes atë të fundit për të ngrënë, por vajzat i kërkuan edhe atë. Atëherë ajo e ndau në dy pjesë dhe ua dha atyre. Unë u çudita shumë nga veprimi i saj dhe i tregova të Dërguarit^{savs} atë që kishte ndodhur. Ai u përgjigj "Allahu e shpërbleu me xhenet si rezultat të këtij veprimi", ose në këtë mënyrë: "Allahu e liroi nga zjarri si shpërblim i kësaj sjelljeje".

Në kundërshtim me qëndrimin e Biblës, Kurani e vlerëson lindjen e vajzës si një dhuratë dhe bekim prej Zotit, ashtu siç është e djalit bile edhe pak më e spikatur sepse ai e radhit këtë gjini para gjinisë mashkullore.

"Allahut i takon pushteti mbi qiejt dhe Tokën. Ai krijon çfarë të dojë. Ai i dhuron vajza kujt të dojë e djem kujt të dojë."

[Esh-Sh'ura 42:50]

2.2. Gruaja

Para Islamit gruaja trajtohej jo më shumë se një shërbëtore dhe nuk gëzonte asnjë të drejtë, ndërsa me ardhjen e Islamit jo vetëm që ajo fitoi dinjitetin dhe respektin por edhe të drejtat e barabarta në të gjitha nivelet me burrin e saj.

"Dhe një prej shenjave të Tij është (edhe kjo) që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë

ka shumë shenja, për njerëzit që mendojnë.”

[Err-Rruum 30:22]

Martesa është bashkimi i harmonizuar i dy shpirtave, me qëllimin kryesor që të dy të gjejnë kënaqësi nga njëri-tjetri. Kurani i Madhërishëm shpjegon barazinë dhe ekuilibrin e kësaj marrëdhënie reciproke në këtë ajet duke thënë:

“Ato janë petk për ju e ju jeni petk për to.”

[El-Bekarrah 2:188]

Një herë i Dërguari i Allahut ^{savs} tha:

“Myslimani më i përkryer në çështjen e besimit është ai që ka sjellje të shkëlqyeshme; dhe më të mirët ndër ju janë ata që sillen mirë me gratë e tyre.”

[Al-Tirmidhi 278]

Duke theksuar sjelljen ndaj gruas, i Dërguari i Allahut ^{savs} thotë: “O njerëz! Kini frikën Allahut lidhur me sjelljen ndaj grave”. Në një rast tjetër, tha: “Pranojeni këtë këshillë dhe silluni me mirësi lidhur me të drejtat e grave.” Burri duhet të kujdeset për çështjet shtëpiake dhe të plotësojë nevojat e shtëpisë, siç thotë Hazret Aliu ^{ra}: “Burri nuk mund të quhet zoti i shtëpisë nëse ai mban qëndrim mospërfilës ndaj shtëpisë së tij.”

Domethënë Islami i jep gruas të drejta të barabarta që ajo të përmbushë sa më mirë detyrat e saj për rritjen, edukimin dhe mësimin e fëmijëve të saj.

2.3 Nëna

Pavarësisht nga fakti që mund të gjejmë shumë udhëzime shumë të bukura në Dhjatën e vjetër rreth respektit të printerëve¹⁵ ne nuk gjejmë dot mësim të veçanta për sjelljen ndaj nënave. Ndërkohë po të lexojmë Dhjatën e re, ajo na bën përshtypja sikur dashuria ndaj nënës është një pengesë në rrugën e Zotit. Mund të gjejmë Krishtin duke ua treguar ndjekësve të tij kushtin e ndjekjes së tij:

“Nëse ndokush vjen tek unë dhe nuk urren babanë e vet dhe nënën e vet, gruan dhe fëmijët, vëllezërit dhe motrat, madje edhe jetën e vet, nuk mund të jetë dishepulli im.”

[Luka 14:26]

Kurse në një vend tjetër shohim se Krishti ishte indiferent ndaj nënës dhe vëllezërve të tij. Për shembull një herë kur ai i predikonte një turme, erdhi nëna e tij duke e kërkuar, por ai nuk i kushtoi asaj aspak vëmendjen.

“Ndërkaq erdhën vëllezërit e tij dhe e ëma dhe, si ndaluan përjashta, dërguan ta thërrasin. Turma ishte ulur përreth tij; dhe i thanë: “Ja, nëna jote dhe vëllezërit e tu janë përjashta dhe po të kërkojnë”. Por ai u përgjigj atyre duke thënë: “Kush është nëna ime, ose vëllezërit e mi?”. Pastaj duke vështruar rreth e qark mbi ata që ishin ulur rreth tij, tha: “Ja nëna ime dhe vëllezërit e mi! Sepse kushdo që bën vullnetin e Perëndisë, ai është vëllai im, motra ime dhe nëna!”

[Marku 3:31-35]

Islami i përkushton nënës respekt dhe nder të pakrahasueshëm. Mirësjellja ndaj prindërve radhitet pas adhurimit të Zotit.

“Zoti yt ka vendosur, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i qorto, por drejtoju atyre me butësi dhe respekt. Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: “O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë nderuar, kur unë isha i vogël!”

[El-Isrraa 17:24-25]

Kurani gjithashtu vë në dukje mundimet dhe vuajtjet e jashtëzakonshme që përjeton nëna gjatë shtatzënisë. Ai thotë:

“Ne e kemi urdhëruar njeriun në mënyrë të veçantë në lidhje me prindërit e tij. Nëna e ka bartur atë, duke duruar mundim pas mundimi...”

[Lukman 31:15]

I Dërguari i Allahut ^{savs} ka sqaruar gjithashtu vendin e veçantë që zë nëna në shoqërinë islame.

Një person e pyeti të Dërguarin e Allahut ^{savs}: “Kë duhet të respektoj më shumë? I Dërguari i Allahut ^{savs} iu përgjigj: “Nënë tënde.” “Kush radhitet më pas?” pyeti ai. I Dërguari i Allahut ^{savs} iu përgjigj: “Nëna jote”. Po pastaj kush? Dhe përsëri Profeti i shenjtë ^{savs} i tha “Nëna jote”. Po pastaj kush vjen? E pyeti personi. Profeti i shenjtë ^{savs} iu përgjigj “Babai yt”.

[Bukhariu & Muslimi]

Në një nga thëniet më të famshme të Profetit të shenjtë ^{savs} që tregon më së miri pozitën e lartë të gruas, thuhet:

“Xheneti shtrihet nën këmbët e nënës.” Ky është vlerësimi më i madh që Islami i jep gruas, që tejkalon edhe pozitën e mashkullit. Ai i jep asaj një vlerësim që nuk mund të gjendet në asnjë fe apo qytetërim tjetër.

Është një fjali që përmban kuptime të thella, se mos varni shpresat tuaja vetëm me xhenetin e botës tjetër por ju mund të bëni pjesë edhe në atë parajsë tokësore ku çdo nënë është mbretëresha e shtëpisë dhe krijon një parajsë të vogël brenda familjes. Është ajo parajsë ku fëmijët edukohen, ushqehen dhe mbruhën në atë drejtim, mbi bazat e të cilit, ndërtohet shoqëria modele shembullore. Ku rrënjosen vlerat morale, shpirtërore dhe kulturore, ku marrëdhëniet e ndërsjella bazohen mbi sinqeritetin, dashurinë dhe respektin dhe jo mbi interesa vetjake. Ku dashuria e Zotit lëshon rrënjë dhe pastaj kjo dashuri shndërrohet në burimin e çdo lloj dashurie. Kështu që parajsa këtu i përgjigjet edhe parajsës shoqërore tokësore edhe asaj qiellore.

Në një rast tjetër i Dërguari i Allahut ^{savs} iu drejtua besimtarëve duke thënë:

Allahu ju ka ndaluar të jeni mospërfillës ndaj nënave tuaja”. [Bukhariu]

Ashtu si një shkollë apo universitet, që i ngarkon mësuesit dhe pedagogët me detyrën e mësimdhënies së nxënësve dhe studentëve, ato gjithashtu kujdesen që mësuesit apo pedagogët të kenë njohuri dhe trajnim të mjaftueshëm për të kryer këtë detyrë. Po në të njëjtën mënyrë Islami jo vetëm që i cakton detyrat, por, gjithashtu dikton mënyrën për përmbushjen e tyre duke i dhënë modele dhe sjellje për t’i përvetësuar. Që nga fëmijëria, krijohen kushte të përshtatshme dhe ambienti mësimor ku formohet dhe krijohet mësuesja e së ardhmes që do të ushtrojë këtë detyrë më vonë.

Pavarësisht nga statusi i barabartë midis dy gjinive, akoma ekziston njëfarë dallimi midis mashkullit dhe femrës, që buron nga natyra fizike e tyre. Po të mos merrej parasysh ky dallim, atëherë nuk do të kishim dallim midis lojtarëve meshkuj dhe femra në lojëra sportive. Pikërisht në varësi të kësaj larmie, ekziston edhe dallimi midis detyrave shoqërore.

Shembulli i funksioneve dhe aftësive të ndryshme mund të kuptohet më mirë nëse shohim se vetëm grua mund të lindë fëmijë ndërsa burri jo, veç kësaj ajo është pajisur me aftësi fiziologjike dhe psikologjike si dhe cilësi të tjera si durimi, butësia dhe lidhja unike që i bën më të përshtatshme për t’i rritur fëmijët.

Në shoqëri burri dhe grua gëzojnë të drejtat e barabarta. Prandaj Kurani thotë:

“Besimtarët dhe besimtares janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepër të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zeqatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t’i mëshirojë Allahu. Se, Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”

[Et-Taube 9:72]

Fjala “*evlija*” e përdorur në këtë ajet, tregon më së miri, të drejtat dhe detyrat e ndërsjella të grave, si dhe përgjegjësitë dhe autoritetet e përbashkëta që ndajnë meshkujt e gratë ndaj shoqërisë. Ndalimi i së keqes dhe urdhri i së mirës është orbita e veprimtarisë së saj që mbulon të gjitha aktivitetet e saj shoqërore e politike. Si shembull Kurani përmendet mbretëreshën e *Shebës* që sundonte në vendin e saj.¹⁶

2.4. E drejta e arsimit

Arsimi dhe shkollimi është i detyrueshëm për çdo mysliman apo myslimane. Para Islamit ajo kalonte një jetë injorante dhe mbizotërohej plotësisht nga mashkulli. Islami i dha të drejta të barabarta edhe në fushën e arsimimit. Në Islam dija dhe arsimimi janë tema të theksuara, bile janë pjesë përbërëse të kulturës Islame. Përveç Kuranit edhe në hadithe arsimimi dhe dituria vlerësohen së tepërmi. Faktikisht gjithë synimi i shpalljes hyjnore dhe dërgimi i profetëve te njerëzit, sipas Kuranit është komunikimi i diturisë.

Në Kuran gjenden shumë ajete që lëvdojnë njerëz të arsimuar, që inkurajojnë gjurmimin origjinal, kërkimin personal dhe denoncojnë besime të kota. I Dërguari i Allahu ^{savs} thotë: “Profetët lënë diturinë si trashëgim pas tyre dhe të diturit trashëgojnë këtë pasuri.” Në një rast tjetër tha: “Ai që merr përsipër udhëtim në kërkim të diturisë, (konsiderohet se) është në rrugë të Allahut derisa mbaron këtë udhëtim.” Prandaj dituria dhe arsimi u trajtuan si pjesë të besimit, dhe si rrjedhojë të gjitha shtresat e shoqërisë morën pjesë në këtë proces. Profeti i shenjtë ^{savs} tha: “Trajtojini me drejtësi studentët e varfër si dhe të pasur, që ulen para jush për arsim.”

Islami e thekson arsimin e femrave jo vetëm në fushën fetare por edhe në atë laike. Këtu nuk ka asnjë dallim dhe të dy inkurajohen që të arsimohen. Profeti i shenjtë ^{savs} thotë: “Kërkojeni dijen nga djepi deri në varr” (domethënë në çdo moshë). Profeti i shenjtë ^{savs} është shprehur një herë se: “Kërkimi i diturisë është detyra e çdo myslimani dhe myslimaneje”. Ai hapi të gjitha rrugët për përhapjen e dijes. Ai vetë i mësonte gratë ashtu siç mësonte meshkujt. Kishte caktuar ditë kur u bënte predikime grave. Duke ndjekur udhëzimet e Kuranit dhe të Profetit të shenjtë ^{savs} një pjesë e madhe e grave u shquan në arsimin fetar, sidomos në shkencën e *hadithit* apo të ligjit fetar. Gratë myslimane luajtën rol të rëndësishëm në krijimin e shumë institucioneve arsimore Islamike. Sipas dijetarit suni Ibne Asakir të shekullit XII, në botën Islame të mesjetës, gratë kishin mundësi të barabarta në fushën e arsimit. Ato mund të shkruanin, mund të vazhdonin studime të larta, mund të fitonin gradë shkencore dhe të diplomoheshin si studiuese apo mësuese.¹⁷ Në shek. XV, El-Sahavi ia përkushtoi një vëllim të tërë studiueseve myslimane nga fjalori i tij biografik prej 12-vëllimesh “*Dav al-lami*” duke dhënë informacion rreth 1075 prej tyre.¹⁸

Siç përmendëm më sipër, nuk ka asnjë ajet në Kuran apo thënia e Profetit të shenjtë ^{savs} që ndalon kategorikisht arsimin e femrave, por fatkeqësisht shpeshherë dëgjohen zëra kundër arsimit të femrave. Shembulli më i freskët është i atyre talibanëve, të cilët menjëherë pas pushtetit të Kabulit, në shtator 1996, shpallën urdhrat, sipas të cilëve femrave u ndalohet që të ndjekin shkollat.¹⁹ “Më 16 qershor 1998, talibanët lëshuan urdhër për të mbyllur më shumë se 100 shkolla private ku mijëra vajzat mësonin zanate dhe

mjeshtëri të ndryshme, që mund t'i kishin ndihmuar për të mbështetur familjet e tyre. ... Sipas ligjeve të reja arsimit për vajzat do të vazhdojë deri në moshën 8 vjeçare dhe i kufizuar vetëm te Kurani.”²⁰ Fatkeqësisht stereotipe të tilla, veprimet e të cilëve nuk e përkojnë aspak Islamin, gjejnë mjaft publicitet dhe reklamë nëpër gazeta apo televizione dhe kështu shkaktojnë përshtypje negative rreth Islamit.

3. Aspekti ekonomik

Në vendet perëndimore gratë në përgjithësi dhe gratë e martuara në veçanti kishin pak apo aspak të drejtë në çështjet e trashëgimisë së pronave. Deri në shek. XVI grave u mohohet e drejta për t'i trashëguar pronat.²¹

Para Islamit, në shoqërinë arabe edhe nënat konsideroheshin pjesë e trashëgimisë dhe ndaheshin midis fëmijëve.

Encyclopedia American International përshkruan përmbledhjen e ligjeve që zbatoheshin në Anglinë e viteve 1850. Sipas tij:

“E gjithë pasuria e paluhatshme që zotëronte gruaja para martesës, kalonte në pronësinë e burrit të saj. Ai kishte të drejta të plota për të marrë qira nga pronat apo ndonjë fitim nga menaxhimi i pronësisë së saj gjatë kohës sa ishin të martuar. Pastaj si kaloi koha, Gjykata Angleze mori masat për t'ia ndaluar burrit transferimin e pronave të paluhatshme pa pëlqimin e bashkëshortes, por ai akoma gëzonte të drejtën për të menaxhuar pronat e saj dhe për të marrë paratë që prodhonin ato. Për sa i përket pasurisë personale të gruas, burri kishte fuqi absolute. Ai kishte të drejtën ta shpenzonte atë ashtu siç dëshironte.”²²

Islami përkrah drejtësinë. Ai jo vetëm i cakton pozitën e barabartë por

i krijon mundësi të njëjlojta në çështje ekonomike. Feja Islame është e para që i dha të drejtën e trashëgimisë. Tani ajo duke qenë bashkëshorte trashëgonte pronat e burrit, duke qenë vajzë trashëgonte pasurinë e babait dhe duke qenë nënë trashëgonte pronat e fëmijëve. Bernard Lewis-i shkruan:

“Islami vendos një barazi në aspektin shoqëror midis burrit dhe gruas, gratë myslimane kanë pasur historikisht të drejtat e pronësisë, diçka që ka qenë e pashembullt në perëndimin modern relativisht deri në kohët e fundit.”²³

Kurani jep udhëzimet rreth trashëgimisë në këtë mënyrë:

“Meshkujve u takon pjesë nga ajo që ua kanë lënë prindërit dhe të afërmit, por, edhe femrave u takon pjesë nga ajo që ua kanë lënë prindërit dhe të afërmit qoftë ajo pak apo shumë, si pjesë e caktuar dhe e detyruar.”

[En-Nisa 4:8]

“Në qoftë se nuk keni fëmijë, atyre (grave) u takon një e katërta e pasurisë që keni lënë e, nëse keni fëmijë, atyre u takon një e teta nga ajo që keni lënë, pasi të kryhet testamenti e të lahet borxhi.”

[En-Nisa 4:13]

“...e për çdonjërin prind të të vdekurit - u përket një e gjashta nga pasuria e trashëguar, nëse i vdekuri ka lënë fëmijë...”

[En-Nisa 4:12]

Prof. Almaric Rumsey (1825-1899), që punoi në King's College, University of London, shkroi në një ndër librat e tij për çështjet ligjore:

“Ligji islamik rreth trashëgimisë, pa dyshim përbëhet nga një sistem rregullash që mbetet sistemi më i detajuar dhe më i përparuar për ndarjen e pronave që ka njohur bota e qytetëruar.”²⁴

Zakonisht mendohet se Islami diskriminon femrën në ndarjen e trashëgimisë

duke i dhënë gjysmën e asaj që ai përcakton për mashkull, por ky është gabim i perceptimit sepse ajo ka pjesë edhe në trashëgiminë e burrit, si dhe mashkullit i ngarkohet përgjegjësia financiare. Veç kësaj kur ajo martohet, burri i saj i jep *mehrr* (prikë) ndërsa ajo nuk detyrohet të paguajë një gjë të tillë. Nëse ata ndahen, atëherë Islami si mbrojtësi i saj, nuk e lejon burrin që të kërkojë diçka prej saj që ai i kishte dhënë. Kështu që Islami jo vetëm mbron të drejtën e saj, por edhe e ruan nga abuzimet e mundshme.

Islami e lejon femrën të punojë nëse e detyron gjendja ekonomike duke respektuar rregullat dhe udhëzimet të parashtruara nga feja, por është burri ai që është përgjegjës për të siguruar nevojat e shtëpisë. Megjithatë ajo duhet të dijë se detyra e saj parësore është rritja dhe edukimi i fëmijëve. Kurani gjithashtu siguron shpërblime të barabarta për punët e tyre:

“Allahu i krijoi qiejt dhe Tokën me qëllim të plotë, në mënyrë që çdo njeri të shpërblehet për atë që ka punuar. E, askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.”

[El-Xhathije 45:23]

Pavarësisht se Islami i jep femrës pozitën e barabartë me mashkullin por në disa ajete theksohet një farë epërsi për mashkull, siç thuhet:

“Gratë kanë aq të drejta (ndaj burrave) sa kanë ata (ndaj tyre), sipas arsyes së shëndoshë, ndonëse burrat kanë një shkallë (më shumë përgjegjësie) mbi ato. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”

[El-Bekarrah 2:229]

“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi ato dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre.”

[En-Nisa 4:35]

Hazret Mirza Tahir Ahmadi^a, Kalifi i Katërt i Mesihut të Premtuar, shpjegon këto ajete:

“Nga fjala arabe *kauvvamun* (kujdestarët, përgjegjësit për të orientuar ata që janë nën kujdesin e tij në rrugë të drejtë), disa ulema (dijetarë fetar) me botëkuptimin mesjetar, nxjerrin përfundimin dhe pohojnë epërsinë e meshkujve mbi femrat, ndërkohë ajeti i referohet vetëm asaj epërsie që gëzon zoti i shtëpisë mbi ata që varen prej tij. Kështu që, kujdestari është më kompetent që të ushtrojë presionin moral mbi ata që varen prej tij, që ata gjithmonë të rrugëtojnë në kah të drejtë. Për sa i përket të drejtave të saj elementare si qenie njerëzore, ky ajet në asnjë mënyrë nuk thotë se gratë nuk janë të barabarta me burrat apo meshkujt kanë një farë epërsie mbi to. Pjesa e fundit e ajetit i referohet kësaj epërsie të lartpërmendur dhe e bën më të qartë që pavarësisht nga ky avantazh, të drejtat themelore të grave janë pikërisht të barabarta me ato të burrave.”²⁵

Kështu që epërsia e burrit është faktikisht përgjegjësia e tij ndaj familjes, që i obligohet jo vetëm për çështjet financiare por edhe për ato morale.

Nëse shikojmë historinë e përpjekjeve apo lëvizjeve për të drejtat e grave do të gjejmë se gjatë viteve 1800 në Amerikë dhe në Angli kishin filluar të sfidonin ligjet që u merrte të drejtat mbi pasuritë e tyre nëse martoheshin. Në fillim të viteve 1840, legjislaturat në SHBA²⁶ dhe në parlamentin e Anglisë²⁷ paraqitën statutet që mbronin pronat e grave nga bashkëshortët e tyre apo nga huadhënësit e tyre. Këto ligje njihen në histori si *Married Women's Property Act* (Ligji i pronës së gruas së martuar).²⁸ Që në shekujt e parë Islami kishte vendosur këto ligje që gruas qoftë në rolin e vajzës, bashkëshortes apo të nënës, të mos i mohohet trashëgimia e saj.

4. Aspekti ligjor

Sipas Kuranit kur në ndonjë çështje gjyqësore ka nevojë për dëshmi atëherë “Thirrni dy dëshmitarë prej njerëzve tuaj e, nëse nuk gjeni dy dëshmitarë burra, atëherë thirrni për dëshmitarë një burrë dhe dy gra nga ata që i quani të përshtatshëm”. Tani nuk duhet kuptuar se dallimi midis burrit dhe gruas nuk nënvlerëson aftësinë e saj fizike apo mendore, sepse këtu udhëzimi i referohet faktit që gratë zakonisht nuk janë të mësuara me procedurat tregtare ku hollësira të specifikuar duhen shpjeguar sipas aspekteve ligjore, atëherë ka më pak rrezik që burrat do të gabojnë, Prandaj sipas Kuranit krahas një burri duhen dy gra sepse “nëse njëra grua harron, t’ia kujtojë tjetra.” [El-Bekrrah 2:283] Kështu që del qartë se ky urdhër mbron dinjitetin e saj dhe mbron atë nga gabimet e mundshme. Kurani qartëson këtë pikë duke shtuar që “kjo mënyrë është më e drejtë para Allahut, më e saktë për dëshmi dhe më e përshtatshme për të mos dyshuar.”

[El-Bekrrah 2:283]

MARTESA

Sipas Islamit, qëllimi kryesor i martesës është që të fitohet pëlqimi i Zotit. Martesa synon vazhdimësinë e jetës, mbrojtjen e dëlirësisë morale e jetën familjare bazuar mbi dashuri dhe kënaqësi. Islami e konsideron martesën si një akt ligjor që synon vijimësinë e jetës. Një nga thëniet e Profetit të shenjtë ^{savs} thotë: “Martesa është praktika ime dhe ai që i shmanget praktikës sime nuk është prej nesh.” Në një rast tjetër tha: “Cilido prej jush që ka mundësi për t’u martuar, duhet të martohet sepse ajo është mënyra më e mirë për mbrojtjen e moralit dhe frenimin e syve.”²⁹ Kështu që ajo është mënyra për të mbrojtur moralin nga sulmet e

djallit dhe për të siguruar një jetë të qetë familjare. Sipas Islamit, baza e kësaj marrëdhënie reciproke duhet të jetë mirësia.

“Jetoni e silluni mirë me to! Në qoftë se ato nuk ju pëlqejnë aq shumë, (duron!) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t’ju sjellë shumë të mira.”

[En-Nisa 4:20]

Karakteri i kësaj marrëdhënieje mund të kuptohet më mirë nga thënia e të Dërguarit ^{savs}:

“Kur i afroheni njeri-tjetrit, bëni këtë lutje: O Allah, mbrona kundër shejtanit, dhe mbaje shejtanin larg prej asaj që do na dhurosh Ti.”

Por meqenëse martesë është një marrëdhënie e përjetshme që kryhet me miratimin e të dyja palëve, prandaj nëse ata nuk mund të vazhdojnë këtë marrëdhënie atëherë Islami u jep leje për t’u ndarë. I Dërguari i Allahut ^{savs} ka cilësuar ndarjen se “leje më e papëlqyer”. Islami u jep këshilla të vazhdueshme për të ruajtur këtë lidhje por nëse mosmarrëveshja është e tillë që ata vetë nuk mund të pajtohen, atëherë sipas Kuranit duhet caktuar një këshill i përbashkët nga secili prej tyre, për t’i pajtuar ata.

“Nëse i druheni konfliktit midis burrit e gruas, atëherë caktoni një ndërmjetës nga ana e burrit dhe një nga ana e gruas. Në qoftë se ata dëshirojnë pajtim, Allahu sjell marrëveshje midis tyre. Allahu, me të vërtetë, është i Gjithëdijshtëm dhe i di të gjitha qëllimet.”

[En-Nisa 4:36]

Sipas Kuranit nëse dështojnë të gjitha përpjekjet për pajtim midis çiftit atëherë divorci mbetet e vetmja rrugë qetësie. Islam i jep secilit të drejtën për të kërkuar divorcin. Ndërkohë në rast se divorcin e kërkon gruaja atëherë veprimi bëhet me anë të gjykatës që të mos cenohen të drejtat e saj. Nëse burri nuk pranon t’i japë divorcin atëherë gruaja ka të drejtë

të kërkojë divorc duke kthyer *mehrr-in* (prikën) dhe përfitime të tjera financiare që kishte marrë nga burri. Për vendimin e kërkesës së saj, i mjafton kadiut (gjykatësit) që të bindet se gruaja kërkon divorcin në mënyrë të pavarur. Ligji nuk i kërkon të shprehë ndonjë arsye apo dëshmi për këtë. Janë raste kur gratë i kanë kërkuar Profetit të shenjtë ^{sav} shkurorezim nga burrat e tyre vetëm duke thënë se nuk i pëlqenin.³⁰

“O Profet (dhe besimtarë)! Nëse i ndani gratë, ndajini ato sipas kohës së tyre të pritjes dhe llogaritni kohën e tyre të pritjes dhe frikësojuni Allahut,”

[Et-Telak 65:2]

Duke sqaruar kohën e pritje Allahu thotë:

“Gratë e ndara duhet të presin tri cikle mujore.”

[El-Bekrrah 2:229]

Domethënë gjithë afati i pritjes zgjatet tri cikle mujore. Ky afat shërben për të mundësuar burrin që të mendojë thellësisht rreth këtij vendimi. Nëse pas ciklit të parë ata pajtohen atëherë lejohet kurorëzimi. Nëse pas pak kohe ata shkurorezohen për së dyti, atëherë përsëri ata ose mund të pajtohen dhe vazhdojnë jetën martesore ose të presin për ciklin e fundit mujor, pas të cilit ata nuk mund të kurorëzohen më. Kurani e sqaron këtë me këto fjalë:

“Ndarja mund të bëhet dy herë. Më pas, gruaja ose të mbahet me të mirë, ose të lejohet të ikë me të mirë.”

[El-Bekrrah 2:230]

“Më pas, nëse burri e ndan sërish gruan (për të tretën herë), nuk mund të martohet më me të, pa u martuar ajo me një burrë tjetër. Por, në qoftë se ai (burri i dytë) i jep divorc asaj, atëherë nuk është gjynah nëse ajo dhe burri i parë të martohen sërish me njëri-tjetrin, nëse mendojnë se do t'i respektojnë kufijtë e Allahut;

këto janë urdhrat e Allahut, që Ai ua shpjegon njerëzve që kuptojnë.”

[El-Bekrrah 2:231]

Nuk mund të bëhet martesë tjetër derisa nuk përfundon koha e pritjes:

“Dhe mos vendosni për martesë para se të kalojë afati i paraparë i pritjes.”

[El-Bekrrah 2:236]

Sipas Kuranit nëse divorcin e kërkon burri atëherë ai vetë do të përballojë të gjitha shpenzimet e gruas gjatë kohës së pritjes. Ajo duhet të qëndrojë në shtëpinë e tij gjatë kësaj periudhe por burrit kurrsesi nuk i lejohet ta keqtrajtojë atë.

“Gratë e ndara në periudhën e pritjes, le të banojnë aty ku banoni edhe ju, sipas mundësive tuaja dhe mos u bini në qafë për t'i detyruar (të largohen).”

[Et-Telak 65:7]

“Nëse janë shtatzëna, shpenzoni për ato deri sa të lindin. Nëse fëmija ushqehet me gjirin e nënës, paguajuni atyre shpërblimin dhe merruni vesh me të mirë. Por, nëse keni vështirësi të merreni vesh, atëherë le ta ushqejë me gjinjë (mëndeshë) tjetër.”

[El-Bekrrah 2:234]

Pas këtij episodi të trishtuar Islami e inkurajon gruan e ndarë që të martohet dhe të formojë jetë martesore me dikë tjetër pasi kjo është mënyra më e ndershme dhe e virtutshme. Allahu thotë:

“Kur t'i ndani gratë dhe ato të kenë plotësuar kohën e pritjes, mos i pengoni ato që të martohen me burrat e tyre, nëse merren vesh me të mirë. Kështu këshillohet çdokush prej jush që beson Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo është më e ndershme dhe më e virtutshme. Allahu di, kurse ju nuk dini.”

[El-Bekrrah 2:233]

VEJUSHAT

Njësia bazë e shoqërisë është familja, prandaj Islami inkurajon jetën martesore. Për të eliminuar plotësisht fenomene të rrezikshme dhe prire të dëmshme për shoqëri, ai thekson jetën normale martesore, dhe për të arritur këtë qëllim ai e lejon rimartesën. Sipas tij nëse një pjesë e shoqërisë mbetet papërkrahje dhe mbështetje morale dhe ekonomike, ajo detyrohet të përfshihet në punë të zeza. Fatkeqësisht një pjesë e të vejave, për të siguruar mbijetesën përfundojnë në prostitucion. Islami merr masat parandaluese kundër gjithë këtyre dukurive. Prandaj Allahu thotë:

“Gratë të cilave iu vdes burri, duhet të presin katër muaj e dhjetë ditë (pas vdekjes së tij). Pas kalimit të këtij afati, ju nuk jeni përgjegjës për çfarë bëjnë ato me jetën e tyre sipas rregullave. Allahu e njeh mirë çdo vepër që ju bëni.”

[El-Bekrrah 2:235]

Asnjë mashkull nga familja e ish-burrit nuk mund ta detyrojë të venë të rimartohet apo t’i rrëmbehet trashëgimia e saj.

“O besimtarë! - nuk ju lejohet të bëheni përdhunisht trashëgimtarë të grave dhe mos i pengoni ato me qëllim që t’ua merrni një pjesë

nga dhuratat që ua keni dhënë, përveç nëse bëjnë gabime sheshazi.”

[En-Nisa 4:20]

Sipas William Montgomery Watt, profesori i studimeve Islamike, Islami përmirësoi statusin e gruas duke “themeluar të drejtat e pronësisë, trashëgimisë, arsimit dhe të divorcit.”³¹

FJALA E FUNDIT

E vërteta është që Islami cakton detyrat e mashkullit dhe femrës në përputhje me natyrën e aftësinë e tyre. Nëse këta dy u përmbahen detyrave të tyre si dhe të drejtave të njeri-tjetrit, atëherë sigurisht ambienti i familjes do të mbushet me dashuri, paqe dhe harmoni dhe nga këto mjedise do të themelohet baza e shoqërisë së re, të shoqërisë hyjnore-të parajsës. Pikërisht ky është qëllimi i jetës së individit, të kontribuojë në krijimin e asaj shoqërie në tokë derisa të marrë këtë lajm të gëzuar prej Zotit të Gjithëmëshirshëm.

“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”

[El-Fexhrr 89:28-31]

¹ Susan B. Anthony, “Remarks to the fiftieth Anniversary of the American Anti Slavery Society” Dhjetor 4, 1883, në Elizabeth Kadi Stanton dhe Susan B. Anthony, *Selected Papers of Elizabeth Cady Stanton and Susan B. Anthony*, vëll 4, *When Clowns make law for Queens*, 1880 deri 1887, bot. Ann D. Gordon (New Brunswick, NJ.: Rutgers University Press, 2006), 304

² Islamofobia është një term i ri që i përgjigjet armiqësisë dhe diskriminimit ndaj fesë Islame apo myslimanëve. Shih Sandra Fredman, *Discrimination and Human Rights*, Oxford Uni ³ In Mace, David and Vera, marriage East and west. Dolphin Books, Doubleday and Co., Inc., N.Y., 1960

⁴ Laws of Manu IX, 3

⁵ Laws of Manu V, 147

⁶ Laws of Manu V, 155

⁷ Leonard J. Swidler, *Women in Judaism: the Status of Women in Formative Judaism* (Metuchen, N.J.: Scarecrow Press, 1976) f. 115

⁸ Për të parë të gjitha citimet e shenjtoreve të mëdhenj, shih Karen Armstrong, *The Gospel According to Woman* (London: Elm Tree Books, 1986) f. 52-62. Shih edhe Nancy van Vuuren, *The Subversion of Women as Practiced by Churches, Witch-Hunters, and Other Sexists* (Philadelphia: Westminster Press) f. 28-30.

⁹ Allen E.A., *History of Civilisation*, vëll. 3, f. 444

¹⁰ Si më lart

¹¹ Encyclopedia American International, vëll 29, f. 108

¹² Ecclesiasticus 22:3

¹³ Ecclesiasticus 42:11

¹⁴ Ibne Hanbal nr. i hadithit 1957

¹⁵ "Kushdo që mallkon të atin ose të ëmën, do të dënohet me vdekë" [Levitiku 20:9]

"Biri i urtë gëzon të atin, por njeriu budalla përçmon të ëmën." [Fjalët e urta 15:20]

¹⁶ En-Neml 27:24

¹⁷ Lindsay, James E. (2005), *Daily Life in the Medieval Islamic World*, Greenwood Publishing Group, pp. 196 & 198, ISBN 0313322708

¹⁸ Guity Nashat, Lois Beck (2003), *Women in Iran from the Rise of Islam to 1800*, University of Illinois Press, p. 69, ISBN 0252071212

¹⁹ Physicians for Human Rights, *The Taliban's war on Women*, f. 39, ISBN 1-879707-25-X

²⁰ 100 Girls' Schools in Afghan Capital Are Ordered Shut, *The New York Times*, June 17, 1998. (Associated Press, June 16, 1998.)

²¹ Atkinson, Thomas, *Handbook of the law of wills and other principles of succession including intestacy and administration of decedents' estates*, botimi II, 1953

²² Encyclopedia Americana international (edition), Vol. 29, p. 108.

²³ Lewis, *What Went Wrong?* 2002, pages 82-83

²⁴ Rumsey, A. Moohummudan Law of Inheritance. (1880), lamic inheritance

jurisprudence. (2009, July 12). In *Wikipedia, The Free Encyclopedia*. Retrieved 05:39, July 12, 2009, from http://en.wikipedia.org/w/index.php?title=Islamic_inheritance_jurisprudence&oldid=301649307

²⁵ Hazret Mirza Tahir Ahmad, *Islam's Response to Contemporary Issues*, Islam International Publications Ltd., Surrey, Angli, 2007, f. 94, ISBN-1-85372-888-8

²⁶ http://womenshistory.about.com/od/marriedwomensproperty/a/property_1848ny.htm

²⁷ <http://www.umd.umich.edu/casl/hum/eng/classes/434/geweb/PROPERTY.htm>

²⁸ <http://www.britannica.com/EBchecked/topic/366305/Married-Womens-Property-Acts>

²⁹ Ebu Daud, kitabun Nikah, Baabut-Tahrriid elen-Nikaah

³⁰ Buhari, Kitabut-Talaak, babul Khula'


³¹ Maan, Bashir and Alastair McIntosh. "The whole house of Islam, and we Christians with them...': An interview with 'the Last Orientalist' - the Rev Prof William Montgomery Watt." Internet version from www.alastairmcintosh.com. Also published in The Coracle, the Iona Community, summer 2000, issue 3:51, pp. 8-11.

Shahid Ahmad Butt

Sadakaja më e madhe

Hazret Abu Hurejrah r.z. tregon: Një ditë, një njeri erdhi te Hazret i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe tha: O i Dërguar i Allahut s.a.v.s., cila sadaka shpërblehet më shumë nga Zoti? Ai iu përgjigj: "Sadakaja më e madhe është ajo që ti jep në kohën kur je shëndosh e mirë, edhe pse kërkon para për nevojat e tua. Sadakaja më e madhe është gjithashtu ajo që ti jep edhe pse ke frikë nga varfëria dhe dëshiron të bëhesh i pasur. Mos u vono aq shumë në dhënien e lëmoshës dhe sadakasë, sa që kur të vjen koha e fundit, atëherë ti do të thuash: "Jepi filanit kaq dhe filanit kaq." Ndërsa atëherë, ajo pasuri nuk të takon ty por i takoi filanit."

(Buhari, Kitabuz Zekat, Bab fadli sadaka esh-shahih vas-sahih)



Fjalimi i Hazret Kalifit të Pestë të Mesihut të Premtuar, i mbajtur gjatë ditës së dytë të Xhelse Salan-ës së Xhematit Mysliman Ahmadia në Britaninë e Madhe, që u zhvillua në “Hadikatul Mahdi” të Anglisë, më 24, 25 dhe 26 korrik 2009

Një dhuratë prej anëtarëve të Xhematit, me rastin e njëqindvjetorit të Kalifatit Ahmadia

Në fillim, Zotëri Shabir Ahmad lexoi një mesazh nga Komiteti i njëqindvjetorit të Sistemit të Kalifatit.

Bismillahirrahmanirrahim

I drejtohet Hazret Kalifit të Pestë të Mesihut të Premtuar, ^{Zoti e ndihmofitë dhe e bekoftë},
Selam alejkum va rahmatullahi va barakatuhu!

Me bekimin dhe mëshirën e Zotit, njëqindvjetori i parë i Kalifatit Ahmadia ka kaluar me shumë mbarësi dhe suksese, dhe Xhemati ndërkombëtar Ahmadia,

me rastin e fillimit të njëqindvjetorit të dytë, falënderon përzemërsisht Zotin e Madhërishëm. Në vitin 1905, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. nga Kadiani kishte deklaruar:

“Jam mishërim i fuqisë së Allahut. Pas meje do të ketë persona të tjerë që do të jenë manifestim i dytë i fuqisë së Tij.”

Allahu i Lartësuar, me bekimin e Tij, e plotësoi paralajmërimin e Hazret Mesihu të Premtuar. Pastaj, më 27 maj të vitit 1907, nisi Sistemin e Kalifatit në Xhemat, me anë të të cilit, Ai e forcoi dhe rimëkëmbi Xhematin. Sot, nën kujdesin e Kalifit të Pestë, karvani i Xhematit po shënon shumë suksese

me shpejtësi të madhe. Ne i jemi shumë mirënjohës Zotit tonë për bekimin e Tij shumë të shtrenjtë – Kalifatin, dhe për shkak të bekimeve dhe sukseseve të panumërta që Xhemati, me anë të Kalifatit, gëzoi deri më sot.

Në vitin 1939, me rastin e njëzete-pesëvjetorit të Kalifatit të Dytë, duke e falënderuar Zotin praktikisht, për bekimet e Tij të shumta, Xhemati Mysliman Ahmadi ia kishte dhuruar udhëheqësit të tyre të dashur një shumë afërsisht prej treqind mijë rupi (monedhë indiane) dhe i kishte kërkuar Kalifit të Dytë që ai t'i pranonte ato, dhe t'i përdorte ku të dëshironte.

Duke e ruajtur traditën e mëparshme të Xhematit dhe duke treguar shembullin

praktik për falënderimin e Zotit të Lartësuar, anëtarët e Xhematit ndërkombëtar po i bëjnë dhuratë Kalifit të Pestë një shumë të hollash prej 2,500,000 £ *pound sterling* dhe i bëjnë kërkesë që ta pranojë këtë dhuratë.

Me respekt nga

një shërbëtor modest i Hazurit

Kryetari i Komitetit të

Njëqindvjetorit të Kalifatit, 2008

Nëse Hazuri do të më lejojë, desha të lexoj edhe emrat e atyre vendeve që kanë marrë pjesë në grumbullimin e kësaj dhurate.

(Pasi Hazuri ia dha lejen, ai i lexoi emrat e atyre vendeve që kontribuan.)



FJALIMI I HAZRET MIRZA MASROOR AHMADIT, KALIFIT TË PESTË TË MESIHUT TË PREMTUAR

Selam alejkum va Rehmatullah!

Unë dëshmoj se s'ka Zot tjetër përveç Allahut. Ai është Një dhe i Pashoq. Po ashtu, unë dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguari i Tij. Pas kësaj, kërkoj strehimin e Allahut nga shejtani i mallkuar.

Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit dhe Mëshirëplotit

Të gjitha lavdërimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve; të Gjithëmëshirshmit dhe Mëshirëplotit; Sunduesit të Ditës së Gjykimit. (O Allah) vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Udhëhiqna në rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre të cilët i bekove Ti, e jo në rrugën e atyre të cilët u bënë pre e zemërimit

e as të atyre të cilët u devijuan. (Amin)

Sot, (ditën e dytë të *Xhelsa Salanës së Anglisë*) siç e dini, paraqitet raporti, madje paraqitet vetëm një pjesë e raportit të veprimtarisë së tërë vitit, ku përmenden bekimet e Allahut të Lartësuar që Ai bëri mbi Xhematin, gjatë gjithë këtij viti.

Shpjegimi i kontributit të njëqindvjetorit

Por para se të filloj, desha të sqaroja pak mesazhin që sapo lexoi Çod'hri Shabir Ahmad Sahibi. Në fakt ky mesazh do të lexohej në Kadian, me rastin e *Xhelsa Salanës* të vitit 2008, dhe do të lexohej nga përfaqësuesit e të gjitha kontinenteve në

gjuhë të ndryshme. Por, për disa arsye, ajo Xhelsa Salana nuk u realizua dot. Atëherë Kryetari i Komitetit të Njëqindvjetorit të Kalifatit bëri kërkesë që ky mesazh të lexohet në këtë Xhelse ndërkombëtare, si dhe të përmendnin emrat e atyre vendeve që dhanë kontribut në këtë fond.

Së pari, u jam mirënjohës të gjitha Xhemateve të botës që, me bekimin e Zotit, prezantuan një sasi kaq të madhe të hollash. Me anë të këtij fondi, shumë projekte janë realizuar, për të cilat kisha frikë se nuk do të realizoheshin, ose ato kërkonin një kohë shumë të gjatë për t'i përfunduar. Pasi u bën premtimet për fondin e njëqindvjetorit, unë e kisha nisur hartimin e projekteve dhe Xhemati filloi t'i përdorte paratë siç vinin. Kështu që, me rastin e njëqindvjetorit të Kalifatit, u ndërtuan xhami të mëdha dhe shtëpi të misionit në vendet e Afrikës. Sepse për këto projekte kisha frikë se do të zgjasnin shumë nëse nuk do të kishte ardhur fondi i njëqindvjetorit. Shuma që u shpenzua nga ky fond në vendet Afrikane është afërsisht 1,065,000 paund. Veç kësaj, me anë të shoqërisë sonë të inxhinierëve, është dhënë një ndihmë për mulli me erë dhe *"Ujë për jetë"* në Afrikë.

Në Kadian, u zgjerua xhamia *Aksa*. Tani ajo ka një ndërtesë të bukur trekatëshe dhe në atë xhami mund të falen pesëqind veta njëherazi. Veç kësaj, u ndërtua një godinë e madhe për bibliotekë në Kadian, në të cilën mund të vendosen miliona libra; po në Kadian u ndërtua një ndërtesë për

shtypshkronjë, gjatë fjalimit do të dëgjoni raportet e saj; u ndërtua një pallat për mysafirë që vijnë në Kadian. Kështu që, u shpenzuan afërsisht tetëqind mijë paund nga ky fond në projektet që sapo përmenda dhe shuma tjetër ishte dhënë nga arka kryesore.

Përveç kësaj, një pjesë të këtyre parave janë dhënë edhe në Bangladesh për ndërtimin e xhamive. Afërsisht pesëqind mijë paund janë dhënë në Evropë për të blerë toka

për xhami dhe shtëpi të misionit. Kështu që, ky fond që përbëhej prej 2.5 milion pondësh u shpenzua në Afrikë, Kadian, në disa vende të Evropës dhe në disa shtete të varfra të Azisë. Detajet e tjera nuk mund t'i shpjegoj hollësisht këtu, për shkak të kohës së ngushtë. Shkurt, me bekimin e Zotit, ky fond më ka ndihmuar shumë për realizimin e projekteve të mëdha që do të zgjasnin shumë. Unë i falënderoj të gjithë anëtarët e Xhematit që dhanë paratë për këtë fond.

Tani, siç është tradita e Xhematit, do të përmenden bekimet e Zotit që ranë si shi mbi Xhematin.

Vende të reja ku u themelua Xhemati Mysliman Ahmadia gjatë këtij viti

Me bekimin e Zotit të Lartësuar, deri sivjet, Xhemati Ahmadia u themelua në **195** shtete të botës. Këtë vit, me bekimin e Zotit të Lartësuar, kemi hyrë në **dy** shtete të reja. Unë mendoja se këtë vit nuk do të gjejmë ndonjë shtet, por Allahu

Me bekimin e Zotit të Lartësuar, deri sivjet, Xhemati Ahmadia u themelua në 195 shtete të botës.

i Lartësuar bëri shumë mirësi e na pranoi lutjet dhe Xhemati u themelua në Serbi dhe në Lituani.

Siç ju thashë se nuk mund të lexoj gjithë raportin këtu, madje as atë pjesë që kisha zgjedhur për ta lexuar nuk mund ta lexoj komplet.

Pra, sivjet, Allahu i Lartësuar na dha këto dy vende. Gjatë këtij viti në 38 vende u dërguan delegacione për të gjetur anëtarë të rinj. Këto vende janë: Algjeria, ku kemi gjetur kontakte të reja dhe me anë të kanalit televiziv MTA u anëtarësuan shumë njerëz dhe vazhdojnë të anëtarësohen, Tunizia, Rumania, Maqedonia ku po gjejmë kontakte të reja dhe me bekimin e Zotit kemi gjithashtu anëtarësime të reja.

Me bekimin e Zotit, jashtë Pakistanit, janë themeluar 531 xhemate të reja. Përveç këtyre 531 vendeve, Xhemati u themelua për herë të parë në 790 vende të ndryshme (në lagje apo qytete të ndryshme). Kështu që gjithsej janë 1321 vende ku u themelua Xhemati Mysliman Ahmadia. Në këto vende, Mali (në Afrikën Perëndimore) është në krye të listës ku Xhemati ka hyrë në 155 vende të reja. India zë vendin e dytë ku Xhemati u themelua në 104 vende të reja. Edhe atje (në Indi), kundërshtarët janë tërbuar shumë dhe nën ndikimin e hoxhallarëve të Pakistanit po tregohen shumë të egër. Por, sa më ashpër që po kundërshtojnë ata, aq më shumë raste krijohen për përhapjen e Xhematit. Në Sierra Leone, Xhemati u themelua në 47 vende të reja, gjithashtu në Kongo, Bregun e Fildishtë, Senegal, Kenia, Burkina Faso, Madagaskar dhe në shumë shtete të tjera Xhemati nisi misionin e tij.

Ndihma e veçantë prej Zotit të Lartësuar”

Ngjarje besimnxitëse gjatë përhapjes së mesazhit të Xhematit

Njerëzit kanë më shumë qejf të dëgjojnë ngjarjet (që ndodhin gjatë përhapjes së misionit të Xhematit). Ka një ngjarje që ndodhi në Kashgër të Kirgistanit. Ashir Ali Sahib shkruan:

“Një herë Ekmel Sahibi, një mik jo-ahmadian më takoi në Kashger, para shtëpisë sime. Unë e mora brenda dhe i tregova për Xhematin. Tek po bëja tabligh (përhapjen e mesazhit), ai mori një libër nga tavolina dhe e hapi dhe aty pa fotografinë e Hazret Mesihut të Premtuar a.s. Ai, duke u habitur thotë se këtë njeri e kam parë në ëndërr, ai kishte qëndruar në drejtim të lindjes së fshatit tonë, atje te mali, duke u drejtuar drejt fshatit tonë po lutej.”

Me bekimin e Zotit, në një vit e gjysmë, 65 ahmadianë janë bërë në atë vend.

Ahmad Xhibrail Sahibi shkruan: Në veri të Ghanës, në një fshat që ishte 15 km afër kufirit ishte dërguar një delegacion për *tabligh*. Edhe unë u bashkova me ta dhe takova njerëzit e atij fshati. I lajmërova për ardhjen e Mesihut të Premtuar a.s. Atëherë, një plak u ngrit dhe mbajti një fjalim shumë emocional dhe tha: “Feja Islame ka qenë gjatë shekujve në këtë vend. Por ka dyzet vjet që ajo është zhdukur. Unë edhe sot mund t’ju tregoj shenjat e saj në këtë zonë. Jam shtatëdhjetë vjeç dhe ka kohë që jam bërë katolik dhe është e vështirë për mua që të rikthehem. Por ngaqë ende kemi besim në gjakun tonë, fëmijët tanë kanë të drejtë që ta përqafojnë fenë Islame dhe të bashkohen me ju.”

Kështu në atë mbledhje, 43 persona nga ata janë bërë ahmadianë.

Në Kongo kishte ardhur një delegacion jo ahmadian nga Kinshasa. Pas një mbledhjeje anëtarët e Xhematit u bënë *tabligh*. Në atë delegacion ishte edhe një imam. Ata kur u kthyen në vendin e tyre, me bekimin e Zotit, aty janë bërë më shumë se 250 ahmadianë të rinj.

Në të njëjtën mënyrë, në Liberi dhe në vende të tjera, Allahu na ndihmoi duke ua hapur zemrat njerëzve për Xhematin dhe shumë njerëz duke parë ëndrra apo duke parë vërtetësinë e Xhematit në një mënyrë a në një tjetër e përqaftuan Xhematin Mysliman Ahmadia.

Xhami dhe shtëpi të reja të misionit të Xhematit Mysliman Ahmadia dhe rrëfimi i disa ngjarjeve besimshtytëse rreth tyre

Këtë vit, Xhemati Mysliman Ahmadia, me bekimin e veçantë të Zotit të Lartësuar, gjeti 399 xhami, në të gjithë botën. 164 nga ato i kemi ndërtuar të reja, ndërsa 235 xhami të tjera Zoti na i dha të gatshme (d.m.th. njerëzit e atyre vendeve u anëtarësuan në Xhemat dhe xhamitë e tyre janë bërë të Xhematit.)

Ato vende ku u ndërtua xhamia e parë e Xhematit janë: Çad, Kongobrazil, Venezuela, ku në një mbledhje 15 njerëz u anëtarësuan në Xhemat. Në Kitorialgini

u vu gurthemeli i xhamisë së parë të Xhematit. Në Bolivi dhe në shumë vende të tjera është blerë tokë për xhami.

Këtë vit, Xhemati Mysliman Ahmadia, me bekimin e veçantë të Zotit të Lartësuar, gjeti 399 xhami, në të gjithë botën. 164 nga ato i kemi ndërtuar të reja, ndërsa 235 xhami të tjera Zoti na i dha të gatshme

Desha t'ju tregoj disa ngjarje besimnxitëse që ndodhën gjatë ndërtimit të xhamive. Është një fshat në Benin që quhet *Bujkon*. Edhe këtu u ndërtua xhamia e parë e Xhematit. Kur kryeimami i fshatit mori vesh se Xhemati Mysliman Ahmadia po ndërtonte një xhami, atëherë ai i lajmëroi të gjithë hoxhallarët e fshatit se do të ndërtonte një xhami më madhështore e dy kate më të madhe se sa e Xhematit Ahmadia. Sub-inspektori i asaj zone që megjithëse ishte i krishterë, por ishte njeri i mirë, kur mori vesh fjalët e kryeimamit, deklaroi se tani xhamia e parë

në këtë fshat do të ndërtohet vetëm nga Xhemati Mysliman Ahmadia.

Sërish, në Benin në zonën Pobe, hoxhallarët bënë një turne dhe takuan hoxhallarët e tre fshatrave të atij rrethi. Një delegacion i tyre në tetë makina u mblodh në një vend dhe pohuan se Xhemati Ahmadia po përhapet me shpejtësi, si dhe ata po ndërtojnë edhe xhami, çfarë duhet të bëjmë ne që të zhduket Ahmadiati dhe të fitojmë ne? Njerëz që ishin të pranishëm aty u thanë hoxhallarëve: *Si është e mundur që t'i zhdukni ahmadianët? Ata shkojnë edhe në zonat më të largëta dhe ndërtojnë xhami dhe njerëzve u mësojnë Islamin dhe Kuranin. Dhe nëse ju në të vërtetë do t'i zhdukni ata, atëherë së pari bëni ato punë siç bëjnë ata. Përveç qyteteve shkoni edhe nëpër fshatra dhe*

ndërtoni xhami atje. Arsimojini fëmijët me mësimet islame. Le të besojnë njerëzit që edhe ju përpiqeni për Islamin.” Pas diskutimeve të tilla mbledhja e tyre përfundoi.

Në zonën Pedro të Bregut të Fildishtë, bashkë me kryeimamin disa njerëz u anëtarësuan në Xhemat. Kryeimami që është pasanik, por shumë modest, dhuroi një tokë të tij për xhaminë e Xhematit. Xhamia jonë u ndërtua dhe ishte gati në përfundim, por pas kësaj hoxhallarët erdhën te kryeimami dhe filluan ta shanin ahmadiatin dhe i thanë që të mos ua jepte xhaminë ahmadianëve, përndryshe të gjithë myslimanët e fshatit do ta bojkotonin. Veç kësaj ata gjithashtu e kërcënuan që do t'i dëmtonin pasuritë e tij. Kryeimami që ishte shumë i moshuar, u ndikua nga ata dhe çelësat e xhamisë ua dha atyre. Por pastaj erdhi te ahmadianët dhe pohoi: “Unë isha ahmadian me gjithë zemër dhe jam edhe tani, por hoxhallarët më kanë rrethuar mua. Lutuni për mua!” Pas disa ditësh, u caktua që të bëhej një mbledhje e madhe, në të cilën kryeimami do të deklaronte vendimin e tij për xhaminë. Ai edhe mua më kishte shkruar një letër për lutje. Një natë, në sheshin e fshatit u organizua një mbledhje. Atëherë, me bekimin e Zotit, kryeimami trim haptazi deklaroi se ai është ahmadian dhe mandej çelësat dhe dokumentet e xhamisë ia dorëzoi Xhematit.

Ka shumë ngjarje të tilla që s'mund t'i lexoj dot të gjitha. Me bekimin e Zotit të Lartësuar, në xhamitë tona edhe joahmadianët vijnë dhe gjejnë qetësi.

Është edhe një ngjarje tjetër që ndodhi në Bregun e Fildishtë, ku Xhemati mrekullisht gjeti tokë për xhami. Është një qytet Bënduku që njihet si qytet i hoxhallarëve. (Bënduku është emri i qytetit, dhe s'është ajo gjë që thuhet në gjuhën

urdu. Në urdu fjala “bënduk” do të thotë pistoletë që shpesh mbajnë hoxhallarët). Pra, në këtë qytet jetojnë hoxhallarë shumë ekstremë. Ky qytet gjithashtu njihet si qytet me njëmijë xhami. Kryeimami është kundërshtar i përbetuar i Xhematit dhe ka kontroll të plotë mbi qytetin. Kur ahmadianët po kërkonin tokë atje për xhami, atëherë një delegacion i hoxhallarëve shkoi te kryebashkiaku dhe i tha se ahmadianët s'janë mysliman dhe madje janë terroristë nga Pakistani. Prandaj nuk duhet t'i jepni tokë për xhami. Kështu që, kryebashkiaku na refuzoi kërkesën tonë për të blerë një tokë për xhami. Pastaj kërkesën ia dorëzua guvernatorit. Por hoxhallarët na përgojuan edhe atje, dhe guvernatori na e refuzoi kërkesën. Fundja ahmadianët ngelën të shqetësuar duke iu lutur Zotit. Edhe mua më shkruan shumë herë për lutje. Më në fund, më 27 maj 2008, Xhemati edhe atje po festonte njëqindvjetorin e Kalifatit. Në këtë tubim e ftuam guvernatorin, kryebashkiakun dhe disa oficerë ushtarakë. Ditën e tubimit, në namazin e *tehexhudit*¹ ahmadianët janë lutur shumë për xhaminë. Këta qeveritarë kur panë tubimin e Xhematit u çuditën pamasë. Të nesërmen, guvernatori thirri misionarin tonë në zyrën e tij, dhe i tha: “Nuk dija se Xhemati Mysliman Ahmadian është kaq shumë paqësor dhe po bën kaq shumë për humanizmin, edhe mësimet i ka shumë të mira. Prandaj, pavarësisht nga kundërshtimet e hoxhallarëve, ju ku të doni mund të merrni tokë për xhaminë tuaj.” Kështu që, ai na dha një tokë nga tokat e qeverisë për të cilën kishin ardhur shumë kërkesa përpara nesh nga kompani të ndryshme.

Në shumë vende për herë të parë u ndërtuan shtëpi të misionit të Xhematit.

¹Namazi vullnetar që falet gjatë natës, zakonisht preferohet në pjesën e fundit të natës, para namazit të sabahut.



**HAZRET MIRZA MASROOR AHMAD,
KALIF I PESTË I MESIHUTTË PREMTUAR**
Allahu e ndihmoftë fuqimisht

Katër nga ato janë shtete të Evropës: Maqedoni, Slloveni, Estoni dhe Islandë. Në Afrikë janë ishujt e Cape Verde-së. Edhe në Greqi është në proces. Në Turqi është blerë një ndërtesë. Në Kosovë ndërtimi i qendrës së Xhematit është thuar duke përfunduar. Këtë vit, **106** shtëpi të misionit janë shtuar në Xhematin tonë.

Dhe deri tani, në **102** shtete të botës kemi **2117** shtëpi të misionit. Këtë vit, India renditet e para në këtë garë ku janë ndërtuar **36** qendrat tona.

Në Melburn (në Australi) Xhemati kishte kërkuar për të përdorur qendrën e xhematit si xhami. Kishte pasur shumë kundërshtime madje, por prapëseprapë Bashkia e miratoi. Një njeri paditi Xhematin në gjyq dhe anëtarët e Xhematit ishin të shqetësuar e më shkruanin edhe mua për lutje. Ata thonë se përgjigjen që morën ata prej meje ishte kjo “*Zoti i Lartësuar do t’i largojë të gjitha pengesat që do të dalin për këtë punë.*” Pastaj gjyqi vendosi në favor të Xhematit dhe veç kësaj dha edhe vendimin që nuk mund të bëhet padi në asnjë gjyq tjetër kundër këtij vendimi.

Një qendër e Xhematit është blerë edhe në Stokholm, në Suedi. Xhemati e gjeti në një vend shumë të mirë dhe shumë të lirë. Kur anëtarët e Xhematit dëshironin ta blinin ajo shitej 4.5 milionë Krona, dhe ata më shkruanin se nuk kanë qas shumë para. Unë u thashë se nuk do të keni asnjë ndihmë nga qendra, duhet ta blini nga financimet tuaja. Ata s’kishin gjë veçse të prisnin. Në disa ditë ra çmimi i saj. Prapë më shkruan, pasi ende nuk kishin

mundësi ta blinin me buxhetin tyre. Unë u thashë: *Prisni edhe pak*. Pastaj erdhi kriza ekonomike dhe çmimet shtëpive dhe pronave ranë shumë. Në këtë mënyrë ata e gjetën me aq pak para sa kishin. Kështu që edhe kjo krizë ekonomike erdhi për të na ndihmuar.

Përkthimi i Kuranit të Shenjtë dhe botimi i librave

Sipas raportit të zyrës së botimeve të Xhematit, deri në vitin e kaluar Xhemati kishte botuar Kuranin e Shenjtë në **68** gjuhë të botës. Sivjet u botua edhe në një gjuhë tjetër dhe kështu u bë në **69** gjuhë. Përkthimi i ri që u botua sivjet është në gjuhën *ashanti* (*akan*) që është një gjuhë rajonale e Ganës. El-Haxh Jusuf Adosui Sahibi dhe disa

miq të tij dhanë një kontribut të madh për këtë. Ata kanë bërë edhe promovimin e këtij përkthimi. Njerëzit e pritën shumë mirë dhe thanë se në gjuhën e tyre ky ishte përkthimi i parë i ndonjë Libri të Shenjtë.

Përkthimi i Kuranit në disa gjuhë të tjera është ende në proces. Janë përkthyer në shumë gjuhë ajete të zgjedhura nga Kurani i Shenjtë.

Vëllimi i tetë i komentimit të Kuranit, bërë nga Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar, tani është përkthyer dhe botuar në gjuhën arabe.

Këtë vit, 12 vëllimet e para nga përmbledhja e veprave të Hazretit Mesihut të Premtuar janë botuar sërish. Për herë të parë të gjitha këto janë shtypur me kompjuter. Këto vëllime u botuan në

Deri në vitin e kaluar Xhemati kishte botuar Kuranin e Shenjtë në 68 gjuhë të botës. Sivjet u botua edhe në një gjuhë tjetër dhe kështu u bë në 69 gjuhë.

Pakistan, Indi dhe në Angli. *Tadhkirah* (përmbledhja e shpalljeve dhe ëndrrave të Mesihut të Premtuar) u botua sërish në gjuhën angleze. Botimi është shumë i bukur, ka edhe tregues në fund. Janë botuar shumë fletushka, broshura dhe përkthime në gjuhë të ndryshme.

Sipas raportit të zyrës së botimeve ata morën raportet nga 40 shtete të botës, sipas të cilave, këtë vit janë botuar 523 libra dhe broshura të ndryshme në 31 gjuhë të ndryshme me tirazhin 2,486,000.

Sivjet për herë të parë edhe në gjuhën kirgize (të Kirgistanit) u botuan “*Ajete të zgjedhura të Kuranit të Shenjtë*”, “*Hadithe të zgjedhura të Profetit Muhammed s.a.v.s.*” dhe “*Thënie të zgjedhura të Hazret Mesihut të Premtuar a.s.*” E para ndër këto është botuar edhe në gjuhët tailandeze dhe kuza. Ndërsa e fundit është botuar në gjuhën serbo-kroate. Veç këtyre, të tre këto tani mund t’i gjeni edhe në CD në 25 gjuhë të ndryshme.

Veprimtaria e shtypshkronjës së Xhematit

Shtypshkronja e Xhematit që kemi në Angli quhet “*Shtypshkronja Rakim*” përveç Anglisë ajo gjendet edhe në tetë vende të Afrikës: Ghanë, Nigeri, Tanzani, Sera Leone, Bregu i Fildishtë, Kenia, Gambia dhe Burkinafaso. Vetëm librat dhe broshurat që u botuan nga shtypshkronja që kemi në Londër, tirazhi i tyre është 212,500; ndërsa në Afrikë janë botuar 436,000. Para pak kohe, makina të reja me teknologji të avancuar janë dërguar atje.

Veprimtaria e mrekullueshme e MTA-së (Kanali televiziv i Xhematit

Mysliman Ahmadia). Ngjarje interesante e besimnxitëse sesi u udhëzuan kërkimtarët e së vërtetës nëpërmjet këtij mjeti qiellor

Në Kanalin *MTA Internation* (Muslim Television Ahmadia Kanali televiziv i Xhematit Mysliman Ahmadia) punojnë 116 burra dhe 46 gra në 14 departamente të ndryshme. Këta vullnetarë, me bekimin e Zotit, shërbejnë 24 orë. Sivjet kemi bërë një marrëveshje me agjencinë e lajmeve *Reuters*. Tash ajo çdo ditë do të dërgojë buletin lajmesh me video për të dhënë lajmet edhe në MTA. MTA-ja përgatiti disa dokumentarë rreth njohurive të Xhematit Ahmadia, Kalifëve të tij dhe për xhamitë që u ndërtuan në Evropë, etj.

MTA El-Arabija (MTA në gjuhën arabe) përveç *Hotbird-it*, tani transmetohet edhe në dy satelite me famë botërore që janë *Atlanticbird 4* and *Euorobird 9A*. Tani MTA mund të shihet nga çdo cep i botës arabe. Veç kësaj MTA ka nisur një kanal të veçantë edhe në *Youtube*.

Nëpërmjet këtij kanali, po anëtarësohen shumë njerëz në Xhemat. *Amiri* i Xhematit të Francës tregon se një ahmadian i sapoanëtarësuar që quhet Amaskara para ca kohe kishte parë kanalin tonë MTA. Pastaj ai para se të flinte përsëriste *shehadetin*. Kur atij iu bë e qartë se Hazret Mirza Ghulam Ahmadi është Mesihu i Premtuar, atëherë ai u shqetësua se nëse do të vdiste atë natë pa u anëtarësuar në Xhemat, çfarë do t’i përgjigjej Zotit? Ai nuk kishte mundësi të komunikonte me Xhematin. Atëherë, ai thotë, *unë e futa kokën nën jorgan dhe pas shehadetit thashë: O Zot unë besoj se Hazret Mirza Ghulam Ahmadi është Mesihu i Premtuar. Konsiderojë këtë deklaram timin si Bejtin tim.*”

Ka shumë ngjarje të tilla sesi njerëzit u udhëzuan nëpërmjet kanalit tonë. Në Spanjë, një shtetas marokian u anëtarësua me gjithë familjen e tij. Edhe ky u lidh me Xhematin me anë të MTA-së. Ai kur u informua mirë me emisionet tona dhe u bind, më dërgoi letrën për të bërë *Bejtin* e tij dhe të anëtarëve të familjes së tij, pasi ai nuk dinte për qendrën e Xhematit në Spanjë. Pastaj nga Londra letra e tij u dërgua prapë në Spanjë dhe ahmadianët e Spanjës arritën te ai. Në ato ditë do të bëhej edhe Xhelsa Salana e Spanjës. Edhe ai mori pjesë në Xhelsa duke udhëtuar 800 km. Ai kishte sjellë dhe tre shokë të tjerë. Kur u kthye në vendin e tij filloi edhe të dërgonte *çanda* (kontributin financiar).

Në këtë mënyrë, në vendet arabe po anëtarësohen shumë njerëz. Disa njerëz vetëm duke parë fotografinë e Hazret Mesihut të Premtuar a.s. u anëtarësuan në Xhemat.

Ali Sherif Sahibi nga Algjeria që jeton në Limeuil të Francës, më shkruan një letër:

“Unë, me një anëtar të Xhematit, shkuam në një shtëpi për të bërë tabligh (për të përhapur mesazhin e Xhematit). I Zoti i shtëpisë na takoi me shumë dashuri, sikur të na njihte prej kohësh dhe tamam si të ishte ahmadian. Ai na tha se kurdoherë që e shikonte kanalën tonë thoshte Astagfirullah dhe ai e mbyllte televizorin. Dhjetëra herë kështu ndodhi. Njëherë rastësisht kur doli kanali televiziv MTA ishte ulur edhe gruaja e tij. Atëherë po tregohej fotografia e Hazret Mesihut të Premtuar a.s. Gruaja e tij i tha se kështu është edhe fytyra e Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s. Unë e kam parë shumë herë në ëndërr. Ai thotë se atë ditë tre orë rresht e kishin parë emisionin El-Hiwarul Mubashar

në kanalën tonë. Gruaja e tij i tha: Unë po bëhem ahmadiane. Pasi na tregoi këtë ngjarje ai na tha: “Që atëherë ne po ju kërkojmë, ne jemi ahmadianë.”

Ka shumë ngjarje të tilla por nuk mund t’ju tregoj të gjitha në këtë tubim.

Emisione televizive e radio që u transmetuan gjatë këtij viti

Përveç transmetimeve 24 orë nga kanalet e MTA-së, nëpërmjet emisioneve televizive në kanalet e të tjerëve kemi transmetuar 1159 emisione 779 orë dhe 40 minuta. Mendohet të kemi përcjellë mesazhin e Xhematit rreth 100,000,000 personave në të gjithë botën. Edhe në radio, në shumë vende, kemi transmetuar 5448 emisione për 3,788 orë. Edhe me një llogaritje të ngushtë mendohet të kemi përcjellë mesazhin më shumë se 70,000,000 njerëzve në të gjithë botën. Veç këtyre, në Burkinafaso, Ghanë dhe në disa vende të tjera të Afrikës kemi stacionet tona të radios. Edhe me anë të këtyre mesazhi i Islamit të vërtetë po arrin te miliona njerëz.

Stacioni i radios i Xhematit Mysliman Ahmadia, me bekimin e Zotit, po bën një punë shumë të mirë. Njerëzit po anëtarësohen duke dëgjuar mësimet e Xhematit.

Ekspozita dhe pjesëmarrje në panaire

Sivjet Xhemati ka organizuar 257 ekspozita fotografike dhe 790 dyqane të përkohshme librash (*book stalls*) si dhe ka marrë pjesë në 48 panaire librash. Me anë të këtyre përpjekjeve mesazhi ynë mendohet të ketë arritur te 2,097,000 njerëz.

Vzhdon në numrin e ardhshëm

NJË KOMUNITET NJË UDHËHEQËS

Dokumentar televiziv i përgatitur nga MTA

**Shtëpitë e Kuvendit të Mbretërisë së
Bashkuar, tetor 2008**

Hazret Mirza Masroor Ahmadi u drejtohet deputetëve të Kuvendit të UK-së

"Sipas mendimit tim, kam frikë se drejtimi në të cilin po ecin gjërat në ditët e sotme, politikat dhe ekonomia e vendeve, mund të çojnë botën drejt një Luftë Botërore. Prandaj është detyrë e superfuqive që të ulen dhe të gjejnë rrugëzgjidhje për ta shpëtuar njerëzimin që ndodhet në prag të shkatërrimit."

**Stephen Harper
Kryeministër i Kanadasë**

"Siç e dini, dashuria e thellë që nxit liria e fesë është një mjet shumë i rëndësishëm ndërtues për të vendosur paqe këtu dhe në të gjithë botën. Për këtë punë ne jemi bashkë me Shkëlqesinë e tij, që është një kampion guximtar i përhapjes së lirisë së fesë dhe paqes."

Hazret Mirza Masroor Ahmadi është Krye-

etari i tanishëm i Xhematit Mysliman Ahmadi, bashkësia më dinamike ndërkom-bëtare brenda fesë Islame. Ky Xhemat (bashkësi) u themelua nga Hazret Mirza Ghulam Ahmadi në Kadian, një qytezë e vogël dhe e largët e Indisë. Ai deklaroi se ishte

Reformatori i prituri ditëve

të vona, i njëjti Reformator që pritej nga të gjitha fetë krye-

sore. I themeluar më 1889, ky

Xhemat filloi

të përhapej

anëmbanë

botës duke

lulëzuar nën

kuajtësinë

e sistemit

të Kalifatit,

që është një

sistem i një lid-

ërshipi shpirtëror

që nisi pas vdekjes

së Themeluesit të

nderuar. Hazret Mirza

Masroor Ahmadi, Kalifi i tan-

ishëm i këtij Xhemati vijon punën e

Themeluesit të tij për të ripërtëritur gjen-

djen shpirtërore dhe morale të njerëzimit.

Ky Xhemat është i mishëruar me mesazhin

dashamirës të Islamit dhe me pastërtinë

origjinale të tij. Është një Xhemat që më-

son paqen, vëllazërinë universale dhe nën-

shtrimin ndaj dëshirës së Zotit. Myslimanët

ahmadianë kanë arritur veçantinë dhe

tacionin për të qenë një bashkësi paqësore dhe që i zbaton ligjet.

Brenda një shekulli, Xhemati ka arritur në të gjitha qoshet e Tokës dhe po lëvdohehet dhe përshëndetet nga komuniteti botëror.

Jeremy Hunt

Deputet i Kuvendit të Britanisë së Madhe, Sekretar i Dytë i Shtetit për Kulturën, Median dhe Sportin

“Dashuri për të gjithë dhe urrejtje për askënd. Sot, këto fjale të Kalifit tuaj të Tretë janë më të rëndësishme, më vendimtare, më thelbësore seç kanë qenë ndonjëherë. Dhe sigurisht këtë filozofi paqeje dhe dashurie ahmadianët e kanë praktikuar gjithmonë.”

Baroness Sarah Ludford

Deputete e Kuvendit Evropian për Londrën

“Unë jam e gëzuar dhe e frymëzuar nga fakti që ju ahmadianët, jo vetëm e keni predikuar mesazhin e dashurisë, miqësisë dhe mirëkuptimit të tij, por edhe duke e praktikuar plotësisht atë, ftoni edhe të tjerët në mbledhjet tuaja për t'i ndarë mendimet me ta.”

Shkëlqesia



Ahmadianët duke bërë betimin në dorën e Udhëheqësit të tyre, gjatë Xhelsa Salanës së Anglisë, 2009.

e tij, **Peter Cardinal Appiah Turkson, Kryepeshkopi i Cape Coast-it, Ghana**

“Urdhri për të dashur të gjithë dhe për të mos urreyer asnjë, është në përgjithësi parimi udhëzues i jetës së Ahmadit.”

Lars Rise, Deputet i Parlamentit të Norvegjisë

“Gjithashtu unë desha t’ju falënderoj që keni theksuar rëndësinë për të paraqitur Islamin si fe e paqes, dhe jo një fe e urrejtjes, siç ishte shpallur nëpër botë nga të tjerët. Dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd, unë mendoj se ky është mesazhi që bota ka nevojë me të vërtetë.”

Anurag Sood

Gazetar dhe analist politik

“Nëse njerëzimi do t’i përmbahej kësaj thënieje, që është bërthama e të gjitha mësimëve të fesë, atëherë asnjë nga luftërat që janë zhvilluar gjatë historisë nuk do të kishin ndodhur kurrë.”

Stephen Harper

Kryeministër i Kanadasë

“Siç e dini, dashuria e thellë që nxit liria e fesë, është një mjet shumë i rëndësishëm ndërtues për të vendosur paqe këtu dhe në të gjithë botën.



Duke bërë lutje të heshtur pas ngritjes së flamurit.

Për këtë punë ne jemi bashkë me Shkëlqesinë e tij, që është një kampion guximtar i përhapjes së lirisë së fesë dhe të paqes.”

Judy Saunders

Këshilltare për Mitcham dhe Morden, Angli

“Dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd, është mesazhi që ne shohim në këtë xhami dhe nga Xhemati Ahmadija. Njerëzit tuaj kanë qenë një hap përpara si udhëheqës kryesor në nxitjen e lëvizjeve për të përhapur paqen.”

Jack Straw

Këshilltar i Parë dhe Sekretar i Shtetit për Drejtësinë, Angli

“Ne të gjithë, kemi një respekt shumë të madh për punën tuaj, që mendohe- ni çdo ditë për të bërë realitet paqen e vëllazëri- në komu- niteteve në këtë vend dhe nëpër botë.”

Richard Caborn

Deputet i Kuvendit të Britanisë së Madhe

Unë mendoj që gjërat që ju u thatë kolegëve të mi në Parlament, tingëllojnë sigurisht të vërteta, gjithë shpresë, shumë shpresëdhënëse, që ditën kur ju i keni thënë ato në Parlament pak javë më parë. Shenjtëria e tij filloi duke folur për konfliktin e madh që ka përfshirë tërë botën sot. Luftërat janë të pranishme në të gjitha anët e botës. Ai shfaq shqetësimin për probleme edhe më të mëdha. Ai vazhdoi të thoshte:

“Sipas mendimit tim, kam frikë se drejtimi në të cilin po ecin gjërat në ditët e sotme, politikat dhe ekonomia e vendeve, mund të çojnë botën drejt një Luftë Botërore. Prandaj është detyrë e superfuqive që të ulen dhe të gjejnë rrugë zgjidhje për ta shpëtuar njerëzimin që ndodhet në prag të shkatërrimit.”

Fjalët tuaja, Shenjtëria juaj, mendoj se duhen marrë shumë seriozisht nga të gjithë që ishin atje, në atë takim.

Kudo që të jetë themeluar Xhemati, përpjekjet e saj kanë shfaqur një ndikim ndër- tues të Islamit përmes projekteve sociale, qendrave arsimore, shërbimeve mjekësore, botimeve Islamike dhe ndërtimeve të xha-

mive. Këto përpjekje vazhdojnë, pavarësisht nga perse- kutimi i egër që i bëhet Xhe- matit në disa vende të botës.

Baron- ess Sarah Ludford

Deputete e Parla- mentit Ev- ropian për



Hazret Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar dhe i nderuari Stephen Harper, Kryeministri i Kanadasë gjatë përurimit të xhamisë Nur, në Kalgeri të Kanadasë.

Londrën

“Ne kemi nevojë për çdo mirësi që mund të gje- jmë sot në botë. Unë ju përgëzoj për kontributin tuaj në Britani dhe kudo në botë për të bashkuar komunitetet e ndryshme dhe për të pasur shumël- lojshmëri të tyre që është një pasuri e vlefshme.”

Stephen Harper

Kryeministër i Kanadasë

“Dhe kudo që ahmadianët të jetojnë nëpër botë, janë të njohur për t’u bërë komunitet i zgjeruar duke jetuar bashkë me njerëz të ngjyrës, gjuhës dhe kulturës sonë, në mënyrë shumë paqësore.”

Lord Eric Avebury

Zëdhënës i Punëve të Jasht- me dhe i Common- wealth-it

“Gjithashtu, unë doja t’ju përgëzoja sërish për punën tuaj që po bëni në Afrikë për të ngritur nivelet e tyre, sidomos në arsimim.”

Simon Hughes

Sekretar i Dytë i Shtetit për Energjinë dhe Ndryshimet Klimatike, Britania e Madhe

“Sigurisht që Britania e mirëpriti qendrën e Xhematit Ahmadia në këtë vend, por ky Xhemat nuk u bë një sekt i mbyllur. Madje ky u shqua për t’u përhapur në mbarë botën. Dhe kjo është shumë e rëndësishme, sepse rruga më e mirë për të kapërcyer barrierat e keqkuptimit dhe paragjykimet është pikërisht ky kontakt i zgjeruar, dhe unë ju falënderoj për këtë.”

Jonathan Shaw

Ministër për nën sekretarin e juglindjes dhe Parlamentit të Shtetit për mjedisin, u shqimin dhe punët rurale, Britania e Madhe

“Xhemati Mysliman Ahmadia kontribuon shumë për for-



Presidenti i Sierra Leonës me Hazret Kalifin e Pestë të Mesihut të Premtuar.

mbështesni. Këtë nuk e bëni vetëm për komunitetin tuaj, por në mënyrë edhe më të gjerë. Dhe kjo duhet të përgëzohet”

Terry Rooney

Deputet i Kuvendit të Britanisë së Madhe

“Xhemati Mysliman Ahmadia ka qenë si një fener, një fener i paqes, i vërtetësisë dhe i drejtësisë dhe pishtar në këtë qytet. Ne jemi më të mirë duke ju pasur ju. Jeni të jashtëzakonshëm në qëndrim dhe në triumf. Ne vlerësojmë miqësinë tuaj, ne vlerësojmë përkushtimin tuaj dhe angazhimin tuaj dhe sidomos paraqitjen tuaj në shoqërinë civile, në Bradford.

Siobhain McDonagh

Deputete e Kuvendit të Britanisë së Madhe

“Besimi juaj është i përkushtuar në shërbim të shoqërisë në të cilën ju jectoni. Dhe ajo që kam parë, dëgjuar dhe



Presidenti i Ganës me Hazret Kalifin e Pestë të Mesihut të Premtuar.

kam përvojë duke menaxhuar shkolla, punë bamirësie dhe kisha, besimi dhe komuniteti juaj ka kontribuar shumë. Unë vetë kam përvojë dhe kam dëgjuar që ju keni kontribuar me dhjetëra e mijëra paund për mirëqenien e fëmijëve, pleqve dhe njerëzve të paafitë. Ju keni dedikuar veten për projekte bamirësie, kurse ajo që është më e rëndësishmja, ju nuk bëni dallim mes feve, etnive dhe komuniteteve.”

Shumë nga projektet sociale të këtij Xhemati për të ndihmuar të varfrit përbëjnë një dëshmi të mjaftueshme për të kuptuar sesa shumë interesohet ky Xhemat për humanizmin dhe si e respekton të gjithë njerëzimin, pa bërë dallim midis racës, ngjyrës dhe besimit.

Siobhain McDonagh

Deputete e Kuvendit të Britanisë së Madhe

“Xhemati Mysliman Ahmadija ka një reputacion të jashtëzakonshëm për punët humanitare, jashtë vendit, në Afrikë, Indi, Bosnje dhe Indonezi. Përveç këtyre vendeve, Xhemati juaj edhe këtu ka reputacion të jashtëzakonshëm. Keni qenë bujarë me kohën dhe me



Presidenti i Tanzanisë me Hazret Kalifin e Pestë të Mesihut të Premtuar.

mjetet tuaja dhe ju e keni bërë veten pjesë të një komuniteti më të gjerë.”

Domini Grieve

Sekretar i Dytë për Zyrën e Ministrisë së Britanisë së Madhe

“Xhemati Mysliman Ah-

madija gjithmonë ka qenë përpara, jo vetëm duke ndihmuar njerëzit e vet, por edhe duke ndihmuar të gjithë shoqërinë. Për këtë arsye unë mund të them se prania juaj në këtë vend ka qenë shumë e dobishme për ne.”

Baroness Emma Nicholson

Deputete e Parlamentit Evropian për Anglinë Juglindore

“Gjatë njëqind viteve të fundit ju i keni dhënë aq shumë shoqërisë në Britaninë e Madhe, madje edhe kudo në botë! Ju jeni nga ata që japin, dhe jo vetëm që marrin. Ju jepni kaq shumë, shumë shoqërive, që unë vetë e kam parë, ndier dhe dëgjuar”

Stephen Harper

Kryeministër i Kanadasë



Zëvendëspresidenti i Mauratiusit me Hazret Kalifin e Pestë të Mesihut të Premtuar.

“Ahmadianët gjithashtu janë të njohur për punën që bëjnë për nevojat më të rëndësishme shoqërore,

shëndetësore dhe arsimore dhe gjithash-tu për pro-jekte të tjera të mëdha.”

Lord Eric Avebury

Zëdhënës i Punëve të Jashtme dhe i Commonwealth-it

“*Hirësi* a

juaj! Vetë puna

juaj është e njohur sidomos në Afrikën Perëndimore. Dhe ne sapo morëm vesh për përpjekjet tuaja për të sjellë ujë dhe dritë në disa nga komunitetet më të varfra të Afrikës Perëndimore.”

John Agyekum Kufour

President i Ganës

“Së bashku ne duhet t’i luftojmë armiqet e përbashkët, siç janë: analfabetizmi, sëmundjet, uria dhe varfëria. Xhemati Mysliman Ahmadia ka ngritur struktura për të luftuar kundër këtyre armiqve të përbashkët, që të ngrihet dinjiteti i njeriut.”

Alhaji Aliu Mahama

Zëvendëspresident i Ghanës

“Misioni i Xhematit ka qenë pararojë dhe bashkëpunëtor me qeverinë në fushat e arsimit, shëndetit, bujqësisë dhe të jetës njerëzore.”

Dr. Alhaji Ahmad Tejan Kabbah

President i Sierra Leone

“Në të vërtetë, Xhemati Mysliman Ahmadia në Sierra Leone, ka dhënë një kontribut shumë të madh për arsimin. Kudo që gjendeni ju, mjafton që të shikoni përreth.”

Malcolm Wicks

Ministër i Shtetit për Energjinë

“Dhe unë desha t’i thosha Hirësisë suaj se më la mbresë të thellë duke parë sesi paraardhësi juaj dhe udhëheqësi shpirtëror e kishte udhëzuar ko-



Hazret Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar duke i dhënë këshilla një forumi studentësh ahmadianë.

munitetin, pra Xhematin Mysliman Ahmadia që të tregohet dashamirës dhe të kujdeset për vuajtjet që u shkaktuan nga konflikti i Bosnjës. Dhe kjo më bëri shumë përshtypje.”

“Gjithkund ku vuan njerëzimi, anëtarët tuaj janë të gatshëm për të sjellë shëndet

dhe për të siguruar jetët dhe gjymtyrët.”

Ky Xhemat u themelua nën udhëheqjen hyjnore me qëllim që t’i rikrijojë moralet islamike dhe vlerat shpirtërore. Ai inkurajon dialog ndërfaqet, duke mbrojtur fenë Islame dhe duke ndrequr keqkuptimet që janë përhapur për fenë në Perëndim.

Lord Eric Avebury

Zëdhënës i Punëve të Jashtme dhe i Commonwealth-it

“Me gjithë gëzimin shfrytëzoj rastin e kësaj mbërme, për të përgëzuar punën e mrekullueshme të Xhematit Mysliman Ahmadia për t’u dhënë shtysë qëllimeve për të gjetur paqen me anë të mirëkuptimit dhe tolerancës. Xhemati Mysliman Ahmadia po bën një punë të jashtëzakonshme për të ngritur urë midis komuniteteve, etnive, gjuhëfolësve dhe feve të ndryshme në mbarë vendin tonë. Dhe unë gjithashtu di që ju keni rekord të shkëlqyeshëm edhe në pjesët e tjera të botës.”

Gillian Merron

Minister i Zyrës së Jashtme, Britania e Madhe

“Në fillim desha të thosha se sa e rëndësishme është puna e Xhematit Mysliman Ahmadia. Xhemati thellon mirëkuptimin, mendimin dhe besimin e tjetrit dhe ia jep zërin atij që është i nënvlerësuar në shoqërinë e tij.”

Jeremy Hunt

Deputet i Parlamentit të Britanisë së Madhe, Sekretar i Dytë i Shtetit për Kulturën, Median dhe Sportin

“Ajo që më bëri përshtypje duke iu afruar Xhematit Ahmadia, është angazhimi juaj i mrekullueshëm për bashkëbisedim ndërfaqetor, besimi juaj i fuqishëm ndaj parimit “feja jo me dhunë” si dhe zotimi juaj për të shpërndarë paqe dhe tolerancë. Ju ahmadianët qëndroni si një fener në besimin tuaj të palëkundshëm kur ne duhet të gjejmë rrugëzgjdhje për të bërë bashkëbisedë të hapur dhe miqësore. Ju jeni fener gjithashtu për arsye se ju thërrisni njerëzit për diskutim për të gjetur rrugëzgjdhjet me modelin tuaj praktik.”

Alhaji Aliu Mahama

Zv.krye-ministër i Ganës

“Misioni Ahmadia është një organizatë fetare në Ganë që shfaq mjaft tolerancë dhe u tregua shumë e gatshme për të bashkëpunuar me organet fetare, njësoj si me myslimanët ashtu edhe me të krishterët.”

Baroness Emma Nicholson

Anëtare e Parlamentit Evropian për Anglinë Juglindore

“Sa mirë keni qenë me komunitetin tonë! Komuniteti juaj që gjendet këtu, sot pasqyrohet me kaq shumë profesione dhe me kaq shumë mënyra të jetesës. Jeni të mbushur me të gjitha virtytet dhe etiketat e bukura, që feja juaj jua ka dhënë që kur keni lindur.”

Në këtë vijë bosh-tore të marrëdhënieve ndërkom-bëtare, shumë pyetje dhe shqetësime janë ngritur kundër më-simeve të fesë Islame. Shumica e kanë keqin-terpretuar

Islamin duke lejuar dhunë dhe terrorizëm. Ndërsa Xhemati Ahmadia gjithnjë ka shfaqur tolerancë, dashamirësi dhe vël-lazëri të vërtetë. Madje ai përhap paqe, dashuri dhe mirëkuptim në ithtarët e feve të ndryshme, por duke besuar fuqimisht në mësimet e Kuranit dhe duke i ndjekur ato. Xhemati mohon krejtësisht dhunën dhe ter-rorizmin, në çfarëdo lloj forme të jenë apo për çfarëdo lloj arsye të jenë.

Xhemati Ahmadia ofron një paraqitje shumë të qartë të diturisë së Islamit dhe të filozofisë, moralit dhe karakterit shpirtëror të tij, ashtu siç buron nga Kurani i Shenjtë dhe nga praktika e Profetit të Islamit, Muhammedit (paqja e Allahut qoftë mbi të.)

Micheal Macy

Atashe i Kulturës, Ambasada Amerikane në Londër, UK

“Unë si student i fesë Islame, vazhdimisht prej 30 viteve deri tani kam ngelur i habitur nga in-tensiteti i shërbimit që bën pikërisht ky Xhemat, nga traditat, nga niveli i lartë i tolerancës dhe kërkimi i vazhdueshëm për të gjetur kuptimin e njerëzimit. Për të qenë njeri do të thotë të jesh duke shërbyer, dhe unë mendoj se kjo pikëpamje është paraqitur në mënyrë kaq dramatike nga me-sazhi i këtij Xhemati.”

Stephane Dion

Kryetar i Partisë Liberale, Kanada

“Por në besimin e Xhematit Mysliman Ah-madia ka diçka goditëse dhe që të lë mbresë. Ju mësoni ndjekësit tuaj që besnikëria ndaj atdheut tënd është një pjesë e fesë



Xhelsa Salana e dytë e Xhematit Mysliman Ahmadia të Shqipërisë, 2008.

tënde. Ahmadianët janë krenarë nga fakti se kudo që shkon, ata tregohen qytetarë besnikë ndaj atij shteti ku jetojnë.”

El-Haxh Noorudin Usman Jaan
Ish-ministër i Shërbimeve Sociale, i të Rinjve dhe i Sportit



Ahmadianët duke bërë lutje të heshtur gjatë Xhelsa Salanës.

“Kam admirim dhe respekt shumë të madh për punën që bën Xhemati Mysliman Ahmadi në mbarë botën, për stimulimin e paqes dhe mirëkuptimit, thjeshtë jo vetëm me gojë, por edhe duke e treguar si shembull të

Kryetar i Partisë Publike të Sierra Leone

“Si do të ishte bota nëse nuk do të ishte Xhemati Ahmadi? Për sa i përket Islamit, do të ishte një boshllëk shumë shumë i madh, sa që në të vërtetë nuk mund të imagjinohej as për të menduar për impaktin që do të bënte mungesa e tij në shoqëri.”

Greg Sorbara

MPP/Ministër i Financave i Kanadasë

“Forca dhe angazhimi juaj në besimin tuaj forcon besimin e të gjithëve në Kanada, në të gjitha fetë dhe praktikat tona shpirtërore.”

Jeremy Hunt

Deputet i Kuvendit të Britanisë së Madhe, Sekretar i Dytë i Shtetit për Kulturën, Median dhe Sportin

“Interpretimi juaj i xhihadit gjithmonë ka qenë në kundërshtim të rreptë me “ekstremistët” e pa dëshiruar.”

Stephen Harper

Kryeministër i Kanadasë

“Ne e përgëzojmë Shkëlqesinë e tij, në mënyrë të veçantë për të hedhur poshtë mendimin e atyre që justifikojnë dhunë në përhapjen e fesë. Si do që të përkufizojmë Zotin, është gabim të vrasësh me emrin e Tij.”

Elizabeth Howlett

Anëtare e Asamblesë së Londrës së Madhe

mënyrës së jetesës dhe duke dhënë një model të mirësjelljes mbresëlënëse, të besimit të pamohueshëm në Zotin e Madhëruar dhe një model të paqes dhe tolerancës.”

Susan Kramer

Deputete e Kuvendit të Britanisë së Madhe

“Unë vetëm do të doja që të ishin këtu më shumë njerëz për ta dëshmuar këtë fytyrë të Islamit, për ta kuptuar pasqyrimin e asaj feje të madhëruar prej këtij Xhemati. Dhe unë shpresoj se në të ardhmen ju do të jeni ata që do të përfaqësojnë fytyrën e Islamit, dashurisë, tolerancës, vëllazërisë dhe të miqësisë. Puna që ju bëni në këtë Xhemat, çdo ditë, na lë të shpresojmë që çdokush tjetër të hapë sytë për të parë të vërtetën, drejtësinë dhe dhembshurinë që ju i sillni shoqërisë sonë.”

Hirësia e tij, Hazret Mirza Masroor Ahmadi, udhëheqësi i tanishëm i Xhematit vazhdon të bëjë përpjekje për të bashkuar popuj nga fetë dhe kulturat e ndryshme, duke nxitur bashkëbisedë-ndërfetare dhe liri fetare. Ai ka udhëtuar shumë, për të përhapur mesazhin e paqes dhe për t'i sjellë ndër mend çdokujt që t'i respektojë të drejtat e njerëzve. Gjatë udhëtimeve të tij, Hirësia e tij ka takuar liderët e botës si në Lindjen e Largët ashtu edhe në Evropë, në Amerikën Veriore dhe gjithashtu në Afrikë, për të diskutuar problemet që po përballon bota sot,

qoftë shoqërore, qoftë ekonomike apo politike. Gjithashtu, ai synon të krijojë paqe dhe drejtësi në këtë botë.

Ai gjithashtu ka takuar prijës të feve apo komuniteteve të ndryshme, për të ndarë me ta vlerat unike, idetë thelbësore që janë të njëjta në çdo fe dhe që ngrenë statusin moral të njerëzimit duke krijuar një atmosferë të dashurisë dhe dhembshurisë. Ai, me dhembshuri të plotë, dëgjon çdo njeri të thjeshtë, qoftë të vogël qoftë të madh, pa bërë dallim racën, ngjyrën apo fenë e tij. Ai personalisht ka nisur projekte shoqërore dhe plane për ta eliminuar varfërinë dhe vuajtjet njerëzore. Ai nuk interesohet vetëm për mirëqenien dhe statusin moral të anëtarëve të Xhematit Mysliman Ahmadia, por gjithashtu përpiqet për të pakësuar vuajtjet e tërë njerëzimit. Xhemati Mysliman Ahmadia njeh vetëm atë Islam, që është Islami i dashurisë dhe dhembshurisë dhe që jep mesazhin e vërtetë të paqes dhe të sigurtisë.

Richard Caborn

Deputet i Kuvendit të Britanisë së Madhe

“Është kënaqësi që të jesh i lidhur me këtë Xhemat dhe me këtë fe që thotë “Dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd”. Unë mendoj se nëse ne do t'i kushtojmë vëmendjen kësaj (thënije), në të vërtetë kjo do të ndikojë në të gjitha çështjet e botës së sotme.”

Don Morgan

Ministër i Drejtësisë dhe Përfaqësues Ligjor dhe Anëtar i Legjislavit për Saskatoon

Xhemati Mysliman Ahmadia ka qenë një lider në përhapjen e paqes dhe bashkëpunimit midis komuniteteve. I themeluar në 190 vende të botës, Xhemati Mysliman Ahmadia vazhdon të predikojë për paqen dhe tolerancën edhe në ato pjesë të botës ku anëtarët e këtij Xhemati keqtrajtohen për shkak të besimit të tyre.”

Stephen Harper

Kryeministër i Kanadasë

“Por, kjo nuk është çudi për askënd, të nderuar miq dhe mikeshë, për ata që e njohin këtë Xhemat, ahmadianët janë të famshëm në mbarë botën për devotshmërinë që kanë ndaj paqes, vëllazërisë universale dhe pëlqimit të Zotit, që janë parime themelore të Islamit të vërtetë.”

Jack Straw

Këshilltar i Parë dhe Sekretar i Shtetit për Drejtësinë, Angli

“Çdokush prej nesh, pavarësisht nga spektri politik që i përkasim, përgëzon fort punën e Xhematit Mysliman Ahmadia që ai bën këtu në Angli dhe në të gjithë botën.”

Vijay Kumar Chopra

Sipërmarrës i Medias dhe Kryeredaktor i tri gazetave të Indisë

“Në këto rrethana, duke parë ngjarjet siç po ndodhin sot në botë, sidomos ajo që ndodhi në Londër në vitin 2001, e vetmja shpresë që kemi është pikërisht nga njerëzit si ju, që po dalin përpara për ta mbushur boshllëkun që është krijuar sot midis njerëzve dhe për ta shpëtuar botën nga këto probleme.”

Jeremy Hunt

Deputet i Kuvendit të Britanisë së Madhe, Sekretar i Dytë i Shtetit për Kulturën, Median dhe Sportin

“Ju gjithashtu jeni si fener, sepse ju na mësoni ne të gjithëve që duhet të kërkojmë zgjidhjen e problemeve të sotme me anë të një rizbulimi të anës shpirtërore si dhe materiale të jetës sonë.”

Lord Eric Avebury

Zëdhënës i Punëve të Jashtme dhe i Commonwealth-it

“Le të marrim një vendim! Le të marrim vendimin për të përhapur mesazhin e paqes dhe të vëllazërisë, i cili është mesazhi juaj për njerëzimin që popujt e feve të ndryshme të mos grinden me njëri-tjetrin, por ta pranojnë dhe ta tolerojnë njëri-tjetrin dhe të jetojnë bashkë në atë mënyrë vëllazërore e paqësore, e cila është esenca e fesë tuaj.”

Shkurtime

s.a.v.s.: *Sal-lallahu alejhi ue selam*

(Paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi Profetin e shenjtë), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i Hazret Profetit Muhammed s.a.v.s.

a.s.: *Alehis selam* (Paqja qoftë mbi të), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë Profeti të Allahut xh.sh.

r.a.: *Redi Allahu anhu/anha/anhum* (Qoftë Allahu i kënaqur me të), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i ndonjë *sahabi* të Profetit të

shenjtë s.a.v.s. ose të Mesihut të Premtuar a.s.

r.t.a.: *Rahmatullah alejhe* (Allahu e mëshiroftë), shkruhet e lexohet kur përmenden emrat e muslimanëve të shquar e të devotshëm.

a.b.a.: *Ajjadahullahu t'ala bi nasrihil aziz* (Allahu e ndihmoftë atë me ndihmën e Tij të fuqishme), shkruhet e lexohet kur përmendet emri i Kalifit të tanishëm të Mesihut të Premtuar a.s.

Ajeti (vargu) “Bismillah...” (Në emër të Zotit...) që i referohet Kuranit të Shenjtë konsiderohet si ajeti i parë i çdo kapitulli (*sure*). Në disa tekste, nuk shënohet si ajet i parë, dhe lexuesi duhet të ketë parasysh se ajeti i cituar në revistën *Vërtetësia*, në tekste të tjera do të gjendet në një ajet më parë sesa numri i cituar.



Të nderuar lexues,

Redaksia e *Vërtetësisë* do t'ju lutej që në adresën e mëposhtme të shfaqni mendimin tuaj për çështjet që ju interesojnë. Zoti ju shpërbleftë!



E-mail:



Post:



Celularë:

vertetesia@gmail.com

Xhemati Mysliman Ahmadia
Kutia postare 8176
Tiranë, Shqipëri

+355 (0) 682974992

+355 (0) 692994966

+355 (0) 672168054

Fax: +355 (0) 48302523

Perlat e urtësisë nga fe të ndryshme

“Nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur alarmues.” (Kurani i Shenjtë 35:25)

“Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij.” (Kurani i Shenjtë 2:286)

Islami

Profeti Muhammed s.a.v.s. thotë:

“Allahu më ka thënë: Të gjitha krijesat e Mia janë familja Ime. Pra, Allahu prej krijesave të Tij, e do më shumë atë njeri që sillet mirë ndaj familjes (krijesave) së Tij dhe ia plotëson nevojat e kërkesat e saj.” (Mishkatul Mesabih, vol. 2, f. 217)

Krishterimi

“Silluni mirë ndër johebrenjtë, që aty ku do t'ju padisin si keqbërës, të përlëvdojnë Perëndinë ditën e ardhjes së tij, për shkak të veprave tuaja të mira.” (1 Pjetër 2:12)

Budizmi

“Të zemëruarin mposhte me dashuri; të vrazhdin mposhte me butësi; kurnacin mposhte me bujari; gënjeshtarin mposhte me të vërtetën.” (Dhammapada)

Judaizmi

“Mbaje gjuhën tënde larg së keqes dhe buzët e tua të mos thonë gënjeshtër. Largohu nga e keqja dhe bëj të mirën, kërkoje dhe siguroje paqen.” (Psalmet 34:13-14)

Konfucizmi

Konfuci thotë: “Unë do të jem i gëzuar nëse jetoj duke ngrënë oriz të trashë, duke pirë vetëm ujë dhe duke përdorur krahun tim si jastëk. Pasuria dhe nderi që një njeri zotëron në mënyrë të padrejtë, nuk janë veçse re që zhvendosen herë pas here.” (Analekte 7:15)

Hinduizmi

“Ata që urtësia e të cilëve është grabitur nga kjo apo ajo dëshirë, shkojnë te zota të tjerë, duke ndjekur këtë apo atë rit, të caktuar nga natyra e tyre vetjake.” (Bhagavad Gita 7:20)

“Vërtetësia” (the Truthfulness) is a periodical Albanian magazine
published by Ahmadiyya Muslim Jamaat, Albania.

Çmimi 2 € / 250 lekë